

## Kodi zgjedhor

Një, tre apo gjashtë njësi zgjedhore

Fq.3



## KOXIAS PËR BISEDIMET

Për emrin, PO dhe JO janë shumë afër

Fq.4



## HAKIMI, talenti i Realit që pritet të shkëlqejë në Rusi

Fq.22



# Koha

www.koha.mk

Marrëveshja historike për Kosovën

Fq.14

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3382 · E mërkurë, 6 qershor 2018

15°C | 27°C

15 DEN

### EDITORIAL

## A ja vlen të jesh ministër?



Tash e tutje ministër të ri të kulturës do të kemi një kuadër shqiptar. Po thonë se kultura tash e tutje do të trajtohet shumë seriozisht nga shteti, sepse është shtuar edhe një zyrë që do t'i koordinojë punët e pambaruara të Ministrisë së Kulturës. Shef i kësaj zyre do të jetë ministri i deritanishëm i Kulturës dhe po presim që të ndodhin mrekullira në këtë shtet të lodhur nga buxhetet e harxhuara kot. Me një pagë gati sa të ministrit, koordinatori i ardhshëm nacional i kulturës, do ta udhëzojë pasuesin e tij se si të menaxhohen...

Fq.2

### GLOBI

## Katari, model suksesi në një rajon të trazuar

Fq.15

### FORUM

## SHBA-të nxisin përçarjen e Evropës

Fq.11



## MËSIMI I GJUHËVE TË HUAJA NË MAQEDONI

# PRIN ANGLISHTJA, GJERMANISHTJA E DYTË



Pjesa dërmuese e nxënësve të mesëm - 71.238 nga gjithsej 71.458, zgjedhin ta mësojnë anglishten si gjuhë të parë të huaj, ashtu si edhe të gjithë filloristët pa përjashtim (192.448). E ardhmja nuk duket aspak fatlume për frëngjishten dhe rusishten. Në vitin shkollor 2017/2018 asnjë nxënës i shkollave të mesme nuk e kishte zgjedh rusishten si gjuhë të parë të huaj, ndërsa frëngjishten vetëm 126 nxënës - edhe atë që para katër viteve

Fq.7

## Shantazh me Facebook!

Shkup, 5 qershor - Autoritet zyrtare të Maqedonisë bëjnë të ditur se është në rritje numri i ankesave të qytetarëve për cenim, shkelje të të dhënave personale dhe privatësisë. Vetëm gjatë vitit të kaluar, përkatësisht gjatë vitit 2017, në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave personale janë parashtruar 376 ankesa nga ana e qytetarëve për keqpërdorimin e të dhënave të tyre personale. Nga Drejtoria për Mbrojtjen e të

Dhënave Personale, për Radion Evropa e Lirë thonë se 3 nga 4 parashtruesit e qytetarëve kanë të bëjnë me keqpërdorimin e të dhënave në rrjetet sociale duke kryesuar Facebook dhe më pas Twitter, Instagram. Pas miratimit të rregullores së përgjithshme evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale që ka hyrë në fuqi më 25 maj, që ka për qëllim mbrojtjen e të dhënave personale përmes një varg...

Fq.6



## EDITORIAL

A JA VLEN TË  
JESH MINISTËR?

Emin AZEMI

Na duket absurde kjo dëshirë e kryeministrit që me çdo kusht të "lehtësojë" punët e ministrave shqiptarë thua se ata janë zgjedhur për të qenë të koordinuar jo nga politika e bashkëqeverisjes, por nga teket e individëve që sa here që ngelin pa punë bëhen koordinatorë nacional

Tash e tutje ministër të ri të kulturës do të kemi një kuadër shqiptar. Po thonë se kultura tash e tutje do të trajtohet shumë seriozisht nga shteti, sepse është shtuar edhe një zyrë që do t'i koordinojë punët e pambaruara të Ministrisë së Kulturës. Shefi i kësaj zyre do të jetë ministri i deritanishëm i Kulturës dhe po presim që të ndodhin mrekullira në këtë shtet të lodhur nga buxhetet e harxhuara kot. Me një pagë gati sa të ministrit, koordinatori i ardhshëm nacional i kulturës, do ta udhëzojë pasuesin e tij se si të menaxhohen politikat kulturore dhe resurset që e bëjnë një vend të ketë identitet të vetin nacional, etnik, e civilizues.

Kryeministri mund të ketë koordinator nacional edhe për ngrohjen globale, por ndikimi i klimës në ambient do të jetë i pazvogëluar edhe pa këtë koordinator. Fundja, a ja vlen në ditë të sodit të bëhesh ministër, kur e di se prapa dere të qëndron një kujdestar, si tip mbikëqyrësi dhe në këtë sens humb kuptimi i të qenit udhëheqës i një dikasteri, që ke edhe njëfarë stafi dhe një far rregullore pune. Prandaj ia vlen të luftosh të bëhesh koordinator nacional në qeveri, sepse vetëm kështu nuk mund të zëvendësohesh më nga askush. Por është një kusht. Duhesh të jesh maqedonas patjetër. Në të kundërtën nuk vlen hiq ky funksion. Sepse po të ishte ndryshe, deri më tani do të kishim ndonjë koordinator nacional shqiptar.

Shpikja e funksioneve të tilla nuk është ndonjë risi. Si stil pune është e njohur përvoja dhe kur ndonjë qeveri s'ka qenë e disponuar të kryejë punë, ka hartuar strategji, ka formuar komisione dhe ka shpërblyer aktivistë të ndryshëm partiak me poste që mund të përketohen edhe si kompensim meritash për punët që kanë kryer në dobi të partisë. Dhe fund, as punët janë krye dhe as individët e caktuar janë begatuar me ndonjë biografi të hairit.

Tash së fundmi do të kemi një Angjushëv të ri në Qeveri dhe ai gjatë gjithë kohës do të merret me koordinim të politikave kulturore në vend. Deri më tani partitë shqiptare, pjesëmarrëse në pushtet, nuk e kanë kundërshtuar këtë far praktike, sepse kanë menduar se është vetëm improvizim i kryeministrit për ta paraqitur Qeverinë sa më interesante në sytë e publikut. Por në fakt, ky dublifim funksionesh, që në të shumtën e rasteve bëhet për të "lehtësuar" punë e ministrave shqiptarë, nuk lë shije të mirë në publikun shqiptar, i cili nuk ka votuar që obligimet e ministrave shqiptarë t'i kryejnë koordinatorët e ndryshëm maqedonas.

Koordinatori nacional për kulturë nuk ishte parapa si vend pune më pare. Ky sistemim erdhi tani, posa në postin e ministrit të Kulturës u vendos një kuadër shqiptar. Ky i fundit mund të paragjykohej, apo të mbiçmohet për aftësitë që mund ti ketë në drejtimin e këtij dikasteri, por atij nuk mund t'i mohohet e drejta kushtetuese ligjore për të qenë i plotfuqishëm në vendimet tija. Ministrin e ri të Kulturës nuk mundet askush ta obligojë, së paku në bazë të Ligjit aktual të Qeverisë, që të heqë dorë nga autonomia e vendimmarrjes dhe së këndejmi na duket absurde kjo dëshirë e kryeministrit që me çdo kusht të "lehtësojë" punët e ministrave shqiptarë thua se ata janë zgjedhur për të qenë të koordinuar jo nga politika e bashkëqeverisjes, por nga teket e individëve që sa herë ngelin pa punë bëhen koordinatorë nacional.

SHTETI DIKTATORIAL DHE  
KUSHTETUTA JODEMOKRATIKE

"Lideri i partisë OBRM-PDUKM, Hristian Mickovski, në tubimin kundërqeveritar, të mbajtur në Shkup, mes tjerash ka deklaruar: 'Shqiptarët nuk kanë nevojë për ligj kundërkushtetues të gjuhës shqipe'. Kështu është kur gjarpri i zbulon këmbët e veta. Ai, me këtë dëshmon se nuk ka asnjë shpresë të ndryshojë kjo kategori e njerëzve me mentalitet të pareformueshëm, të indoktrinuar thellë me urrejtje dhe shovinizëm kundër shqiptarëve, të cilët përmes kësaj deklarate i ofendon në nivel tepër poshtëruar, dhe jo vetëm me fajin e tij, as të paraardhësve të tij në parti në e cila e ka udhëhequr shtetin mbi 11 vjet me radhë, me ndihmën edhe të partive politike të shqiptarëve, drejtuesit e të cilave ose nuk e kuptojnë këtë gjuhë të urrejtjes që buron nga ideologjia nacionalshoviniste e kësaj partie politike, ose janë tepër të paditur dhe injorantë për të udhëhequr politikë në emër të shqiptarëve në Maqedoni.

Kur deklaroi kështu lideri i partisë më të madhe opozitare maqedonase, se „shqiptarët nuk kanë nevojë për ligj kundërkushtetues të gjuhës shqipe”, me këtë ai e pranon se kushtetuta e këtij shteti nuk e njeh gjuhën shqipe, me këtë as identitetin dhe përkatësinë kombëtare të shqiptarëve, prandaj, jo rastësisht ata janë të përfaqësuar si numra, përqindje në këtë kushtetutë, si pakicë kombëtare e padefinuar, e jo si popull shtetformues, sipas numrit të tyre dhe veçorive kombëtare, të dallueshme nga të tjerët, sepse shqiptarët janë i vetmi popull autokton në Maqedoni dhe përbëjnë shumicë të konsiderueshme të popullsisë në këtë shtet. Jo vetëm intelektualët shqiptarë, por edhe shumë intelektualë maqedonas kanë thënë publikisht, se kur do të çlirohet Maqedonia nga mentaliteti i njerëzve të kësaj partie me ideologji nacionalshoviniste, të cilën e drejton aktualisht Hristian Mickovski, vetëm atëherë mund të fillojë demokratizimi i kësaj shoqërie dhe progresi në këtë shtet. Kur do ta kuptojnë këtë edhe udhëheqësit e partive politike të shqiptarëve, apo, janë zhytur aq thellë në korrupsion dhe krime, sa që e kanë njësoj, nëse do të ndjehen shqiptarë, apo vetëm politikanë, e pa identitet kombëtar?!", shkruan në profilin e tij në FB, Abdulla Mehmeti.

## EKSTREMIZMI I FSHEHUR I BE-së

"Italia po bën një Qeveri që do të hap debate në BE. Spanja po bën një Qeveri që do të jetë më e ngushtë me BE-në në krahasim me të kaluarën. Qeveritë e Francës dhe të Holandës po vështirësojnë integrimin e shteteve të Ballkanit Perëndimorë. Greqia po pengon Maqedoninë për në NATO. Jemi në hall. Kujt të ja bëjmë qefin përpara. Domethënë edhe servilizmi i tepruar që kemi s'po na shpëton.

Kjo na e bën të ditur se, sa të pa mundshëm janë këto shtete dhe sa e pa konsoliduar është BE aktualisht. BE ka nevojë të luftoj ekstremizmin brenda vetes që aq shumë po e fsheh...", shkruan në profilin e tij në FB, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.

## ÇFARË KA QENË SUBASHI?

Subashi ka qenë funksionar ushtarak osman, komandant në një kaza, qytet ose nahije. Mbante rendin e qetësinë aty ku kryente detyrën dhe në kohë lufte merrte pjesë me repartin e tij në veprime luftarake. Më 1438 Skënderbeu ishte subash i vilajetit të Krujës. Në shek.XV subashi varej nga sanxhakbeu. Në

shek.XVI subashët u shndërruan në funksionarë administrativë, kryesisht nëpër feudet ushtarake dhe në çifligje, si përfaqësues të pronarëve të tyre. Subashë të tillë janë të përmendur për grabitjet e mëdha të të ardhurave mbi sasinë e caktuar të detyrimeve.

## MEDIACitate

Familjet e gjashtë shtetasve turq, të cilët më 29 mars të këtij viti u dëbuan nga autoritetet e Kosovës për në Turqi, janë duke përgatitur dosje për ta dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës. Lajmin për Radion Evropa e Lirë e ka konfirmuar Urim Vokshi, avokati i njëres prej gjashtë familjeve të shtetasve turq, duke shtuar se dosja ka të bëjë me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave kushtetuese me rastin e largimit me forcë të këtyre personave.

"Një periudhë kohore nuk mund të jap saktësisht, por jemi brenda afatit ligjor. Periudha për ngritje të çështjes në Gjykatën Kushtetuese është katër muaj nga ndodhja e rastit, kemi kohë edhe dy muaj". "Jemi duke përgatitur në mënyrë të detajuar dosjen, nuk jemi duke shpejtuar në atë aspekt sepse dëshirojmë që të gjitha faktet dhe argumentet t'i paraqesim sa më qartë", tha Vokshi.

Familjarët e shtetasve turq të dëbuar nga Kosova, muajin e kaluar kanë ngritur edhe padi kundër institucioneve përgjegjëse ndaj vendimit për urdhër- largimin e tyre me forcë dhe për revokimin e leje-qëndrimit të gjashtë shtetasve turq. Padinë e familjarëve të gjashtë shtetasve turq ndaj Qeverisë së Kosovës ditë më parë e kishte konfirmuar edhe kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se Qeveria e Kosovës "ka filluar një hetim të brendshëm", lidhur me këtë çështje. Dëbimi i gjashtë shtetasve turq ka nxitur reagime të ndryshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, posaçërisht nga organizatat për të drejtat e njeriut, të cilat e kanë dënuar veprimin e institucioneve të Kosovës. Dyshimet e ngritura se janë shkelur standardet ndërkombëtare të lirisë dhe të drejtave të njeriut, kanë shtyrë edhe Avokatin e Popullit, Hilmi Jashari që të nisë hetimet lidhur me këtë rast të deportimit. Në një raport më rekomandime të publikuar nga institucioni i Avokatit të Popullit drejtuar institucioneve kompetente në vend, janë gjetur shkelje të të drejtave të njeriut, tha për Radion Evropa e Lirë, Avokati i Popullit, Hilmi Jashari.

(REL, 5 qershor)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## Zaevi sërish i kërkon Ivanovit ta firmos Ligjin për gjuhët

Shkup, 5 qershor - Kryeministri Zoran Zaev edhe njëherë i bëri apel presidentit Gjorge Ivanov për të dhënë nënshkrimin e tij në Ligjin për gjuhët dhe të mundësojë funksionimin papengesa të demokracisë në shoqëri. Duke u përgjigjur në pyetje të gazetareve se kur pritet marrëveshje poli-

tike për Ligjin për gjuhët, si dhe shpalljen e tij në Gazetën Zyrtare, Zaevi theksoi se në disa takime me Ivanovin ka tentuar ta motivojë dhe ta nxitë për ta vendosur nënshkrimin, sepse siç tha, përmes këtij Ligji është bllokuar Parlamenti në funksionin e vet. "Kjo jep porosi se presidenti

mund të vendosë kur të dojë dhe për cilindo ligj që dëshiron ta aktivizojë 'veton që ka në xhep'. Kjo nuk është demokraci funksionale. Përgjegjësia është shumë e madhe", tha Zaev. Ai theksoi se duhet të ftohen institucionet kompetente si Gjykata Kushtetuese, por edhe të drejtohe

deri tek Komisioni i Venecias.

"Gjykata Kushtetuese tregon çka është kushtetuese dhe çka nuk është. Dhe nëse ka diçka problematike mund të ndryshohet", tha Zaev dhe shtoi se nëse me disa ligje rriten disa të drejta do të mundet më lehtë të hyjmë në procesin e tillë të paralajmëruar



për fillimin e negociatave me BE-në. (F.R)

## Maqedonia dhe Greqia me 37 projekte të përbashkëta

Strumicë, 5 qershor - Maqedonia dhe Greqia do t'i realizojnë 37 projekte të përbashkëta në kuadër të Interreg IPA programit për bashkëpunim ndërkufitar në shumë prej 36,2 milionë eurosh. Ajo u raportua në Info ditën për zbatuesit e projekteve që mbahet sot në hotelin "Sirius" në Strumicë. Nga gjithsej mjetet e parapara për realizimin e projekteve Maqedonisë i takojnë 14 milionë euro, ndërsa do të zbatohen projekte nga më shumë fusha të rëndësishme për qytetarët nga të dyja anët e kufirit. "Realizimi i projekteve të mëparshme ndërkufitare më jep të drejtë që të pres rezultate të dukshme edhe nga kjo thirrje. Bëhet fjalë për projekte të cilat sjellin hapjen e vendeve të reja të punës, menaxhimin e përbashkët të rreziqeve dhe fatkeqësive, përmirësim të infrastrukturës, shërbime më cilësore shëndetësore në rajonet ndërkufitare. Me funksionimin e përbashkët të këtyre projekteve përforcohet bashkëpunimi midis komunave, sektorit civil, institucionet e të dy palëve", tha Aleksandros Samaras, përfaqësues i Organit drejtues nga ana e Greqisë. Projektet duhet të realizohen në 18 muajt e ardhshme dhe të përfundojnë në vitin 2020.

Pritjet janë që në konkurs të paktën të paraqiten kandidatura serioze dhe të fillojë funksionimi i KSHZ, ndërkohë që në Parlament vazhdojnë të diskutohet mes grupeve të punës për ndryshimet në Kodin Zgjedhor. LSDM insiston një njësi zgjedhore, qëndrim që ndan edhe BESA, ndërsa BDI propozon tre njësi zgjedhore, ose në rastin më të keq të ruhet modeli i vjetër me gjashtë njësi

Koha Evis HALILI

Shkup, 5 qershor - Përbërja e anëtarëve të Komisionit të përkohshëm Shtetëror të Zgjedhjeve do të dihet muajin e kaluar. Pritjet janë që në konkurs të paktën të paraqiten kandidatura serioze dhe të fillojë funksionimi i KSHZ, ndërkohë që në Parlament vazhdojnë të diskutohet mes grupeve të punës për ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Koordinator i grupit parlamentar të Lidhjes Social Demokrate, Tomisllav Tuntev, ka vënë në dukje se bëhet fjalë për marrëveshje koncensuale midis katër partive më të mëdha parlamentare për një KSHZ kalimtare, pasi që pa ekzistencën e tij disa procese edhe mund të bllokohen, ndërsa në kompetenca ka organizimin e referendumit dhe verifikimin e mandateve.

"Besoj se procesi i zgjedhjes së anëtarëve të KSHZ-së do të kalojë në mënyrë të rregullt dhe në afatin e paraparë me ligj dhe diku nga

KODI ZGJEDHOR, VAZHDOJNË BISEDIMET MES GRUPEVE PUNËS

# NJË, TRE APO GJASHTË NJËSI ZGJEDHORE



fundi i këtij muaji apo në fillim të muajit të ardhshëm tashmë do ta kemi përbërjen e re kohore të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve", deklaroi Tomisllav Tuntev, koordinator i grupit të deputetëve të LSDM-së. Sipas zgjidhjes së tanishme ligjore, katër anëtarë do të jenë nga pozita, tre nga opozita, prej ku do të zgjidhet edhe kryetari i KSHZ-së. Nga VMRO-DPMNE nuk kanë ende ndonjë emër. Koordinator i grupit parlamentar, Dragan Danev, tha se për momentin nuk dihet kush do të jetë njeriu i parë i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Edhe Bashkimi Demokratik për Integritet e mbështet variantin e përkohshëm për zgjedhjen e anëtarëve të KSHZ,

duke iu referuar bisedimeve për modelin zgjedhor mes partive politike, koordinatori i grupit parlamentar të BDI, Rexhail Ismaili, tha se propozimi i tyre është që numri i njësisve zgjedhore të jetë tre, pasi që modeli i vetëm njësie është përjashtues dhe shumë rajone nuk do të kishin deputetët e tyre.

"BDI është për tre njësi zgjedhore, në mënyrë që përfaqësimi në Parlament të jetë nga të gjitha rajonet. Në rast se një gjë e tillë nuk miratohet ne jemi për variantin e vjetër me gjashtë njësi zgjedhore, pasi që modeli me një njësi zgjedhore nuk i përgjigjet të gjithë qytetarëve, përkatësisht të gjitha rajoneve, pasi një pjesë prej tyre

nuk mund të mbulojnë me deputetë", ka thënë Rexhaili.

Një njësi zgjedhore është modeli që përkrahet edhe nga BESA, fraksion i Kasamit. Deputeti i Fadil Zendeli, sqaron se gjashtë njësi zgjedhore janë shumë për Maqedoninë si një shtet me territor të vogël dhe se ata angazhohen për një numër më të vogël njësisish dhe lista të hapura. – "Nëse do të ketë një, dy apo tre kjo është një çështje që duhet ta bisedojnë partitë, ekspertët dhe të gjithë të interesuarit. Ne si parti jemi për lista të hapura, sistemin proporcional me lista të hapura", ka thënë Zendeli. Nga VMRO-DPMNE ende nuk deklarohet asnjë qëndrim.

HARADINAJ PRITI LIDERIN E PDSH-së, MENDUH THAÇI

## SHEMBULL SE SI DY SHTETE FQINJE TREGOJNË MARRËDHËNIE TË MIRA

Prishtinë, 5 qershor - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur dje në takim kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare, Menduh Thaçi, me të cilin bisedoi për zhvillimet politike dhe tema tjera të rëndësishme për të dyja vendet. Në këtë takim, Haradinaj përshëndeti rekomandimin për hapjen e negociatave për Maqedoninë për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke theksuar se kjo është e rëndësishme

për perspektivën evropiane të rajonit.

Po ashtu, kryeministri e njoftoi Thaçin për të arriturat në Kosovë, për rrugën integruese të Kosovës në BE dhe në NATO, duke theksuar se përkrahja e Maqedonisë në këto procese është e nevojshme për Kosovën. "Kosova dhe Maqedonia janë shembull se si dy shtete fqinje tregojnë marrëdhënie të mira dhe partneritet të mirë ekonomik dhe politik

dhe ky shembull duhet të shërbejë edhe për vendet tjera të rajonit, në mënyrë që në Ballkan të ketë paqe të qëndrueshme", tha kreu i ekzekutivit kosovar. Kryetari i PDSH-së, Menduh Thaçi, falënderoi Haradinajn për pritjen dhe angazhimin për marrëdhënie të mira bilaterale mes dy vendeve, duke theksuar mundësinë e thellimit të raporteve në të gjitha fushat e interesit të përbashkët.



## Po negociohet për zgjidhje të reja kreative



Shkup, 5 qershor - Deputeti i BDI-së, Artan Grubi, në një intervistë për Kanal 5 theksoi se bisedimet ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë për emrin nuk janë në qorr-sokak, por se bëhet fjalë për implementim të ndryshëm të asaj për çka janë marrë vesh dhe shtoi se në lojë janë edhe zgjidhje tjera kreative, përveç atyre nga pakoja e Methju Nimicit.

"Ndërmjetësuesi Nimic i propozoi emrat Veriore, e Vardarit, E Epërme, E Re dhe Republika e Maqedonisë (Shkupi). E dini se bisedohet për emrat e propozuar nga Nimici, por bisedohet edhe për çfarëdo zgjidhje të mundshme kreative. Kreative si: 'Republika e Maqedonia e Krushevës', 'Republika Maqedonia Bashkëkohore', 'Republika Maqedonia Evropiane', tha Grubi. Grubi tha se për gjithçka janë marrë vesh në bisedimet me Greqinë, mbetet edhe mënyra e implementimit të marrëveshjes. Sipas tij, janë në pyetje disa ditë deri në nënshkrimin e marrëveshjes për tejkallimin e kontestit për emrin.

"Asnjëherë nuk kemi qenë më afër zgjidhjes. Ne si parti jemi optimistë të mëdhenj dhe japim mbështetje të madhe për zgjidhjen e kontestit. Informacionet e fundit janë se janë afruar qëndrimet e dy palëve dhe mendoj se ky është lajm optimist. Jam i bindur se në ditët në vijim ajo që është e paqartë do të tejkalohet dhe se do të arrijmë ta nënshkruajmë dhe gjegjësisht do të arrijmë ta ruajmë atë që është më e rëndësishme për bashkëqytetarët e mi maqedonas: identiteti, gjuha, shtetësia. Bisedimet nuk janë në qorr-sokak, bëhet fjalë për implementimin e ndryshëm të asaj për çka janë marrë vesh. Maqedonasit do të mbetet maqedonas, qoftë në Shkup qoftë në Bruksel dhe Uashington. Gjuha do të mbetet maqedonase, në grupin e gjuhëve sllave, që është fakt", tha Grubi në intervistë për Kanal 5.

KOXIAS PËR PAKON E PESË EMRAVE TË PROPOZUARA

# PËR EMRIN, "PO" DHE "JO" JANË SHUMË AFËR

Nga pakoja e pesë emrave të propozuara nga ndërmjetësuesi Methju Nimic, Koxias tha se në lojë janë tre emra: "Republika e Maqedonisë Veriore", "Republika e Maqedonisë së Epërme", dhe "Republika e Maqedonisë së Re", pasi "Republika e Maqedonisë (Shkup)" u hodh poshtë nga pala greke, ndërsa "Republika e Maqedonisë së Vardarit", nga pala e Maqedonisë

Athinë, 5 qershor - Mendoj se po vjen momenti ta themi "PO"-në e madhe ose "JO"-në e madhe dhe i kupton vështirësitë që gjenden para teje, thotë ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, Nikos Koxias, në intervistë për televizionin shtetëror grek ERT në lidhje me ndodhitë e fundit në bisedimet ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë. "Kam ndjenja se udhëheqësia në vendin tonë mik në veri, udhëheqësia në Shkup tani, kur duhet të përfundojmë me këtë, i kuptoi vështirësitë e mëdha që ekzistojnë për implementimin e marrëveshjes dhe kjo luajti rol që të dëshirojë përsëri ta rishikojë marrëveshjen, të bisedojë për sqarime të caktuara për vetë marrëveshjen, por thellë jam i bindur dhe shpresoj se kjo, së shpejti, për disa ditë do të tejkalohet", tha Koxias.

Ai sqaroi se kjo është ndjenja e tij, se do të përmbillet çështja, por theksoi se "kurrë nuk duhet të thuhet kurrë, derisa nuk vijnë nënshkrimet" dhe shfaqti shpresë se kjo do të ndodh së shpejti. Shtoi se 5-10 ditë më herët ose më vonë, nuk bëjnë dallim të madh. Siç lajmëroi korrespondentja e MIA-s nga Athina, ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë nuk dëshiroi të zbulojë se për cilin emër janë marrë vesh sepse "kjo është e përfshirë në pakon dhe do të duhet ta publikojnë dy qeveritë, gjegjësisht dy kryeministrat".

Nga pakoja e pesë emrave të propozuara nga ndërmjetësuesi Methju Nimic, Koxias tha se në lojë janë tre emra: "Republika e Maqedonisë Veriore", "Republika e Maqedonisë së Epërme", dhe "Republika e Maqedonisë së Re", pasi "Republika e Maqedonisë (Shkup)" u hodh poshtë nga pala greke, ndërsa "Republika e Maqedonisë së Vardarit", nga pala e



Maqedonisë. Në lidhje me marrëveshjen, shefi i diplomacisë greke zbuloi se është 20 faqe, në fillim ishte 17, ndërsa pastaj arriti në 19, që versioni final të jetë 20 faqe. Për ratifikimin dhe implementimin e marrëveshjes, tha se do të pasojnë hapa konkret, siç janë ratifikimi në Kuvendin e Maqedonisë, pastaj referendum dhe ndryshimet kushtetuese, ndërsa pastaj drita e gjelbër nga Parlamenti grek.

"Fillimisht nevojitet ratifikim i marrëveshjes në Kuvendin në Shkup. Vetë Shkupi, jo ne vendosin që të mbajnë referendum, dëshirojnë të mbajnë referendum. Referendumin nuk e imponojmë ne, nuk e kërkojmë ne, nuk e imponon askush, ky është vendim politik që të mbahet premtimi i dhënë dhe ne, nga ana jonë e respektojmë plotësisht këtë vendim. Ne duhet ta kuptojmë këtë: kjo për ata nuk është vetëm një kompromis i thjeshtë, ata do ta ndërrojnë emrin e shtetit të tyre. Dhe kjo sa e di unë, ka ndodhur vetëm një herë në Evropën Qendrore, me austro-gjermanët", tha Koxias. Ai vlerësoi se nëse lidhet marrëveshja së shpejti, në Kuvendin e Maqedonisë do të arrijë në javët e ardhshme, referendumit me siguri do të mbahet në vjeshtë, ndërsa pas referendumit do të bëheshin ndryshime kushtetuese.

"Mendoj se nëse kalon në referendum atëherë edhe kryetari i vendit fqinj edhe deputetët do ta marrin parasysh vullnetin kombëtar. Mendoj se ky është një detyrim", thotë shefi i diplomacisë greke lidhur me atë

se çfarë do të jetë qëndrimi i presidentit të Maqedonisë dhe partive opozitare. Në pyetjen kur marrëveshja do të arrihet në Parlamentin grek, Koxias sqaroi se "marrëveshja do t'i parashikojë parakushtet për ratifikim dhe se nuk do të mund të jetë para referendumit në Shkup. Ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë, i pyetur për atë nëse ekziston mundësi që të bëhen ndryshime në marrëveshje, thotë se "gjithçka që është dashur të bëhet, është bërë" dhe sqaroi se me kolegët e tij nga Maqedonia të dielën në mbrëmje në takim në Bruksel, deri në orët e hershme të mëngjesit që nga fillimi e kanë shqyrtuar marrëveshjen të përfunduar dy ditë më parë në Nju-Jork dhe kanë arritur deri në ndryshimet që është dashur të bëhen. Nikos Koxias thotë se ka vullnet edhe nga të dyja qeveritë që të gjendet zgjidhje me kompromis, diçka që është normale në marrëdhëniet ndërkombëtare.

"Mendoj se udhëheqësia e IRJM-së sjell një vendim shumë të vështirë dhe të drejtë, për të cilin është i nevojshëm guxim i madh politik, pjekuri e madhe politike dhe mendoj se këtë e tregojnë dhe do ta tregojnë. Gjithashtu mendoj se i sqarojnë edhe përfitimet që ekzistojnë për anën e tyre", thotë Koxias. Lidhur me përfaqësuesin e KB-së në bisedimet për emrin, shefi i diplomacisë greke tha se "Nimic, gjendet para një suksesi të madh në jetën e tij, sepse do të përfundojë diçka në të cilën punon 25 vjet".

## ZAEVI PËR DEFINIMIN E MARRËVESHJES PËR EMRIN

# Në pyetje janë ditë kur do të ndodh biseda me Ciprasin

Shkup, 5 korrik - Në pyetje janë ditë që të ndodh biseda telefonike mes kryeministrave të Maqedonisë dhe të Greqisë dhe për momentin ende krijohen rrethana që të realizohet kjo. Këtë e porositi kryeministri Zoran Zaev në margjinat e konferencës përfundimtare të projektit Rrjeti 23+ kapitulli 23: Kutia e Pandorës ose çelës për qeverisje të mirë?, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve për atë deri ku janë bisedimet me Aleksis Ciprasin, por

edhe duke e komentuar deklaratën e shefit të diplomacisë greke Nikos Koxias se është koha që të thuhet një "PO" ose "JO" e madhe në procesin e negociatave.

Lidhur me deklaratën e Koxiasit se janë në lojë tre propozime Republika e Maqedonisë Veriore, Republika e Maqedonisë së Epërme dhe Republika e Maqedonisë së Re, Zaev u përgjigj beson që procesi është nga fundi dhe se fundi do të jetë i lumtur dhe i sukses-

shëm. "Të mos flasim me detaje për atë, ende krijohen rrethanat që të realizohet biseda telefonike. Në pyetje janë ditë. Pasi që do të ndodh qytetarët do të informohen për atë edhe për përmbajtjen e saj" tha kryeministri i Maqedonisë.

Ai nuk dëshiroi të komentojë nëse janë në lojë zgjidhje të reja kreative të cilat dje në një intervistë për Kanal 5 i parashitri Artan Grubi nga BDI-ja, Republika e Maqedonisë e Krushevës, Republika

Maqedonia Bashkëkohore, Republika Maqedonia Evropiane. "Pyetja është sensitive dhe do të mbetem i kujdesshëm. Këto ditë dua që të jenë ditë të përfundimit të suksesshëm të procesit. Kur të gjitha hollësitë do të kontraktohen, menjëherë do të ndahen me publikun. E ndjeshme është tek ne, e ndjeshme është në Greqi", tha Zaev dhe shtoi se megjithatë, për pyetjen në fund qytetarët do të vendosin në referendum. (F.R)



Fillimi i procesit të deinstitutionalizimit, ringjallja e skenës kulturore në nivel lokal, avancimi i shkrim-leximit në media, avancimi i sistemit arsimor përmes arsimit joformal, partnerit dhe aktivitet në sektorin e shëndetësisë, paraqesin vetëm një pjesë të të arriturave që sektori civil i ka realizuar në Maqedoni, të cilave qytetari i rëndomtë nuk i ka kushtuar rëndësi

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 5 qershor - Qytetarët e Maqedoni nuk i njohin apo nuk vërejnë ndryshimet shoqërore që janë realizuar përmes angazhimit dhe punës së sektorit civil në vendin tonë. Kjo u konstatua në prezantimin e Instrumentit për matjen e ndryshime shoqërore të nisura nga sektori civil, ku morën pjesë përfaqësues të organizatave e institucioneve të ndryshme.

Drejtoresha e shoqatës jo qeveritare "Public", Klimentina Ilijevska, tha se aktivitet dhe puna e pandalshme e organizatave të ndryshme shumë pak është parë nga qytetarët. Në rast se shihet perceptimi i qytetarëve për punën dhe veprimtarinë e sektorit civil në Maqedoni, respektivisht nëse shihen të arriturat në terren, mund të vërehet një dallim i madh.

"Përderisa nga njëra anë kemi shprehje të mosbesimit, nga ana

NDRYSHIMET SHOQËRORE TË NISURA NGA SEKTORI CIVIL

# QYTETARË TË PAINFORMUAR



tjetër kemi tregues të ndryshime, të cilët qytetarët nuk janë të vetëdijshëm se janë iniciuar dhe trajtuar nga organizatat jo qeveritare. Qasja e sektorit civil deri te grupet e rrezikuar dhe qytetarët në nevojë është shumë më i shprehur se sa prezenca apo interesi i vetë institucioneve shtetërore", tha Ilijevska.

Hulumtimi i realizuar nga shoqata "Public" ka konstatuar se përgjatë dy dekadave të kaluar kontributi i shoqatave joqeveritare në ndryshimin e zhvillimeve shoqërore në Maqedoni ka qenë tepër i lartë, por fatkeqësisht këto aktiviteteve nuk janë shikuar me një interes të posaçëm nga ana qy-

tetarëve. Fillimi i procesit të deinstitutionalizimit, ringjallja e skenës kulturore në nivel lokal, avancimi i shkrim-leximit në media, avancimi i sistemit arsimor përmes arsimit joformal, partnerit dhe aktivitet në sektorin e shëndetësisë paraqesin vetëm një pjesë të të arriturave që sektori civil i ka realizuar në Maqedoni, të cilave qytetari i rëndomtë nuk i ka kushtuar rëndësi.

"Gazetaria hulumtuese kryesisht deri më tani është iniciuar nga sektori civil dhe shoqatat e ndryshme, me çka mediat në këtë drejtim shumë pak marrin pjesë. Paralelisht edhe kultura media-tike është zhvilluar nga organi-

zatat joqeveritare. Kur jemi të shëndetësia mund të themi se është realizuar një progres i dukshëm në relacion të ndërtimit të raporteve me institucionet dhe marrjes përsipër të një pjesë të aktiviteteve që realisht organet shtetërore nuk kanë mundësi ti bëjnë. Gjatë dy dekadave të fundit sektorit civil ka arritur të ndryshoj edhe një varg punësh tjera. Shpresoj se përmes Instrumentit të parë të kontekstulizuar për matjen e ndryshimeve shoqërore, sektori civil do të ketë mundësi të shoh ndikimin e tyre në ndryshimet shoqërore. Pres që ky Instrument në të ardhmen për organizatat jo qeverita-

re të jetë bazë apo pikënisje e cila do ti udhëzoj se në çfarë segmenti duhet të përqendrohen dhe në çfarë sektori të fokusohen", tha Ilijevska. Koordinatorja e ekipit, i cili e ka realizuar hulumtimin për ndikimin e organizatave jo qeveritare në Maqedoni, profesoresha Maria Donevska, ka thënë se fenomenet shoqërore kanë një strukturë tejet abstrakte dhe të ndërlikuar që e bëjnë të vështirë matjen dhe ecurinë tyre.

"Nëse dëshirojmë të dimë se vallë aktivitet tona janë efikase dhe të dëshiruara, atëherë duhet të këmbëngulim dhe të shfrytëzojmë një metodologji e cila i përshtatet atyre. Shoqatave të qytetarëve iu nevojitet njohuri dhe të dhëna se cilat segmente të funksionimit të tyre janë të dobishëm që sjellin ndryshime, respektivisht cilës pjesë të veprimtarisë së tyre i duhet ndryshimi. Një mundësi të tillë do ta ofrojë Instrumenti për matjen e ndikimit të organizatave në ndryshimet shoqërore", tha profesoresha Donevska.

Të dhënat e siguruar nga ky hulumtimi e tregojnë edhe një realitet të hidhur të shoqërisë në vendin tonë e cila pa diskutim është e ndarë në shumë sfera, përfshi edhe atë etnike. Përderisa pjesa dërmuese e sektorit civil vjen në përfundim se qytetarët nuk janë të informuar apo nuk e njohin punën e tyre, parashtrohet dilema se në çfarë gjendje është shoqëria shqiptare në Maqedoni.

PRIBE ME POROSI NGA OHRI

## Sundimi i së drejtës, imperativ për reformat



Ohër, 5 qershor - Nuk kam informata të hollësishme në atë se çka ka ndodhur, çka është bërë gjatë dy viteve të kaluara lidhur me dy raportet që i kemi përgatitur si grup ekspert, ato të vitit 2015 dhe të vitit të kaluar. Raporti i BE-së për përparimin e Maqedonisë tregon në përparim të konsiderueshëm në sfera të caktuara, por ekzistojnë edhe mjaft sfera ku duhet edhe mjaft të punohet, të zbatohen reformat e domosdoshme në procesin eurointegruar.

Qartë se në raportin si çështje qendrore dhe prioritet u potencua sundimi i së drejtës me të gjitha aspektet që i nënkupton, tha

Rajnhard Pribe, i cili merr pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare për reformat në sistemin e sigurisë, që mbahet në Ohër.

Pribe, i cili e udhëheq grupin pesëanëtarësh ekspert të BE-së, i obliguar për çështje sistematike, në deklaratë për mediumet theksoi se më nuk është përfaqësues zyrtar i BE-së, por personalisht shpreson se Maqedonia dhe shtetet nga rajoni do të bëjnë përparim në procesin e eurointegritimit. "Për çdo rast, reformat të cilat i potencuam, e të cilat përmenden edhe në Raportet e BE-së, duhet të bëhen, jo vetëm për shkak të përparimit në atë proces eurointegruar, por më shumë për vetë shtetet dhe qytetarët para së gjithash", tha Pribe. Ai nuk deshi të ndajë ndonjë sferë ku do të duhej politika, shteti dhe institucionet t'i orientojnë proceset e tyre refor-

muese. "Bëhet fjalë për një sërë rekomandimesh. Sundimi i së drejtës është kyç për afrimin drejt BE-së, të gjitha resurset dhe forcat në shoqëri do të duhej të angazhohen dhe orientohen drejt atij qëllimi", tha Pribe. Pribe mbajti fjalim para pjesëmarrësve në Konferencën për reforma në strukturat e sigurisë, ku e theksoi rëndësinë e çështjeve të sigurisë në procesin e afrimit dhe anëtarësimit në BE, prej aty pasi vet Unioni ballafaqohet me probleme të natyrës së sigurisë. Ingrid Shikova, profesoresha e politikave të BE-së pranë Universitetit të Sofjes, tha se çështjet e sigurisë janë me rëndësi të madhe jo vetëm për vendet e rajonit, por edhe në aspektin kontinental, madje edhe global.

"Jo rastësisht Bullgaria gjatë kryesimit me BE-në mes prioritetëve e vendosi çështjen e sigurisë në Ballkanin Perëndimor. Sa më sh-

pejtë vendet nga rajoni i plotësojnë kriteret për sigurinë në procesin e anëtarësimit, kjo do të kontribuojë për Evropë më të sigurt. Shtetet nga Ballkani Perëndimor duhet ta ndjekin shembullin e pajtimit të shteteve nga Evropa Perëndimore pas Luftës së Dytë Botërore dhe përmes tejkalimit të kontesteve të kontribuojnë për siguri më të madhe në kontinent. Çështje kyçe në sigurinë është paraqitja e përbashkët në ballafaqim me sfidat", tha Shikova.

Konferenca për siguri, që mbahet në Ohër në organizim të Fakultetit për siguri, ka për qëllim që bashkësia akademike dhe praktikantët nga sfera e sigurisë të këmbëjnë njohuri të bazuara në shfrytëzimin e metodave shkencore për hulumtim në këtë sferë, por edhe të përfitohet përvoja nga praktika që të mund t'u jepet dimension shkencor-hulumtues.

## Termin për dokumente identifikimi edhe përmes telefonit

Shkup, 5 qershor - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) të martën filloi me caktimin e orareve për aplikim për dokumente biometrikë edhe përmes telefonit celular 072929292. Përkundër caktimit online përmes ueb faqes të MPB-së (<http://termin.gov.mk/>) edhe me caktimin e telefonit në numrin 0800 192 92, qytetarët do të mund të caktojnë orare edhe duke telefonuar në numrin celular 072929292. "Janë siguruar 30 linja (operatorë) që do të shërbejnë qytetarët edhe me këtë në masë të madhe do t'i lehtësohet mënyra që më shpejt të nxirren dokumentet personale informojnë nga MPB-ja.

TREFISHOHEN KEQPËRDORIMET NË RRJETET SOCIALE

# SHANTAZH ME FACEBOOK!

Tre nga katër parashtresat e qytetarëve kanë të bëjnë me keqpërdorimin e të dhënave në rrjetet sociale duke kryesuar Facebook dhe më pas Twitter, Instagram...

Shkup, 5 qershor - Autoritet zyrtare të Maqedonisë bëjnë të ditur se është në rritje numri i ankesave të qytetarëve për cenim, shkelje të të dhënave personale dhe privatësisë. Vetëm gjatë vitit të kaluar, përkatësisht gjatë vitit 2017, në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave personale janë parashtruar 376 ankesa nga ana e qytetarëve për keqpërdorimin e të dhënave të tyre personale.

Nga Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Radion Evropa e Lirë thonë se 3 nga 4 parashtresat e qytetarëve kanë të bëjnë me keqpërdorimin e të dhënave në rrjetet sociale duke kryesuar Facebook dhe më pas Twitter, Instagram. Pas miratimit të rregullores së përgjithshme evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale që ka hyrë në fuqi më 25 maj, që ka për qëllim mbrojtjen e të dhënave personale përmes një varg procedurash, çdo shfrytëzues në inter-



net duhet të japë pëlqim se dëshiron apo jo të dhënat e tij të mund t'i shfrytëzojë kompania ku është abonuar, autoritet në Maqedoni kanë paralajmëruar që brenda këtij viti do të miratohet dhe një Ligji ri për mbrojtje të të dhënave personale, në përputhje të plotë me rregullativën evropiane.

Sekretari i përgjithshëm i drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale, Igor Kuzevski, për Radion Evropa e Lirë thotë se përmes ndryshimeve ligjore synohet të rritet niveli i sigurisë së të dhënave personale të qytetarëve në përputhje me standardet evropiane,

duke aplikuar mekanizmat e modelit të rregullativës së përgjithshme evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale. "Gjatë vitit të kaluar, Maqedonia në detaje ka punuar në hartimin e ligjit në fjalë dhe tanimë me ndërmjetësimin e delegacionit të Bashkimit Evropian këtu në Shkup, e kemi dërguar për shqyrtim se a është në përputhje të plotë me rregullativën evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale".

"Në mars morëm disa vërejtje të vogla të cilat tanimë i kemi përmirësuar dhe ato përmirësime i kemi inkorporuar në tekstin e ligjit.

Besoj se deri në fund të vitit, ligji do të marrë vizë dhe nga Parlamenti duke u mundësuar qytetarëve një shkallë të më të lartë të sigurisë sa i përket të dhënave personale", thotë Kuzevski. Por, njohësit e çështjeve juridike thonë se mbrojtje absolute nuk mund të sigurohet përmes ligjeve sepse bota elektronike ka shumë kurthe që jetën private të qytetarëve e vë në spikamë.

"Sado që të dëshirojmë apo të tregohemi të kujdesshëm që të mbrojmë të dhënat tona personale pothuajse është e pamundur në këtë kohë teknologjike në të cilën jetojmë. Thjesht nuk kemi mundë-

si se si të mbrohemi, ngase ne me vullnetin apo pa vullnetin tonë i hedhim në sistem në çfarëdo forme të komunikimit elektronik që në një mënyrë krijohet mundësi që ato të keqpërdoren. Pra, është shumë e vështirë të vendoset sistemi i mbrojtjes", thotë Qebri Avziu ligjërues i penales në Universitetin e Tetovës. Përdërisa, ekspertët e informatikës konsiderojnë se me rregullativën e evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe harmonizimin e legjislativës edhe në kushte të Maqedonisë ngushtohet hapësira e përdorimit të të dhënave personale. "Tani vendosen dënime të larta, madje rreth 4 për qind nga të qarkullimi i kompanive më të mëdha si dhe platformat e ndryshme në internet nëse ata mundësojnë të keqpërdoren të dhënat personale të abonuesve kjo i bën të jenë më syçelë në këto raste", thotë Bojan Kordallov ekspert i Informatikës.

Autoritetet përkatëse në Maqedoni vlerësojnë se tek popullata më e re vetëdija publike është në nivel të lartë, andaj theksojnë edhe nga drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale se numri i ankesave nga ana e gjeneratave të reja është më i ulët krahasuar me grupmoshat më të vjetra. (REL)

SHMANGIA E VAKSINIMIT

## Pasojat mund të jenë vdekjeprurëse

Ministria e Shëndetësisë së bashku me ministrinë e Arsimit dhe atë të Punës Sociale po merren me këtë problem dhe po shqyrtojnë mundësitë për ndërmarrjen e masave, të cilat do të kishin përfshirë në vaksinim të gjithë popullsinë, ndërkohë që tërhiqet vërejtja një fëmijë i pavaksinuar dhe me infeksion mund të shkaktojë sëmundje infektive tek shumë fëmijë

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 5 qershor - Maqedonia është në grupin e vendeve me rrezik të lartë të përhapjes së sëmundjeve infektive. Kjo si pasojë e zvogëlimit të numrit të fëmijëve, të cilët nuk pranojnë vakcina. Një rënie e dukshme e dinamikës së vaksinimit ka qenë në periudhën e kaluar në Maqedoni, sipas të dhënave më të fundit të Institutit të Shëndetit Publik. Krahasuar me vitin e kaluar edhe këtë vit, ka një rënie për të gjitha vaksinat me përjashtim të vaksinës MRP (vaksina kundër fruthit, shytave dhe rubeolës), e cila megjithëse ka një rritje të parëndësishme krahasuar me vitin e kaluar, ende është i ulët në fushëveprim, nën 90 për qind.

Mjekët pediater vazhdojnë të apelojnë që prindërit të mos ndalojnë në vaksinimin e fëmijëve të tyre. Mirëpo, duke u përpjekur për

t'i "mbrojtur" fëmijët nga autizmi, prindërit i lënë ata të ekspozuar ndaj sëmundjeve shumë të rrezikshme të fëmijërisë, të cilat shoqërohen me pasoja të rënda.

Nëna A.M konsideron se vakcina është e dëmshme për fëmijën e saj, me autizëm dhe ajo kërkon që të bëhen analiza gjenetike, për të vërtetuar nëse fëmija nuk reagon normal. Ajo është e hutuar nga ato që lexon në internet, sepse ka raste që disa doktor mendojnë që vakcina është negative për fëmijën që ka probleme, disa të tjerë nuk mendojnë kështu. Sipas këtij prindi vakcinat kanë përherë një efekt të kundër, sidomos kur bashkë me vaksinën fusim bakterien që të krijojë antitrupta, për të mbrojtur organizmin e njeriut.

Megjithatë, shmangia e vaksinimit, sipas mjekëve, do t'i lë fëmijët të pambrojtur nga sëmundje me pasoja deri vdekjeprurës.

Mjekja Gjylshene Murati, apelon që fëmijët patjetër të marrin vaksinat për t'u mbrojtur nga sëmundjet e rrezikshme. Ajo tregon se vajzën e saj e ka vaksinuar, për arsye se janë disa sëmundje të rrezikshme që po rikthehen dhe ato mund të parandalohen vetëm me vakcina adekuate. Nuk mund të jetë justifikim autizmi si shkak për të shmangur vaksinat, shpjegon pediatria, ndonëse nuk përjashtohet që të paraqiten situata të rralla që vakcina të shkaktojë komplikime, alergji, raste këto shumë specifike.

Vaksina MRP që merret në muajin e 13 të fëmijës, sipas mjekes Murati mundet të pranohet edhe më vonë. Por këshilla e saj është që fëmija në atë moshë 10 fjalë të paktën duhet t'i shqiptojë edhe po të jenë të paqarta. Ajo shton se vajzën e vet e ka vaksinuar pa mos belbëzuar asnjë fjalë, ndërsa fëmija i saj ka filluar në muajin e 18 të



nxjerr fjalë nga goja. Por ka edhe përjashtime kur shumë prindër marrin dezinformata nga rrjetet sociale, ndërsa harrojnë se ka njerëz të specializuar për problemet e shëndetësisë, sqaron mjekja Murati. Ministria e Shëndetësisë së bashku me ministrinë e Arsimit dhe atë të Punës Sociale po merren me këtë problem dhe po shqyrtojnë mundësitë për ndërmarrjen e masave, të cilat do të kishin përfshirë në vaksinim të gjithë popullsinë. Megjithatë, Ministria e Shëndetësisë ka lënë në dorë të zgjedhin vetë prindërit nëse do të vendosin që vaksinonjë fëmijën e tij ose jo, ndërkohë që tërhiqet vërejtja një fëmijë i pavaksinuar dhe me infeksion mund të shkaktojë sëmundje

infektive tek shumë fëmijë.

Ndryshe, nga raporti i Institutit të Shëndetit Publik thuhet se refuzimi i vaksinimit nga ana e prindërve është nën ndikimin e lobit kundër vaksinimit në Maqedoni. Kjo edhe për shkak të ndikimit të disa punonjësve shëndetësorë, kryesisht mjekë (mjekët e familjes, pediatri dhe gjinekologët) të cilët rekomandojnë vonesa të vaksinimit për në një moshë më të madhe të fëmijës. Kjo situatë i referohet vaksinimit MRP dhe HPV, duke rezultuar në mbulimin më të ulët për të dyja vaksinat. Gjithashtu, rivaksinimi që kryhet në moshën shkollore është i ulët, ndonëse Ligji është i qartë dhe i prerë se vaksinimi patjetër duhet të kryhet.

## Kthehet mundësia për privatizimin e tokës shtetërore

Shkup, 5 qershor - Ministria e Financave ka përgatitur ndryshime të Ligjit për privatizim dhe qira të tokës ndërtimore në pronësi shtetërore, me të cilat prolongohet afati për parashtrimin e kërkesës për privatizimin e tokës. Me ndryshimet jepen tre vjet shtesë, gjegjësisht mundësi që të parashtrihen deri më 31 dhjetor të vitit 2021. Afati për parashtrimin e kërkesës sipas kësaj baze skadoi më 15 dhjetor të vitit 2014 dhe nga ajo datë e deri më tani nuk kanë mundur të parashtrajnë kërkesa për privatizim. Nga Ministria dikasteriale tregojnë se në periudhën e fundit kanë arritur shumë reagime nga qytetarët të cilët nuk kanë arritur ta ruajnë afatin për parashtrimin e kërkesës për privatizim. Bëhet fjalë për qytetarë të cilët kanë jetuar jashtë vendit, por edhe qytetarë të cilët jetojnë në vend dhe nuk kanë arritur të parashtrajnë kërkesë në afat.

Siç informojnë, pasi vazhdohet afati për parashtrimin e kërkesës, prolongohen edhe ndryshimet e dispozitave për qira, gjegjësisht shtyhet konfirmimi i qirasë për ata të cilët nuk do ta privatizojnë tokën. "Përveç afatit për kërkesë për privatizim, prolongohet edhe afati për parashtrimin e aplikimit për ndryshim nga e drejta e shfrytëzimit në të drejtë pronësie. Afati për këtë kërkesë prolongohet deri më 31 dhjetor të vitit 2022", kumtojnë nga Ministria e Financave.

Cjithashtu, vazhdohet edhe afati për kërkesën për ndryshim të aplikuesit të privatizimit të tokës ndërtimore. Për shembull, nëse një person blen objekt, i cili gjendet në tokë dhe e cila është në procedurë të privatizimit, me ndryshimet e Ligjit, në vend të 30 ditëve, do të ketë në dispozicion 60 ditë për të parashtruar kërkesë për ndryshim të aplikuesit për privatizim. Zbatimi i deritanishëm i Ligjit ka treguar se afati prej 30 ditëve është shumë i shkurtër dhe kështu me ndryshimet u dilet në ndihmë qytetarëve.

## MËSIMI I GJUHËVE TË HUAJA NË MAQEDONI

# PRIN ANGLISHTJA, GJERMANISHTJA E DYTË

Pjesa dërmuese e nxënësve të mesëm - 71.238 nga gjithsej 71.458, zgjedhin ta mësojnë anglishten si gjuhë të parë të huaj, ashtu si edhe të gjithë filloristët pa përjashtim (192.448). E ardhmja nuk duket aspak fatlume për frëngjishten dhe rusishten. Në vitin shkollor 2017/2018 asnjë nxënës i shkollave të mesme nuk e kishte zgjedh rusishten si gjuhë të parë të huaj, ndërsa frëngjishten vetëm 126 nxënës - edhe atë që para katër viteve

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 5 qershor - Mësimi i anglishtes në shkollat e Maqedonisë vazhdon të ruajë primatin e gjuhëve të huaja dhe paralelisht vite me radhë vërehet edhe një tendencë tjetër në rritje - ajo e mësimi të gjuhës gjermane. Si në shkollat e mesme ashtu edhe në shkollat nëntëvjeçare, nxënësit zgjedhin në masë më të madhe të mësojnë anglishten dhe pastaj gjermanishten. Madje, gjatë këtij viti shkollor (2017/2018), në nivelin e shkollave fillore nuk është shënuar as edhe një rast tjetër i mësimi të ndonjë gjuhe tjetër të huaj (si gjuhë e parë) përpos anglishtes. Gjuhët tjera janë alternativa për gjuhë të dytë të huaj dhe ku kryeson gjermanishtja. Në arsimin e mesëm, kjo ndarje nuk është si e "prerë me thikë", pasi në kategorinë e gjuhës së parë, përveç anglishtes mësohen edhe gjuhë të tjera, por kuptohet në masë shumë të vogël krahasuar me anglishten. Sipas të dhënave për vitin shkollor 2017/2018, i cili do të përfundojë këtë javë, të gjithë filloristët pa përjashtim, mësojnë anglishten si gjuhë të parë të huaj. Pra 192.448 nxënës, nga klasa e parë deri të nëntën, kanë zgjedhje të parë



anglishten ashtu sikundër nuk ka asnjë nxënës që ta ketë anglishten gjuhë të dytë të huaj. Në kategorinë e lëndëve, pra të gjuhës së dytë të huaj - më tepër e përfaqësuar është gjuha gjermane, pastaj gjuha frënge, ruse dhe ndonjë tjetër. Referuar të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave, ndarja e nxënësve të shkollave fillore sipas mësimi të gjuhës së dytë të huaj është me sa vijon: 46.960 nxënës kanë zgjedhur mësimin e gjermanishtes, 36.033 frëngjishten, 649 rusishten dhe 407 ndonjë gjuhë tjetër të huaj edhe atë nga klasa IV deri IX, pasi në dy ciklet e para të arsimit nëntëvjeçar - gjuhë e dytë e huaj janë vetëm anglishtja dhe gjermanishtja. Në nivelin e arsimit të mesëm, mësimi i gjuhëve të huaja është i rregulluar në tre kategori edhe atë si gjuhë e parë e huaj e obligueshme, gjuhë e dytë e huaj e obligueshme dhe gjuhë e huaj fakultative (zgjedhore). Në kategorinë e parë, sipas programeve mësimore, janë dhënë anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja dhe rusishtja, kurse në kategorinë e dytë dhe të tretë të lëndëve, listës së gjuhëve u janë shtuar edhe italishtja, turqishtja dhe ndonjë gjuhë tjetër. Në këto dy kategori, anglishten e kanë zgjedhur ose shumë pak nxënës (198 si lëndë të dytë) ose nuk e kanë zgjedhur fare (si

lëndë fakultative), pasi pjesa dërmuese e nxënësve 71.238 (nga gjithsej 71.458 nxënës të mesëm) e mësojnë anglishten si gjuhë të parë të huaj. E ardhmja nuk duket aspak fatlume për frëngjishten dhe rusishten. Kjo e fundit, veç më ka kaluar në histori. ESSH raporton se në vitin shkollor 2017/2018 asnjë nxënës nuk e kishte zgjedh mësimin e rusishtes si lëndë e gjuhës së parë të huaj, ndërsa frëngjishten e kishin zgjedhur 126 nxënës edhe atë që para katër viteve. Në vitin e parë, të dytë dhe të tretë të shkollave të mesme asnjë nxënës nuk e ka frëngjishten gjuhë të parë të huaj. Ndryshe, ndodh me gjermanishten e cila për momentin mësohet si gjuhë e parë me nxënësit e të gjitha viteve të arsimit të mesëm (nga 94 nxënës në total).

Njëllor si në shkollat fillore, edhe në nivelin e arsimit të mesëm gjermanishtja vjen si gjuhë e dytë e huaj më e kërkuar në Maqedoni. Konkretisht, nga viti i parë deri vitin e katërt 19.262 nxënës mësojnë gjermanisht, 17.004 frëngjisht, 896 turqisht, 838 italisht, 249 rusisht dhe 66 gjuhë të tjera.

Te lista e lëndëve fakultative kryeson mësimi i italishtes me 494 nxënës. Edhe në këtë kategori, rusishtja është gjuhë më pak e kërkuar me vetëm 13 nxënës edhe atë që të gjithë viti i katërt.

Që një familje të fitojë të drejtën brenda vitit të fiton edhe një rrogë plus në vlerë totale prej 500 eurove nevojitet që brenda një muaji për konsum të përgjithshëm të shpenzojë 16.700 denarë ose 200 mijë denarë brenda një viti

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 5 qershor - Një qytetar duhet të harxhojë brenda vitit 200 mijë denarë (16.700 denarë në muaj), ose rreth 3500 euro, në mënyrë që shteti t'i kthejë 30.000 denarë në

## KTHIMI I TVSH NGA QYTETARËT

# RRITJE E BUXHETIT FAMILJAR DHE KONSUMIT

formë të TVSH. Kjo është masa më e re që planifikon ta aplikojë Qeveria e Maqedonisë, që ishte edhe premtim parazgjedhor i LSDM-së për kthimin e TVSH qytetarëve. Kthimi i 15 për qindëshit për qytetarët do të startojë nga janari i vitit 2019, ndërsa në përgatitje e sipër janë ndryshimet e reja ligjore dhe për momentin kjo masë është duke u testuar në tri komuna apo rajone.

Zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev, thotë fillimisht se Projekti për kthimin e TVSH për personat fizik, është lëshuar në qarkullim si pilot projekt

në disa komuna. "Sa i përket projektit për kthimin e TVSH-së për qytetarët bëhet fjalë për projekt i cili kur të fillohet me zbatimin nuk do të ketë efekte negative as në buxhet por as tek qytetarët. Mendoj se mirë është që njëherësh të fillohet si projekt pilot në disa komuna", sqaroi Angjushev.

Shpjegimet më të hollësishme që vijnë nga Ministria e Financave bëjnë të ditur se bëhet fjalë për projekt i cili tani po testohet në disa komuna dhe nëse tregohet funksional dhe jep efektet e pritura atëherë nga 1 janari i vitit 2019

do të duhet të zbatohet në të gjithë territorin e Maqedonisë.

"Me këtë masë Qeveria dëshiron që qytetarëve t'iu sigurojë të hyra plotësuese apo edhe një rrogë vjetore plus në vlerë prej 30.000 denarë për çdo familje. Kthimi TVSH-së prej 15 për qind nga pagesa e TVSH-së do të jetë për qytetarët që do të shpenzojnë për konsum të përgjithshëm brenda një viti, njëherësh do të jetë një stimul plus për ekonominë e vendit sepse kështu do të rriten shpenzimet individuale të qytetarëve që dhe njëherazi paraqet segmentin më të lartë për mbushjen e buxhetit",

thonë nga Ministria e Financave.

Ndërkaq në bazë të llogarive të para të bëra nga Ministria e Financave nëse një familje arrin të shpenzojë më shumë se 200 mijë denarë, apo 16.700 denarë brenda një muaji, atëherë e fiton të drejtën që në fund të vitit shteti t'i kthejë 500 euro.

"Pra çdo familje që për konsum të përgjithshëm do të harxhon për një vit kalendarik rreth 3500 euro shteti do t'i kthejë 15 për qindësin e TVSH-së apo 500 euro. Realizimi i kësaj mase do të shkojë përmes kartelave pagesore", thonë nga Ministria e Financave.

Banorët janë të indinjuar me Qeverinë, komunën, me partitë shqiptare të cilët nuk bënë asgjë për të realizuar premtimet që i dhanë publikisht

FSHATI POROJ VAZHDON TË JETË NË RREZIK

# NJË VIT NGA PËRMBYTJET, ASNJË PREMTIM NUK U MBAJT

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 5 qershor - Një vit më parë, pikërisht më 5 qershor, kishte vërshuar lumi në fshatin Poroj. Vërshimet ishin përsëritur dy vite pas përmbytjeve katastrofale të vitit 2015. Përveç pastrimit dhe urës që u ndërtua nga ana e Armatës së Maqedonisë, në terren nuk është punuar asgjë. Sot e kësaj dite, çdoherë kur ka reshje atmosferike, rreziku për përmbytje ekziston, por edhe një vit pas premtimeve nuk është bërë asgjë. Situata është e njëjtë, shtrati i lumit ka mbetur i papastruar, ndërsa ishte premtuar se në vitin 2018 do të fillohet me rregullimin. "Një vit pas vërshimeve, situata shihet se çfarë ndryshimi ka, edhe ajo hera e dytë çka erdh ngeli këtu dhe tash jemi në këtë gjendje. Edhe pse morëm shumë premtime, si nga pushteti lokal dhe nga ai qendror, gjatë vizitës që na bëri Zaevi atë kohë, ai premtoi se 2018-ta do të jetë vit i punës... Vit ky në të cilin do të ndërmerren të gjitha masat për pastrimin e shtratit të lumit brenda fshatit dhe punët tjera lartë me digat që do të duhej të ndërtoheshin që të parandalohen vërshimet tjera



siç kishim në 2015 dhe 2017. Tani jemi të frikësuar se nëse ndodh që të përsëriten vërshimet, do të jetë shumë më rrezik se shtrati i lumit si brenda fshatit po ashtu edhe poshtë është i mbushur i gjithë", tha Sulejman Ramadani, kryetar i Bashkësisë Lokale të fshatit Poroj.

Banorët janë të indinjuar me Qeverinë, komunën, me partitë shqiptare të cilët nuk bënë asgjë për të realizuar premtimet që i dhanë publikisht.

"Është pastruar atëherë pak, nuk mund të themi se aspak nuk është pastruar, por është pastruar

në disa pjesë dhe për momentin është pastruar fusha poshtë dhe këtu mbi urë dhe na thanë se do të pastrohet komplet ashtu si duhet të jetë. Ajo që është më me rëndësi - rregullimi i digave të prishura që janë lartë, si dhe ndërtimi i digave të reja si në bjeshkë, në fshatin

Xhermë dhe më poshtë, nuk duken askundi. Të paktën ne nuk jemi të informuar për asnjë lloj pune që kanë ndërmarrë qeveria apo komuna. Duket që nuk ka asgjë, edhe pse ne shpresuam shumë nga kjo qeveri se do të arrihet do të bëhet diçka, megjithatë po shihet se partitë tona duan vetëm që të jenë pjesë e qeverisë dhe jo pjesë e popullatës", shprehet Ramadani.

Tani, banorët si alternativë kanë vetëm protestat. "Tanimë i kemi humbur të gjitha shpresat dhe nuk e di se çfarë do të bëjmë. Një pjesë e banorëve mendojnë se duhet të protestohet njëjtë sikurse vitin e kaluar kur bllokuam rrugën. Një pjesë e banorëve edhe tani janë të mendimit që sërish duhet të dilet në protesta", theksoi ai. Përndryshe, edhe ura në rrugën kryesore Tetovë-Jazhincë është e dëmtuar dhe nuk është e sigurt, kurse dhe përkundër premtimeve asgjë, nuk është bërë në këtë drejtim. Ura ishte tejet e dëmtuar dhe fillimisht ishte rekomanduar për më shumë kujdes, kurse sot e kësaj dite aty qarkullojnë me mijëra automjete brenda ditës.

## Shkupi nuk ka ingerenca për dislokimin e përmendoreve!

Shkup, 5 qershor - Kryetari i Shkupit, Petre Shilegov, deklaroi se Qyteti i Shkupit për fat të keq nuk ka ingerenca në dislokimin e ndërtimeve pa leje dhe se konform legjislacionit kjo kompetencë është në Komunën Qendër. "Pres se organet kompetente në procedura përkatëse do t'i marrin vendimet dhe konform atyre më tej do të jetë statusi i atyre ndërtimeve pa leje", tha Shilegov, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve në shënimin global më 5 Qershor - Ditës Botërore të Mjedisit të Jetesës në Parkun e Qytetit në Shkup. Sipas tij, projekti "Shkupi 2014" dhe paligjshmëria e tij është e dukshme dhe shtoi se për këtë kanë folur edhe kur kanë qenë në opozitë. "Qyteti i Shkupit nën ingerenca të veta ka jashtëzakonisht pesë përmendore, prej të cilave tashmë një e larguam, ndërsa për të tjerat në vijim është procedura. I kemi edhe ato galerë përbindësh në shtatin e lumit Vardar për të cilat tashmë udhëheqim procedurë, ndërsa unë duhet të mbaj llogari edhe për mjetet buxhetore të Qytetit të Shkupit", tha Shilegov. Ai bëri të ditur se një nga një i zgjedhin problemet të cilat, siç tha, janë shtresuar tejet shumë, por nuk do të heqim dorë nga konsistenca.

NË FUND TË QERSHORIT PËRFUNDON PUNIMET

## Gati rehabilitimi i autostradës Shkup-Tetovë

Shkup, 5 qershor - Intensivisht po punohet në rehabilitimin e aksit të autostradës Shkup-Tetovë, i cili është në gjatësi prej 17 kilometra. Deri më tani janë rehabilituar edhe asfaltuar nëntë kilometra, ndërsa deri në fund të qershorit pritet të përfundojnë punët në njërin anë të autostradës nga Shkupi në drejtim të Tetovës. Dje inspektim në kryerjen e rehabilitimit të korsisë në aksin e autostradës Saraj - Grupçin kanë bërë ministri i Transportit dhe Lidhjeve Goran Sugareski, zëvendësministri i Transportit dhe Lidhjeve, Sadik Beqiri dhe drejtori i NP "Rrugët Shtetërore", Zoran Kitanov, "Rikonstruktimi i aksit ishte i domosdoshëm, për shkak se korsia lëvizëse ishte pjesa më e dëmtuar nga autostrada në drejtim të Tetovës, ndërsa të gjithë jemi të vetëdijshëm sa automjete në ditë kalojnë në këtë aks. Për këtë nevojitet intervenim urgjent me qëllim që plotësisht ta rehabilitojmë dhe të mundësojmë që trafiku të zhvillohet më i sigurt", deklaroi ministri Sugareski. Ai shtoi se në pjesën perëndimore po investohet përmes gjysmë miliardë euro për ndërtimin dhe rikonstruktimin e Korridorit 8. "Krahas rikonstruktimit të autostradës nga Shkupi deri në Tetovë, në gjy-



smën e dytë të vitit 2018 përmes Ndërmarrjes Publike për Rrugë Shtetërore do të shpallet tender për projektimin për rikonstruktimin e rrugës nga Tetova deri në Gostivar në nivel të autostradës standarde. Ndërkohë po punohet në rikonstruktimin e rrugës shtetërore nga Gostivari deri në Kërçovë, me vlerë të përgjithshme të investimit prej gjashtë milionë euro, ndërsa në vijim është edhe projektimi për ndërtimin e autostradës së re nga Gostivari deri në Kërçovë dhe gjithësesi vazhdojmë me ndërtimin e auto-

stradës nga Kërçova deri në Ohër", theksoi ministri i Transportit. Sugareski potencoi se përmes programeve të ndryshme të NPRRSH punohet edhe në rehabilitimin e akteve të tjera rrugore. Drejtori i NP "Rrugët Shtetërore", Zoran Kitanov potencoi se punohet në rehabilitimin e 17 kilometrave të aksit të autostradës në vlerë prej 70 milionë denarë. Për rikonstruktimin e këtij aksi rrugor janë siguruar 1,1 milionë euro nga Buxheti i NP "Rrugët Shtetërore". Punët ndërtimore kanë filluar në nëntor të vitit 2017.



SIMPOZIUM PËR MENAXHMENT NË ART

# TËRHEQJA E PUBLIKUT KËRKON KREATIVITET DHE STRATEGJI

"Po ballafaqohemi me resurse të kufizuara, shije të ndryshueshme të publikut, intensitet të vogël të vëmendjes me mediat e sotme sociale. Edhe në SHBA institucionet kulturore mundohen të vijnë deri tek publiku dhe bilanci pozitiv në llogaritë e tyre, por gjithmonë duhet të kërkojnë mënyra kreative se si të fitojnë publik. Nuk mundet vetëm të rrini dhe të prisni publiku të vijë tek ju...", tha ambasadori amerikan

Koha

Evis HALILI

Shkup, 5 qershor - Duhet të kërkon mënyra kreative për ta përfutur publikun, të keni prirje sipërmarrëse, të mendoni në mënyrë strategjike dhe të planifikoni dhe të keni menaxhment financiar të plotë që të mund të ndjeheni të realizuar në kushtet e sotme, pasi kultura është sferë e garës dhe konkurrencës, porositi ambasadori Xhes Bejli në hapjen e simpoziumit dyditor për menaxhment në art.

Ngjarja u mbajt dje dhe sot në Shkup, në organizim të Ambasadës së SHBA-së në Maqedoni, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe "Lokomotiva" - Qendrën për nisma të reja në art dhe kulturë në Shkup. Në praninë e rreth tetëdhjetë punonjësve të kulturës dhe ekspertëve nga Maqedonia, ambasadori amerikan theksoi se kudo menaxhimi është i vështirë për sektorin e Kulturës, pa dallim, siç tha, nëse bëhet fjalë për SHBA-në apo Maqedoninë.

"Po ballafaqohemi me resurse të kufizuara, shije të ndryshueshme të publikut, intensitet të vogël të vëmendjes me mediat e sotme sociale. Edhe në SHBA institucionet kulturore mundohen të vijnë deri tek publiku dhe bilanci pozitiv në llogaritë e tyre, por gjithmonë duhet të kërkojnë mënyra kreative se si të fitojnë publik. Nuk mundet vetëm të rrini dhe të



## QENDËR E RINOVUAR PËR FËMIJËT ME AUTIZËM NË FUSHË TOPHANË

Qendra ditore e rinovuar për fëmijët me autizëm në Fushë Tophanë, siguron trajtim psikosocial dhe mbështetje për fëmijët dhe punë këshillëdhënëse me prindërit e tyre. Qendrën ditore do ta vizitojnë 90 fëmijë dhe ata do të marrin shërbime individuale prej edukatorëve specialë, logopedëve dhe punonjësve socialë, ndërsa e njëjta do të funksionojë në dy turne prej orës 8:30 deri në orën 19. Në hapjen e qendrës mori pjesë ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Mila Carovska. Rinovimi, siç kumtuan nga MPPS, është rezultat i bashkëpunimit të përbashkët mes Qendrës ndërkomunale për punë sociale të Qytetit të Shkupit, Shoqatës së qytetarëve "Imago Plus" dhe IP "Entit për rehabilitimin e fëmijëve dhe të rinjve" - Shkup, ndërsa KB Shoqata e parë pensioniste dhe Digit Ekspres MM SHPKNJ siguruan materiale didaktike dhe lojëra për fëmijë të cilët do ta vizitojnë qendrën.

prisni publiku të vijë tek ju... Në kërkimin e burimeve për financim është e rëndësishme t'i shtyni njerëzit të marrin pjesë në këshilla drejtues, që do t'u mundësonte menaxherëve në artet të marrin ide të ndryshme për menaxhmentin, për menaxhimin me financat dhe kjo do të ndihmonte që të përforcohen këto institucione", tha Bejli, i cili ndau përvoja se pse edhe vetë është rritur në familje e cila, tha, është e involvuar në artet. Ai nnvizoi se Maqedonia ka shumë gjëra të cilat mund t'i ofrojnë në hapësirën e Kulturës, të cilat aspak nuk janë hulumtuar. Ndonjëherë benefiti fitohet edhe prej një shenje të vendosur në shtegun e lokalitetit, duke e potencuar shembullin me Kokinën, ku vitin e kaluar janë vendosur udhëzime dhe shenja për lëvizjen e vizitorëve.

Në fjalimin hyrës Bejli tha se një prej forcave të SHBA-së është ajo që nuk ka Ministri të Kulturës, por ka shumë organiza-

ta kushtuar artit dhe kulturës, agjenci qeveritare të cilat kanë role konkrete në realizimin e kulturës. "Ky është dallim i rëndësishëm, pasi ne nuk e shohim kulturën si diçka që qeveria duhet të merret dhe kjo ide është futur në qasjen tonë të përgjithshme drejt veprimtarisë së kulturës. Edhe krahas asaj që nuk kemi Ministri të Kulturës, ajo është shumë e zhvilluar, pasi institucionet e artit dhe kulturës e përmirësojnë jetën shoqërore dhe performancat ekonomike. Një muze apo një sallë koncertesh, për shembull, janë në mesin e vendeve më të njohura që njerëzit i vizitojnë", tha ambasadori Bejli.

Ministri i Kulturës, Asaf Ademi, për të cilin kjo ishte ngjarja e tij e parë zyrtare, theksoi se prioritet i Ministrisë është involvimi dhe përmirësimi i bashkëpunimit në nivel kombëtar në sferën e Kulturës.

"Me këtë simpozium do të kemi vizion të mirë për menaxhimin e ardhshëm të institucioneve kulturore, bashkëpunim midis sektorit qeveritar dhe joqeveritar. Ky simpozium do të ndihmojë edhe të fitohen njohuri prej praktikave më të mira për procesin e decentralizimit dhe zhvillimin e kulturës në nivel lokal. E gjithë kjo do të kontribuojë për zhvillimin e kulturës. Jam i bindur se simpoziumi do t'u mundësojë menaxherëve tanë të jenë në hap me rrjedhat botërore dhe se do të ndihmojë për realizimin më të lehtë të politikave të qeverisë për krijimin e kulturës së qëndrueshme, e vendosur prej të gjithëve dhe për të gjithë, e cila do t'i ndjek nevojat e të gjithë qytetarëve", tha Ademi.

## KRONIKË

### Ndalohen 18 "valltare" në Saraqinë dhe në Tetovë

Në aksione të policisë që janë zbatuar të hënën mbrëma në objektet hotelierike në fshatin Saraqinë dhe në Tetovë janë gjetur dhe ndaluar shtetase të huaja nga Serbia, Mali i Zi dhe nga Shqipëria për shpërdorim të lejes së qëndrimit turistik dhe punës të paligjshme. Në objektin hotelierik në Saraqinë, pronësi e AM (36) kanë gjetur tetë femra prej të cilave dy shtetase të Maqedonisë, katër nga Serbia, një nga Mali i Zi dhe një nga Shqipëria. Në objektin hotelierik në Tetovë, pronësi e M.B. (37), janë gjetur 10 persona, prej të cilëve gjashtë janë shtetase të Maqedonisë, dy shtetase nga Serbia dhe dy turiste nga Shqipëria. "Për shkak të keqpërdorimit të lejes së qëndrimit turistik dhe punës së paligjshme të gjitha shtetaset, si dhe dy turiste nga Shqipëria, janë ndaluar në Stacionin policor të Tetovës dhe më pas i janë dorëzuar Sektorit për shkelje kriminale, emigracion, të huaj dhe riadhesim në Tetovë për procedurë të mëtejshme", informojnë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

### Shkup, 9 aksidente për 24 orë

Në territorin e Qytetit të Shkupit në 24 orët e fundit kanë ndodhur nëntë aksidente në të cilat një është me lëndime të rënda trupore, në tre aksidente pjesëmarrësit kanë marrë lëndime trupore, ndërsa pesë janë vetëm me dëme materiale. Sipas raportit policor të SPB Shkup, 61 shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, 44 shoferë janë përjashtuar nga komunikacioni nga të cilët tetë për shkak të drejtimit të automjetit në ndikimin e alkoolit, 23 pa e marrë të drejtën e drejtimit të automjetit motorik, gjashtë shoferë fillestarë... Nga komunikacioni policia ka përjashtuar 20 automjete edhe atë për shkak të parregullsive teknike dhe 17 sepse ishin të paregjistruara. Në mënyrë të parregullt janë parkuar 234 automjete, ndërsa karrotreci ka marrë 73 automjete.

### Godet shtyllën elektrike, katër të lënduar

Në bulevardin e "Ilindenit" në Tetovë, të hënën rreth orës 08.00, veturë e tipit "BMW" me targa të Tetovës, e drejtuar nga 25-vjeçari A.Sh. nga fshati Reçicë e Vogël, ku për shkak të shpejtësisë së papërshtatshme, ka humbur kontrollin dhe është përplasur në një shtyllë elektrike dhe në një dru dekorativ në hapësirën e gjelbërt. Nga përplasia e veturës, katër bashkudhëtarët në veturë të mashave prej 16, 24, 33 dhe 34 vjeç nga fshati Reçicë e Vogël dhe Tetova, me lëndime trupore, janë dërguar në Spitalin klinik të Tetovës ku janë ndaluar për shërim nën observim të mëtutjeshtëm. (U.H)

## ATY KU DO TË ZBULOHEK KRIM, DO TË BASHKËPUNOJMË ME PSP

Ministri i Kulturës, Asaf Ademi, nuk është hollësisht i njoftuar me raportin për parregullsitë në punën e Ministrisë së Kulturës në vitin 2016, që para katër ditëve e publikoi Enti shtetëror për revizion, por theksoi se janë të hapur për bashkëpunim me PSP-në dhe institucionet kompetente. Dita e parë e punës së tij në funksionin ministër sot ishte simpoziumi për menaxhim të kulturës, organizuar nga Ambasada e SHBA-së në Maqedoni. Në një deklaratë për mediat tha se dje ditën e ka kaluar duke u njoftuar me të punësuarit në Ministri dhe se ende nuk është futur në materien, për, siç tha, t'i shqyrtojë dokumentet siç duhet. "Por ne jemi të hapur për të gjitha institucionet. Prokuroria speciale publike është e mirëseardhur t'i shqyrtojë të gjitha dokumentet. Jam takuar me një përfaqësues të PSP-së, i cili dje ishte në Ministri. Unë do të vazhdojë, e kjo është politikë edhe e Qeverisë, kudo që zbulohet krim, të jemi të hapur për bashkëpunim me PSP-në, si dhe me institucionet tjera", deklaroi Ademi.

# Otomanët në Cannes dhe Venecia

Nga  
Veton SURROI



1. Pashë që Agron Demi, drejtor i Institutit GAP dhe njëri prej zbrërthyesve më të mirë të realitetit socio-ekonomik të Kosovës, ishte bërë nervoz me veprimin e fundit të Qeverisë, emërimin e koordinatorëve. "Pasi u tejnep administrata shtetërore me ministra, zëvendësministra, agjenci... tash Qeveria Haradinaj e ka nisur një rend të ri të pozitave të larta shtetërore: atë të KOORDINATORËVE.

Koordinatorë që emërohen në pozita që do të duhej të mbulohehin nga ministrat ose nga zëvendësministrat. Pas emërimit të koordinatorit për Çështjet e Rinisë dhe koordinatorit Nacional për Administratë Shtetërore, sot qenkan emëruar edhe koordinatori për Ndryshime Klimatike dhe koordinatori për Kulturë, Rini dhe Sport. Tash kjo nuk ndalet derisa të emërohet nga një koordinator për secilën fushë. "Koxha injorant duhet me qenë e mos me u ba nervoz me këtë kërdi që është ka bahet në taksat tona".

Hapi i ardhshëm logjik, të cilin duhet ta ndërmarrë Qeveria dhe me të cilin do të bëhet edhe më tepër nervoz Agron Demi është se duhet të emërohen koordinatori për koordinimin e koordinatorëve, dhe, meqë një njeri nuk mund ta bëjë atë, atij i duhen së paku dy zëvendëskoordinatorë, dhe, meqë këta tre zyrtarë të lartë nuk mund ta bëjnë, duhet të vendoset Zyra e Koordinimit të koordinatorëve në nivel kombëtar. Pas këtij hapi të ardhshëm logjik, ai i ardhshmi logjik është që koordinimi, si aktivitet i rëndësishëm shtetëror, të zbresë në nivel të pushtetit vendor, pra të kemi koordinator komunal të kulturës (që do të koordinojë aktivitetin kulturor në bashkësi lokale) e kështu me radhë.

2. Ekziston logjika për këto veprime dhe ajo kaqherë është gjetur në nevojën, natyrisht dhe aftësinë, e burokracisë që ta riprodhojë dhe ta rrisë veten. Ekziston tërë një fushë serioze e hulumtimit të riprodhimit të burokracisë dhe ekziston po ashtu një formulim, me ftohtësinë e humorit britanik që tërë këtë e shpjegon me një fjali: "puna zgjerohet për aq sa ta mbushë kohën e dhënë për ta kryer". Nëse një punë mund të kryhet për një orë, por afati për ta kryer atë punë është një ditë, atëherë puna do të zgjerohet për aq sa ta përmbushë ditën e dhënë si afat.

Ky quhet ligji i Parkinsonit, sipas C.N. Parkinsonit që e shkroi këtë si fjalinë e parë në esenë humoristik

të botuar në "The Economist" më 1955. Ky ligj tashmë ka formatin e vet kosovar: "Puna e Qeverisë zgjerohet për aq sa ka njerëz të vet për të punësuar si anëtarë qeverie". Do të thotë, nëse puna e Qeverisë, për shembull, është të ndihmojë kulturën dhe për ta bërë këtë nevojitet një buxhet dhe tre njerëz të punësuar, atëherë puna e Qeverisë për të ndihmuar kulturën do të zgjerohet për aq sa këtë gjë ta bëjnë 103 të punësuar. Dhe buxheti i kulturës është aty për të mbuluar nevojat e qeverisë për zgjerim.

Mjafton të shihen skenat e përsëritura të festivaleve ndërkombëtare të artit, Berlinale, Cannes e Venecia. Pjesë ndihmëse e kulturës do të jetë prania e zyrtarëve shtetërorë, disa prej të cilëve kulturës nuk i kanë rënë pranë as në formulimin "kaloi afër shtëpisë së kulturës".

3. Problemi është pak më i ndërlikuar se kaq. Ky ligj vlen për shtetet evropiane. Ligji i Parkinsonit u lind në kohën e rënies së Perandorisë britanike, kur po ashtu me humor u konstatua fenomeni paralel i zvogëlimit të Perandorisë britanike dhe rritjes së burokracisë për ta administruar atë. Një drejtues i një perandorie tjetër, Mihail Gorbaçov, për-

mendi se Ligji i Parkinsonit është bukur i çmuar në Bashkimin Sovjetik. Nuk do mend, sundimi i këtij ligji do t'i ketë ndihmuar rënies së asaj perandorie.

Por, Kosova është e veçantë meqë është një shtet paraevropian. Nuk është paraevropian pse nuk është pjesë e Bashkimit Evropian; të këtillë nuk janë, për shembull, Republika e Maqedonisë apo Mali i Zi, por ato janë shtete evropiane. Kosova është paraevropiane, sepse ende nuk ka mbërritur të ketë funksionet e shtetit social, që është determinues thelbësor i shtetit evropian të shekullit XX. Pra, nuk të kualifikon si evropian të qenit në BE, të kualifikon nëse ke apo jo sigurim social, sigurim shëndetësor e pensional, sistem arsimor që prodhon fëmijë që dinë të kuptojnë ato që lexojnë.

Këtu Kosova ka dështuar plotësisht. Për 20 vjet pas çlirimit Kosova nuk ka arritur të bëjë asnjë të arritur fundamentale në shtetësi evropiane, por ka gjashtëfishuar numrin e zëvendësministrave. Identifikimi i shtetit, rrjedhimisht, nuk është me sigurinë që e jep shteti, por me sigurinë që ua jep shteti pjesëtarëve të feudit qeverisës, diçka që otomançe u shpërnda në të gjitha gjuhët e të

**Ligji kosovar i Parkinsonit: punët e Qeverisë zgjerohen për aq sa ka nevojë të punësohen pjesëtarët e feudit**




sunduarve si bashibozukë.

Kosova, pra, është shtet paraevropian i cili gjendet ende nën primesat otomane. Kështu është vështirë të aplikohet madje një ligj si i Parkinsonit.

4. Ndoshta kështu është më lehtë e kuptueshme kultura e qeverisjes në Kosovë. Ajo mund të jetë thellë e ingranuar në besimin otoman se shteti është një thes i pafund të mirash për pushtetarin dhe feudin e tij. Dhe ky besim mund të dalë në sipërfaqe edhe më dramatike kur rajaja, (plebsi otoman) do të kopjojë zotërinë otoman, dhe si në rastin tonë, mendon se zotëri otoman bëhesh automatikisht nëse shkon në Venecia e Cannes dhe Berlinale, apo sikur një çetë e organizuar cubërie zë hotelet e Sofjes me çdokënd që vlerëson se duhet të identifikohet si zotëri i ri otoman në Samitin Evropian dedikuar Ballkanit.

Për këtë nuk nevojitet analiza socio-ekonomike. Nevojiten kujtimet e Eqrem Bej Vlorës në pjesët pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Aty raja e porsaliruar do të synojë të bëhet brenda ditësh sunduesi i ri i të gjitha feudeve të rishpërndara të një shteti që ende e ka të vështirë të bëhet. (koha.net)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Gocë Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 5 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

# Si të lirohet biznesi nga kthetrat e politikave jokreative?



Nga Mr. Delvina KËRLUKU

Në një udhëkryq të madh është gjendur i tërë Ballkani Perëndimor në dy dekadat e fundit. Ky rajon është ballafaquar me shumë barriera, por edhe me sfidat e adaptimit që kërkon procesi i integrit, kjo edhe për shkak të ndryshimeve të shpejta të trendit botëror. Përpyekjet e Maqedonisë për bashkëpunimin rajonal mes vendeve fqinje të Ballkanit Perëndimor, kanë hapin e zhvillimit ekonomik, integritit gjithnjë dhe më tepër, në fushën e infrastrukturës rrugore, hekurudhore por edhe doganore me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të njerëzve dhe mallrave. Këtë rrugë e ka lehtësuar edhe asistencë financiare nga Bashkimi Evropian, qoftë edhe në programet e edukimit. Bashkëpunimi rajonal nuk është rrugë pa sfida, por mbetet kusht i BE-së që të krijohet një bashkëpunim i vendeve të rajonit me shpresë se anëtarësimi në familjen e madhe europia-

ne do të jetë më i shpejtë. Përfitimet e këtij anëtarësimi në fushën e ekonomisë do të jenë: rritja e vazhdueshme e shtimit ekonomik nga konsumi dhe rikuperimi i investimeve, rritja e standardit dhe mirëqenies njerëzore, reduktimi i numrit të papunëve, rënia e varfërisë, etj...

Integrimi ekonomik është një ndër prioritetet dhe rëndësi e madhe në zhvillimin ekonomik të vendeve të Ballkanit. Raportet e Bankës Botërore mbi Ballkanin Perëndimor tregojnë se vendet e rajonit kanë nivel të zhvillimit ekonomik të njëjtë dhe pikërisht mbi këto fakte bazohet rritja dhe zhvillimi i bashkëpunimit ekonomik. Kur përparon ekonomia paraqet një ekonomi të plotë dhe është me efikasë në fushat e tjera, të cilat ajo ndikon. Biznesi, respektivisht këmbimet tregtare, veçmas rritja e eksportit sipas raporteve, tregon se Maqedonia me mundësitë dhe pozitën që ka ndaj BE-së ka përmirësime. Por

Aftësia e institucioneve shtetërore do të duhet të shënojë krijim më efikas të partneritetit me sektorin e biznesit për zvogëlimin e barrierave në qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe bashkëpunim mes institucioneve si të vendit ashtu edhe jashtë tij.

nëse kategorizojmë bizneset brenda vendit, mbetet diskutabile zhvillimi dhe zgjerimi i bizneseve shqiptare, në përkrahjen nga ana e shtetit ose institucioneve, odave ekonomike të vendit.

Reformat ekonomike vendimtare, shtimi i prodhimit nga ana e bizneseve në Maqedoni, konkur-

renca e drejtë, liria e tregtisë ndërkombëtare do të mundësonte që Maqedonia të rrit këmbimin tregtar, bashkëveprimin në fushëveprimin e njëjtë të biznesit me bizneset e rajonit dhe institucionet ndërkombëtare. Për të arrit bizneset këtë qëllim duhet angazhim dhe mbështetje nga ana e organeve shtetërore të vendit, odave ekonomike, por në përgjithësi edhe përkrahja e të gjithë shoqërisë, të cilët lehtësojnë rrugën e depërtimit e këmbimit të mallrave në tregjet e jashtme. Sepse, shtrirja e Maqedonisë në integritet ekonomike rajonale është rruga e duhur ndërkohë që angazhimet dhe fuqizimi i fushës së biznesit paraqet shtyllën më të rëndësishme të zhvillimit dhe përparimit të vendit. Zhvillimi i bizneseve të vendit me përkrahjen e shtetit intensifikon bashkëpunim mes bizneseve dhe bashkëpunim ekonomik me shtetet anëtare të BE-së. Kjo lidhje ndikon në rritjen e eksportit të mallrave të tyre në tregun

e BE-së. Rritja e eksportit të produkteve dhe shërbimeve rrit dukshëm shtimin ekonomik të këtyre vendeve. Pikërisht, edhe për rritjen e standardit dhe mirëqenies të qytetarëve eksporti si dhe faktorët e tjerë të zhvillimit ekonomik sigurojnë shtimin dinamik të Prodhimit të brendshëm Bruto (PBB) si një ndër treguesit kryesor makroekonomik për të matur rritjen ekonomike. Që bizneseve tu jepet hapësirë të depërtojnë në tregjet e jashtme, nevoja për reformimin e shtetit nuk duhet të ndalet tek kufijtë shtetëror. Veprimtaria e biznesit, e cila bëhet e ndërvarur, implikacionet i hasë të fqinjët e vet dhe më gjerë, e nuk do të nevojitet në vendin e vet. Prandaj, aftësia e institucioneve shtetërore do të duhet të shënojë krijim më efikas të partneritetit me sektorin e biznesit për zvogëlimin e barrierave në qarkullimin e lirë të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe bashkëpunim mes institucioneve si të vendit ashtu edhe jashtë tij.

## SHBA-të nxisin përçarjen e Evropës



Nga Ines POHL

Gjermania është e revoltuar. Vetëm pak orë pas publikimit të një interviste të ambasadorit të SHBA në Gjermani, Richard Grenell, janë shtuar zërat që ai të dëbohet nga vendi. Shkaku: në një bisedë me portalin e djathtë të internetit Breitbart njeriu i Trumpit pati deklaruar se ai synon të forcojë forcat konservatore në Evropë, të cilat janë kundër establishmentit. Pasazhet e intervistës, në të cilat ai flet për shumicën e heshtur, për mirëqenien e njerëzve që punojnë normalisht, kritikën për politikën aktuale ndaj refugjatëve dhe në tërësi për qëndrimin mendjemadh të elitave politike, ai mund t'i përsërishte edhe në një aktivitet të partisë konservatore të djathtë AFD -duartrokitjet do t'i kishte të sigurta. Kjo në një kohë kur nuk është hera e parë, që Grenelli përzihet në mënyrë kaq të drejtpërdrejtë në fatet e Gjermanisë. Pa ardhur mirë në post, ai u kërkoi firmave gjermane që të tërhiqen nga bizneset me Iranin. Sfondi për këtë kërkesë është grindja transatlantike për marrëveshjen atomike me Iranin.



**Ambasadori i ri i SHBA në Gjermani bën të ditur se do të përzihet direkt në politikën evropiane dhe e shkakton një skandal. Por revoltimi megjithatë do të ishte përgjigjja e gabuar**

### E PADËGJUAR DERI TANI

Me të vërtetë, deri më sot nuk qe dëgjuar që një ambasador të përfshihet në mënyrë kaq të drejtpërdrejtë në politikën e vendit, në të cilin e kanë dërguar. Deri tani detyra ka qenë më tepër shpjegimi i vendit nga vjen, ndërtimi i urave, paqëtimi i konflikteve. Por ai që nxehet tani dhe habitet që Grenelli e përkufizon krejt ndryshe detyrën e tij, ende nuk e ka kuptuar si duhet që me këtë President në Shtëpinë e Bardhë gjithçka është tjetër. Edhe biznesi i deritashëm diplomatik.

Trumpi është biznesmen, që vjen nga biznesi i spektaklit, ku i ka

arritur atje sukseset më të mëdha të tij. Kuptimi i tij për politikën nuk është "arti i së mundurës", siç e ka përcaktuar atë dikur kancelari i parë i Rajhut, Otto von Bismarck. Si të gjithë populistët, Trumpi dhe njerëzit e tij janë të interesuar që të arrijnë efektin më të madh. Kur Grenelli flet në Gjermani për migrim zinxhir dhe kur lëvdon njëkohësisht politikanin e pakompromis austriak Sebastian Kurz, e di mirë se çfarë po bën. Ai synon të inkurajojë ato forca në Evropë, të cilat e sfidojnë si Trumpi rendin ekzistues. Ai ua drejton këtë intervistë kryetarëve nacionalistë të djathtë të shteteve si për shembull në Hungari dhe në Poloni. Pra ua drejton atyre, që shprehin dyshim për Evropën në formën e saj të tanishme.

### SYNOHET TË DOBËSOHET KOHEZIONI I BE

Me shkathtësi Grenelli shfrytëzon - si shefi i tij në vendin e tij - për këtë jo vetëm frikërat e njerëzve, për të pasur sukses. Ai shfrytëzon edhe dobësitë e sistemit, për të provokuar një rend të ri në kon-

tinëtin e vjetër. Një rend, i cili ta dobësojë kohezionin e BE dhe që të jetë në këtë mënyrë në radhë të parë në dobi të Amerikës.

Tonet e larta, shqetësimet dhe kërkesat për dorëheqje nuk mjaftojnë për t'iu kundërvënë kësaj strategjie të dobësisë të BE. Në këtë garë për tonet më të larta, do të fitojë gjithmonë Trumpi. Gjermanisë dhe partnerëve të saj evropianë nuk i mbetet gjë tjetër veçse të pranojë që Donald Trumpit nuk mund t'i besosh më. Që përkundrazi, ai jo vetëm e kërcënon Evropën me luftë tregtare, por madje dërgon edhe njërin nga diplomatët e tij kryesorë për të përsheptuar përçarjen e Bashkimit Evropian.

Ndaj kësaj forme të re të raportit transatlantik mund të ketë vetëm një përgjigje: një marrëveshje e qartë për të ardhmen e Evropës, në të cilën ta gjejnë vendin e tyre jo vetëm vendet e mëdha, por edhe të voglat. Sado e hidhur që të jetë: për momentin, ish-aleatja SHBA është kthyer në një rrezik, që nxit përçarjen. Pas kësaj interviste për këtë nuk ka më dyshim. (DW)



## Pushime hallall në Turqi

Industria turke e turizmit prej 26 miliardë dollarësh është goditur nga frika e sigurisë dhe mosmarrëveshjet politike gjatë viteve të fundit, por një cep i tregut po rritet në heshtje - pushimet në plazh për myslimanët konservatorë. Dhjetëra hotele dhe vendpushime në brigjet e Turqisë, ofrojnë pishina dhe plazhe të ndara për burrat dhe gratë për të përmbushur kufizimet fetare

në modesti, po tërheqin familje nga Turqia, Lindja e Mesme dhe komunitetet myslimane në Perëndim. "Në dy vitet e fundit ka pasur një bojkot të Turqisë si një destinacion turistik, por ne kemi parë një turizëm miqësor hallall që lulëzon gjatë gjithë kësaj periudhe", tha Ufuk Secgin i halalbooking.com, i cili promovon festat ndërkombëtare islame.





## Konsumimi i vezës mbron zemrën tuaj

Kërkimet e fundit sugjerojnë se konsumimi i një veze në ditë mund të zvogëlojë shanset për t'u prekur nga sëmundjet e zemrës. Ata që konsumojnë mesatarisht vezë pesë herë në javë janë rreth 12 % më pak të prirur për të vuajtur nga sëmundjet e zemrës.

Studiuesit nga Qendra Shëndetësore e Universitetit të Pekinit dhe Universiteti i Oksfordit shqyrtuan lidhjet mes konsumit të vezëve dhe sëmundjeve kardiovaskulare. Ata kanë vërejtur stilin e të ushqyerit të më shumë se 400,000 njerëz të shëndetshëm në Kinë, të moshës nga 30 deri në 79 vjeç. Në fillim të studimit, 13,1 për qind e pjesëmarrësve raportuan se hëngrën një vezë çdo ditë, ndërsa 9,1 për qind thanë se ato rrallë ose nuk bënë kurrë.

Ata që hanin një vezë në ditë ishin të lidhur me një rrezik më të ulët të sëmundjes kardiovaskulare në përgjithësi. "Zbulimet tona japin prova shkencore në lidhje me konsumin e vezëve për të përmirësuar shëndetin e zemrës", tha njëri nga studiuesit. Vezët janë të larta në proteina, vitamina, minerale dhe acide yndyrore esenciale.

## Vitaminat që duhen për çdo problem shëndetësor

Tëksa shumë prej nesh janë të vetëdijshëm mbi përfitimet nga kremrat dhe serumet për lëkurën, shumë pak dimë se vitaminat që gjenden brenda disa ushqimeve na ndihmojnë për problemet me shëndetin. Ka qindra mënyra për të ushqyer flokun, lëkurën, thonjtë dhe të parandalojmë çrregullimet, flokun e hollë dhe thonjtë e thyer. Ekspertët e bukurisë dhe lëkurës rekomandojnë çdo vitaminë për çdo problem shëndetësor. Ndiqni

më poshtë:

- Zinku është shumë i rëndësishëm për të ndihmuar lëkurën të mos dëmtohet. Ushqime të pasura me zink janë farat e kungullit, hudhra, qiçrat dhe farat e shalqirit.

- Për thonjtë e thyer duhet patjetër biotina, ose e njohur ndryshe vitamina B7. Rekomandohet e verdha e vezës, mishi viçit, salmوني, avokado, bishtajat dhe qumështi që thonjtë të jenë të fortë.

- Omega 3 për flokë të dobët.



Ajo gjendet me shumicë tek farat chia, vaj peshku si salmوني.

- Vitaminë K për të luftuar

plakjen. Këtë e gjejmë tek perimet e ushqimet e tjera të fermentuara si lakra turshi, kefiri etj.

## ÇFARË I BËN TË LUMTUR DELFINËT?



Shkencëtarët që punojnë me delfinët në një park detar pranë Parisit kanë tentuar të matin se si kafshët ndihen në lidhje me aspektet e jetës së tyre, kur janë të mbyllur. Në atë që shkencëtarët thonë se është projekti i parë për të shqyrtuar robërinë "nga perspektiva e kafshëve", ekipi vlerësoi se cilat aktivitete delfinët kishin më shumë qejf.

Ata gjetën se gjitarët detarë më shumë shijonin ndërveprimin me

një njeri që është familjar për to. Rezultatet, thonë ata, tregojnë se "lidhjet e mira njeri-kafshë janë të barabartë me mirëqenien". Studimi, i botuar në revistën "Applied Animal Behavior Science", ishte pjesë e një projekti trevjeçar për të matur mirëqenien e delfinëve në një mjedis të mbyllur.

Kryetarja e grupit të shkencëtarëve, Dr. Isabella Clegg punoi në Parc Astérix, një park i cili mban

akuariet më të mëdha të delfinëve. Me kolegët e Universitetit të Parisit, ajo krijoi eksperimente për të deshifruar sjelljen e delfinëve, duke vëzhguar pozicionet fizike për të parë se si ndiheshin kafshët.

"Në donim të kuptonim se çfarë aktivitete delfinët pëlqenin më shumë", tha Dr Clegg për BBC. Për ta bërë këtë gjë të funksionojë, ajo ka testuar tri aktivitete: një trajner që vjen dhe luan me delfinët, duke

vënë lodra në pishinë, dhe lënie të lirë të delfinëve. "Rezultati ishte vërtet befasisht, të gjithë delfinët presin me padurim të bashkëveprojnë me dikë që është familjar për to", tha Dr Clegg. Kafshët filluan të hidheshin mbi sipërfaqe duke shkuar vazhdimisht në drejtim të trajnerit. Delfinët gjithashtu do të rrisnin nivelin e aktivitetit në pishinë dhe do të shpenzonin më shumë kohë në cep të pishinës.

## Lopa Penka duhet të theret pasi që kaloi kufirin ilegalisht

Autoritetet bullgare kanë urdhëruar që Penka të theret. Arsyeja: E drejta europiane ndalon kthimin e një kafshe të gjallë nga një vend që nuk është anëtar i BE-së



lopa gjendet nga një bujk serb, i cili e identifikon si lopë bullgare dhe ia kthen sërish pronarit në Bullgari. Por, gëzimi i bujkut Haralampiev nuk ka zgjatuar shumë, pasi

autoritetet bullgare kanë urdhëruar që Penka të theret. Arsyeja: E drejta europiane ndalon kthimin e një kafshe të gjallë nga një vend që nuk është anëtar i BE-së, në

Unionin Europian. Një veteriner bullgar ka dëshmuar se Penka është në gjendje të shkëlqyeshme shëndetësore. Por, autoritetet nuk e kanë ndërmend të lëshojnë pe,

edhe pse Penka është në muajin e gjashtë të shtatzënisë. "Jemi duke e zbatuar të drejtën europiane", thuhet në rrethet autoritative bullgare, përcjell Albinfo.ch. Bile edhe as apelet e qytetarëve nuk kanë mundur t'i ndryshojnë gjerat.

"Helmimet e mundshme dhe sëmundjet në vendngjarje nuk mund të përjashtohen, prandaj edhe duhet pak më tepër kohë për të vendosur. Nuk mund të konstatohet që ditën e parë nëse një lopë është e shëndoshë. Jeta e njerëzve është në radhë të parë, ka pohuar një zëdhënës.

Në të kaluarën, kafshët e importuara nga jashtë BE-së gjithnjë kanë shkaktuar sëmundje të ndryshme. Për atë rregullat në këtë drejtim janë aq të rrepta. Penka është një viktimitë e një ligji që në vetvete është i drejtë. Thjesht, ajo është fatkeqe dhe së shpejti pritet të theret.

Një ditë e ngrohtë verore në Bullgari, jo larg fshatit Kopilovci, në afërsi të kufirit me Serbinë. Bujku Ivan Haralampiev ka qenë duke e shoqëruar kopenë e lopëve në livadhe, kur papritmas lopa me nofkën Penka tremeb dhe largohet nga kopeja duke kaluar kufirin në Serbi, një vend që nuk i takon Bashkimit Europian. Atje

# ÇKA PËRMBAN MARRËVESHJA HISTORIKE PËR KOSOVËN E SERBINË?

Qeveria e Kosovës kërkon mbështetje nga Kuvendi për një platformë finale në bisedimet me Serbinë. Partitë opozitare e kundërshtojnë këtë platformë dhe nuk duan që bisedimet t'i udhëheqë Presidenti Thaçi

Kuvendi i Kosovës tashmë e ka përcaktuar si pikë të rendit të ditës platformën e qeverisë së Kosovës, e cila e parasheh fundin e dialogut me Serbinë me arritjen e një marrëveshjeje ligjërish të obligueshme për të dyja palët, rikujton DW.

E përmes një marrëveshje finale me Serbinë, që është normalizimi i plotë i raporteve, Kosova synon të sigurojë heqjen e pengesave të krijuara për anëtarësimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, në Bashkimin Evropian dhe strukturat e organizatat tjera ndërkombëtare. Për të hyrë në këtë fazë finale të dialogut dhe për ta arritur këtë marrëveshje me Serbinë, në Kosovë po kërkohet një "Grup Uniteti", ku do të përfshihej edhe opozita. Grupi do të kryesohej nga Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi. Ky i fundit, obligohet që në baza të rregullta ta informojë Kuvendin e Kosovës për bisedimet që zhvillohen në Bruksel.

Mirëpo akoma pa u diskutuar në Kuvend, kjo platformë u kundërshtua nga partitë politike opozitare. Është Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) partia më e madhe opozitare që nëpërmjet një deklarate për medie, tha se "Platforma për dialog, e prezantuar në Kuvendin e Kosovës nga ana e Qeverisë së Kosovës, është dokument i përgatitur dobët, joserioz, me pretendime jokushtetuese dhe si të tillë nuk do ta votojë".

Edhe partia tjetër opozitare Lëvizja Vetëvendosja është shprehur



kundër platformës së qeverisë për bisedime me Serbinë, ku fazën finale do ta udhëhiqte Presidenti Hashim Thaçi. E ky i fundit, po ashtu edhe kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj, janë pajtuar që duhet hyrë në fazën finale të dialogut me gjasë me një "kompromis" me Serbinë, por nuk jepen detaje se për çfarë "kompromisi" është fjala.

Kryeministri i Ramush Haradinaj, tha se Kosova do të pranojë pajtimin me shtetin e Serbisë në këmbim të njohjes së pavarësisë së Kosovës, por sipas tij, Kosova nuk i harron krimet e bëra nga Serbia, ndonëse ai nuk ishte në gjendje të thotë nëse gjatë këtij viti do të ndodhë një marrëveshje pajtimi me Serbinë.

Ndërkohë, mediet në Serbi shkruajnë se Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq tashmë e ka "refuzuar" një plan amerikan për Kosovën, duke e cilësuar atë si të padinjtitshëm. Mirëpo ky plan nuk është konfirmuar nga Vuçiqi ndonëse vet Presidenti i Serbisë disa herë ka deklaruar se "propozimin e bashkësisë ndërkombëtare për çështjen e Kosovës tashmë e ka në tavolinë".

## KATËR SHTYLLAT E MARRËVESHJES HISTORIKE

1. Asociacioni i Komunave serbe bëhet me kompetenca të gjëra dhe me kompetenca të shtuara në fu-

ni. shën e shëndetësisë, arsimin e kulturës.

2. AKS do të jetë i lidhur ngushtë me nënkryetarin e Qeverisë së Kosovës që do të vinte nga radhët e komunitetit serb.

3. Beogradi pritet t'i mundësojë Kosovës hyrjen në organizatat ndërkombëtare, para së gjitha në OKB.

4. Nëse pala serbe pranon këtë pako, Serbisë do t'i mundësohej hyrja në BE, e SHBA-ja do t'i garantonte asaj përkrahje ekonomike e diplomatike në arenën ndërkombëtare, shkruan e përditshmja serbe "Večernje Novosti".

## SA ËSHTË I MUNDUR KOMPROMISI?

Por sa është i mundshëm në këto rrethana kompromisi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, për të arritur në një marrëveshje finale pajtimi? Blerim Burjani, analist politik i tha DW-së, se synimet e palëve tashmë dihen, Kosova synon vend në OKB dhe në fund njohje nga Serbia, ndërsa, kjo e fundit përmes Asociacionit të Komunave Serbe kërkon hise brenda territorit të Kosovës.

"Tash kompromisi është problematik për të dy palët. Kosova nuk mund të copëzohet dhe të jetë shtet jo funksional, edhe pse Serbia pretendon që asociacioni të jetë plotësisht i pavarur nga institucionet e Kosovës", thotë Blerim Burja-



## Shtetet e BE-së kërkojnë përfshirjen në dialog

Shtete anëtare të Bashkimit Evropian kërkojnë që të përfshihen në fazën përfundimtare të dialogut mes Kosovës e Serbisë i cili do të çonte në një marrëveshje ligjërish obliguese për një normalizim zë plotë të marrëdhënieve, ka mësuar Radio Evropa e Lirë, edicioni në gjuhën serbe.

Siç kanë thënë burimet evropiane, shtetet anëtare kanë nisur të shfaqin shqetësimin e tyre në lidhje me mungesën e transparencës rreth dialogut politik, veçanërisht në kapitullin që ka të bëjë me marrëveshjen përfundimtare. Kjo u theksua qartë të premten e kaluar, në takimin ku përfaqësuesit e shërbimit të politikës së jashtme të BE-së gojarisht njoftuan përfaqësuesit e vendeve anëtare për procesin e dialogut. Burimet nga ky takim kanë konfirmuar për REL-in, transmeton Koha.net, se shtetet anëtare nuk janë të kënaqura me faktin se janë të përjashtuara tërësisht nga ky proces. Siç sqarojnë burimet diplomatike, ekipi që udhëheq dialogun në Bruksel në asnjë moment nuk konsulton shtetet anëtare, madje as ato që konsiderohen të mëdha apo më të rëndësishme.

Një prej hapave për të cilët aktualisht po bisedohet është ideja që kjo çështje të përfshihet në konkluzat përfundimtare në Samitin e qershorit ku shefat e shteteve dhe të qeverive të BE-së do të diskutojnë për mundësitë në Ballkanin Perëndimor. Një burim diplomatik ka konfirmuar për REL-in se po punohet në atë drejtim që njëra nga pikat në konkluzat përfundimtare është kërkesa që të "përfshihen" edhe shtetet e BE-së në përgatitjen e marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë.

## Miratohet rezolutë për unifikim doganor me Shqipërinë

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar rezolutën për unifikimin doganor ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë.

Këtë rezolutë e ka propozuar Grupi parlamentar i Partisë Socialdemokrate, e cila është mbështetur nga 76 deputetë.

Përfaqësuesit e këtij subjekti

politik kanë ftuar Qeverinë që të angazhohet sa më shpejt për realizimin e kësaj rezolute që do të lehtësojë qarkullimin e mallrave në mes Kosovës dhe Shqipërisë, duke i dhënë shtytje zhvillimit ekonomik të të dyja vendeve.

Kuvendi i Kosovës, ka miratuar dhe një tjetër rezolutë për heqjen

e tarifave të roming-ut në telekomunikim ndërmjet këtyre dy vendeve.

Deputetët sot miratuan edhe rezolutë në lidhje me gjendjen jo të mirë të rinisë kosovare dhe votuan pro rekomandimeve nga debati parlamentar në lidhje me Kartonin e Gjellbër.



# KATARI MODEL SUKSESI NË NJË RAJON TË TRAZUAR

Për shumë njerëz, fjala Lindje e Mesme ngjall imazhe trazirash e dhune. Për vende si Siria kjo gjë mund të jetë e saktë, por në realitet Lindja e Mesme është shtëpia e një larmie të gjerë njerëzish dhe kulturash, përfshirë disa udhëheqës botërorë në fusha biznesi, arsimit dhe mjekësisë.

Ndoshta në krye të listës është vendi i vogël dhe i pasur me naftë i Katarit. I vendosur në rajonin e Gjirit përgjatë Iranit dhe i kufizuar me tokë nga Arabia Saudite dhe me det nga Emiratet e Bashkuara Arabe, Katarit është bërë një pikë qendrore e përparimit arab, krenarisë dhe, çuditërisht edhe pakënaqësisë arabe. Që kur deklaroi veten si shtet i pavarur në vitin 1971, Katarit u zhvendos shpejt nga statusi i "vëllait të vogël" midis shteteve të Gjirit, në një udhëheqës rajonal.

Në vitin 1995, Hamad bin Khalifa Al Thani pasoi babain e tij si Emir të Katarit. Ai dhe gruaja e tij e dytë, Sheikha Moza bint Nasser Al Mised, krijuan një vizion për vendin e tyre që përfshinte një standard minimal të jetesës, mundësi arsimore, kujdes shëndetësor të nivelit botëror dhe një ekonomi të fortë dhe të larmishme. Krijimi i një vizioni të rritjes së fortë dhe suksesit në vetvete nuk është diçka e pazakontë. Ekzekutimi i atij vizioni me saktësi dhe shpejtësi është gjë shumë më e rrallë.

Katarit ofron liri civile për gratë në një mënyrë që shumica e shteteve arabe kurrë nuk e kanë lejuar. Këtë fakt e dëshmon edhe roli i madh i Sheikha Moza në përcaktimin e axhendës kombëtare. Ajo kryeson bordin e Fondacionit të Katarit për Arsimin, Shkencën dhe Zhvillimin e Komunitetit, dhe ajo nuk është simbolike në atë post.

Nën udhëheqjen e saj, Katarit ka zhvilluar Qytetin Arsimit në Doha, që përfshin kampuset e disa prej universiteteve më prestigjioze të botës, mes tyre Georgetown, Texas A & M, Carnegie Mellon, Northwestern dhe Weill Cornell Medical Col-



lege. Fondacioni i Katarit ka kontribuar në krijimin e Qendrës së mjekësore dhe kërkimore të Sidrës, një qendër e nivelit botëror, e cila është e para e këtij lloji në rajon. Spitali kryesor i dedikohet grave dhe fëmijëve dhe ka 400 shtretër.

Angazhimi i qeverisë për edukimin, kujdesin shëndetësor dhe mirëqenien e përgjithshme të popullit është vizionar, por ndoshta edhe më mbresëlënëse është fakti se dy vjet më parë Katarit dhuroi 10 miliardë dollarë për programet humanitare zhvillimore në të gjithë botën. Pothuajse gjysma e parave është shënjestruar për nismat e edukimit për të ndihmuar në frenimin e përhapjes së ekstremizmit dhe dhunës.

Katarit nuk është pa probleme, më e dukshme nga të cilat është kriza diplomatike me shtetet e tjera arabe të Gjirit.

Katër nga këto vende, Arabia Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Bahreini dhe Egjipti, nisën një bllokadë ndaj Katarit më Qershor 2017, ndërkohë që lëshuan një listë me 13 kërkesa që duhet të plotësohen për të hequr bllokadën. Midis kërkesave ishte kufizimi i lidhjeve diplomatike me Iranin; shkëputja e lidhjeve të supozuara me organiza-

ta terroriste; mbyllja e rrjetit televiziv Al Jazeera me bazë në Doha dhe e financuar nga Katarit; pagimi i dëmshpërblimeve për çështjet e kaluara; ndërprerja e ndërhyrjes në çështjet e brendshme të vendeve fqinje; dhe një kërkesë që Katarit të rregullojë politikën e saj ekonomike dhe të sigurisë me fqinjët e saj arabë.

Është një listë e mbushur plot absurditete dhe që "pikon" ironi.

Bllokada e udhëhequr nga Sauditët e ka detyruar Katarin të rrisë tregtinë dhe komunikimin me Iranin. Kërkesat për të respektuar sovranitetin e të tjerëve në fakt nuk janë gjë tjetër veçse një përpjekje për shkeljen e sovranitetit të Katarit. Al Jazeera mund të jetë e papërshtatshme, por gëzon një audiencë mbarëbotërore prej më shumë se 200 milionë shikues dhe vetëm shërbimi i saj në gjuhën angleze fitoi çmimin "Transmetuesi i Vitit" në Festivalin Ndërkombëtar të Nju Jorkut & Film Gala për të dytin vit radhazi.

Kjo (lista e kërkesave) është një stërvitje e vogël xhelozie dhe jo diplomaci aktuale, gjë që u ekspozua qartazi kur Emiratet e Bashkuara Arabe kërkonin që Katarit të heqë dorë nga Kupa e Botës FIFA 2022, që

është një nga ngjarjet sportive më të mëdha dhe më të spikatura në botë.

Shkëlqesia e saj Lulua Al Khater, zëdhënëse zyrtare e Ministrisë së Jashtme të Katarit, vuri në dukje se kur filloi bllokada "Katarit nuk kishte marrëdhënie diplomatike me Iranin".

"Katarit i preu lidhjet me Iranin në solidaritet me Arabinë Saudite në vitin 2016, dhe merreni mend se çfarë!? Në 2017, ishte Arabia Saudite ajo që i vendosi bllokadë Katarit dhe jo Iranin" tha ajo. "Ishte Iranin që na dha një vendkalim, vendkalimi i vetëm që kemi prej fqinjëve tanë...".

E pyetur nëse Doha mbështet ndonjë organizatë terroriste, qoftë Al Qaeda, Vëllazëria Myslimane, Shteti Islamik, Hamasi apo Hezbollahu, zj. Al Khater ishte e qartë: "Katarit nuk mbështet financiarisht asnjë prej këtyre organizatave... Katarit asnjëherë nuk mbështeti Al Kaedën, kurrë nuk mbështeti Hezbollahun".

Ajo tha se Katarit ka punuar shumë për të kufizuar ndikimin e Hezbollahut në luftën civile në Siri, ndërkohë që disa nga vendet e njëjta që tani i kanë shpallur bllokadë Katarit "nuk kanë luajtur ndonjë rol serioz në këtë gjë".

Ekonomia e Katarit është e fortë,

pavarësisht nga varësia e saj e madhe ndaj naftës, me PBB për frymë në 526 % të mesatares globale. HE Muhamed Al Sada, Ministri i Katarit për Energjinë dhe Industrinë, tha se ka një plan të qartë dhe të bashkërenduar për të diversifikuar ekonominë, përfshirë shtimin e shfrytëzimit të gazit të lëngshëm natyral.

Vitin e kaluar shfrytëzimi i gazit u rrit me 11 % dhe vazhdon të rritet, - tha ministri, "dhe ne po përgatitemi për rritje të vazhdueshme".

Ministri vuri në dukje se vetëm pak vite më parë, 60 % e ekonomisë së Katarit ishte e bazuar mbi naftën dhe gazin. Tani kjo është poshtë 40 % falë përpjekjeve për diversifikimin e ekonomisë.

"Po vlerësojmë mundësitë në projekte petrokimike, ilaçe, pajisje mjekësore. Po shohim edhe industrinë e turizmit, sektorin e shërbimeve, sektorin e ndërtimit etj... Këto janë pjesë të rëndësishme të ekonomisë sonë sot".

Organizimi i Kupës së Botës në Katar është gjithashtu pjesë e vizionit të përcaktuar për herë të parë nga Emiri Baba Hamad bin Khalifa, dhe tani është përshpejtuar nga djalë i tij Tamim bin Hamad Al Thani, Emiri i vendit që nga 2013.

Ajo që e dallon Katarin nga shumica e kombeve është një vizion i qartë dhe një ekzekutim jashtëzakonisht efektiv i atij vizioni. Dëshira për të qenë më i miri, për të investuar në të ardhmen, për të kërkuar ekspertë në çdo fushë nga e gjithë bota dhe për të respektuar traditat e vjetra dhe ndjeshmëritë fetare, ndërsa njëkohësisht përfaqëson botën moderne – nuk është asgjë më pak se e mahnitshme.

Pavarësisht nëse është arkitektura, infrastruktura, mundësitë arsimore, ngjarjet sportive, kujdesi shëndetësor dhe një bibliotekë e re kombëtare, Katarit është i angazhuar qartë për të qenë më i miri./ Washington Times.

## NATO stërvit 18 mijë ushtarë në vendet baltike

NATO ka nisur një stërvitje masive në kufijtë e asaj që konsiderohet rreziku më i madh, Rusisë. Ushtarët e NATO's duke u stërvitur. NATO ka nisur stërvitjen ushtarake të kryesuar nga ushtria amerikane me 18 mijë ushtarë nga 19 vende. Stërvitja e quajtur "Saber Strike 18" do të vazhdojë në

rajon deri me 15 qershor, dhe ka si qëllim të demonstrojë përkushtimin dhe solidaritetin e NATO's në një kohë kur manovrat ushtarake ruse gjithnjë e më shumë po shqetësojnë anëtarët e aleancës në këtë rajon. NATO ka vendosur rreth 6 mijë ushtarë në Poloni dhe vendet baltike, Estoni, Lituani dhe

Letoni.

Ministria e Mbrojtjes e Lituanisë ka njoftuar edhe fillimin e stërvitjes më të madhe ushtarake kombëtare në vend "Stuhia e rrufesë", me rreth 9 mijë ushtarë. Izraeli, i cili nuk është anëtar i NATO's, për herë të parë merr pjesë në këtë stërvitje.



## "Trump-Kim Jong", zbardhen detaje nga takimi i shumëpritur



Shtëpia e Bardhë ka zbardhur orën e takimit mes presidentit Donald Trump dhe liderit të Koresë së Veriut Kim Jong-un. Zëdhënësjë e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders tha se takimi historik do të realizohet në më 12 qershor në orën 09:00 sipas orës lokale në Singapor.

Ajo tha se përgatitjet për samitin vazhdojnë shumë mirë.

"Jemi përgatitur në mënyrë aktive për takimin e 12 qershorit midis presidentit dhe udhëheqësit të Koresë së Veriut," tha Sanders.

"Ndihe mi sikur gjërat po vazhdojnë të ecin përpara, dhe një përparim i mirë është bërë".

Në bazë të nenit 29 dhe nenit 38 të Ligjit për kulturë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 24/07...11/18), nenit 12 të Ligjit për bibliotekat (Gazeta Zyrtare e RM nr. 20/04, 89/08, 116/10, 51/11, 88/15, 152/15, 39/16) dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 9 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e RM nr. 05/2002),  
Kryetari i Komunës së Kavadarit publikon,

### SHPLLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të IPK Biblioteka "Fetkin" – Kavadar

1. Publikohet shpallje publike për zgjedhje të Drejtorit të IPK Biblioteka "Fetkin" – Kavadar.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushte e posaçme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- në momentin e emërimit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

- ka arritur së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të arsimit sipëror,
- ka së paku 5 (pesë) vjet stazh pune në sferën e kulturës ose pesë vjet përvojë pune të punëve ose projekteve në sferën e kulturës në batë të marrëveshjeve të lidhura për vepër,

- Kandidati për drejtor është e domosdoshme të parashtrorë propozim program të vet për punë dhe zhvillim të institucionit për periudhën prej katër vjet.

(vërejtje: kushtin për njohje të gjuhës angleze përmes posedimit të një prej certifikatave të njohura ndërkombëtarisht ose certifikata për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet edhe atë: TOEFL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) së paku niveli B2, FCE (Cambridge English: First) të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2, kandidati i zgjedhur obligohet që ta përmbushë më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit. Drejtorit të cilit nuk do të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës së huaj në afat prej një viti nga dita e emërimit i ndërpritet mandati).

2. Secili kandidat i interesuar duhet të parashtrorë Fletëparaqitje, CV dhe dokumente në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, si dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura.

3. Shpallja publike do të zgjasë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.

4. Kandidatët i parashtrorë dokumentet e nevojshme në pajtim me Konkursin deri te Këshilli drejtues të IPK Biblioteka "Fetkin" – Kavadar.

Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anëtarësh i formuar nga ana e Këshillit Drejtues të IPK Biblioteka "Fetkin" – Kavadar dhe në afat prej 5 ditëve pas përfundimit të shpalljes parashtron propozim të kandidatëve deri te Kryetari i Komunës.

Kryetari i komunës në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së propozimit bën zgjedhjen e drejtorit.

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit dhe i pakompletuar nuk do të shqyrtohet.

KOMUNA E KAVADARIT  
KRYETARI I KOMUNËS  
M-r Mitko Jançev

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strugë, duke vepruar në pajtim me nenin 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 167/2015, 27/2016) dhe nenit 20-g paragrafi 1 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016) publikon

### SHPLLJE PUBLIKE nr. 04-239/1

Për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të pacaktuar

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strugë ka nevojë për punësim për kohë të pacaktuar të 2 (dy) realizuesve.

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strugë

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të njoh gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

1. Nëpunës i pavarur profesional – Jurist në vendin e punës SO030303A05003 në Shërbimin për të drejta për ndihmë në të holla, (1) një realizues.
2. Nëpunës i pavarur profesional – Punëtor i diplomuar social në vendin e punës SO030303A05002 në Shërbimin për shërbime të mbrojtjes sociale, (1) një realizues.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strugë:

- Të ketë 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 shkencat juridike;
- Në mënyrë aktive të njoh programet kompjuterike për punë në zyrë.

Kandidatët e interesuar duhet të parashtrorë Fletëparaqitje, si shoqë të dokumenteve të nevojshme, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter:

- Biografi të shkurtë;
- Letër motivimi;
- Diplomë (certifikatë) për shkallën e mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Certifikatë të shtetësisë.
  - Shuma mujore e neto pagesës: 23.198,00 denarë;
  - Orari javor i punës: prej ditës së hënë deri ditën e premte;
  - Orët e punës në javë: 40;
  - Orari i punës: në mënyrë fleksibile – fillimi prej ora 7:30 deri në 8:30, mbarimi prej ora 15:30 deri në ora 16:30.

Me kandidatën e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet e nevojshme.

Afat për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes.

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrorë në arkivin e IP Qendra

ndërkomunale për punë sociale Strugë, ose përmes postës në adresën:

rr. Dimitar Vllahov pn Strugë (me shenjë për shpallje nr. 04-239/1)

Personi për kontakt: Drejtori Vegim Nura, tel. 070 310-339

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Strugë  
DREJTOR  
Vegim Nura



### FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

#### SHPLLJE

PASQYRË E AKSIONEVE NË PRONË TË FONDIT QË DO TË OFROHEN PËR SHITJE NË BURSËN E MAQEDONISË PËRMES ANKANDIT PUBLIK BURSAR NË TRE DITË RRESHT TË TREGËTIMIT, DUKE FILLUAR NGA 21.06.2018

#### SHITJA E AKSIONEVE TË THJESHTA

| Numër rend. | Shoqëria aksionare | Vendi  | Numri i aksioneve për shitje | Vlera nominale e shoqërisë në EURO | Vlera nominale e kapitalit për shitje (EURO) | Pjesëmarrja e kapitalit për shitje në vlerën e shoqërisë në % | Çmimi fillestar shitës i një aksioni në EURO |
|-------------|--------------------|--------|------------------------------|------------------------------------|--|---|--|
| 1           | SHA OKTA           | Shkup  | 511                          | 43,273,710                         | 26,127                                       | 0.06%   | 65.00  |
| 2           | SHA INTERPROMET    | Tetovë | 18,708                       | 3,579,100                          | 956,540                                      | 26.726%   | 51.13  |

#### SHITJA E AKSIONEVE PRIORITARE

| Numër rend. | Shoqëria aksionare | Vendi  | Numri i aksioneve për shitje | Vlera nominale e shoqërisë në EURO | Vlera nominale e kapitalit për shitje (EURO) | Pjesëmarrja e kapitalit për shitje në vlerën e shoqërisë në % | Çmimi fillestar shitës i një aksioni në EURO |
|-------------|--------------------|--------|------------------------------|------------------------------------|--|---|--|
| 1           | SHA COMA MOLL      | Strugë | 4,994                        | 187,537                            | 25,534                                       | 13.616%   | 5.113  |

Aksionet do të ofrohen për shitje përmes bursës së Maqedonisë në tre ditë rresht të tregëtimit duke filluar nga 21.06.2018. Shitja e aksioneve do të bëhet sipas modelit "të gjitha ose asgjë" me çka aksionet veçmas nga çdo shoqëri do të shiten në pako përmes një transaksioni. Paga do të bëhet në para të gatshme dhe në denarë sipas kursit të këmbimit të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë në ditën e shitjes.

### FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

www.piom.com.mk

Duke vepruar në pajtim me nenin 1 paragrafi 2 të Ligjit për letrat me vlerë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 95/2005, 25/2007, 7/2008, 57/2010135/2011, 13/2013, 188/2013, 43/2014, 15/2015, 154/2015, 192/2015 dhe 23/2016), nenit 84 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 124/2015), Komisioni për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë në vijim publikon këtë:

### LAJMËRIM

Komisioni për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë bën dorëzimin e me publikim publik të akteve që nuk ka arritur t'i dorëzojë edhe atë:

1. Vendimi nr. PRK UP 03-31 e datës 28.03.2018 deri te Shoqëria SKENPOINT SHA Shkup me seli në rr. "Pero Nakov" pn, (Kompleksi MZT), 1000 Shkup.

Ftohet personi i lartpërmendur që në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit të këtij lajmërimi të paraqitet në lokalet e Komisionit për letra me vlerë të Republikës së Maqedonisë së dhe të marrë aktin e lartpërmendur.

VËREJTJE: Palët paralajmërohen se mënyra e këtyllë e parashtrimit konsiderohet si e rregullt, ndërsa secila pasojë që mund të dalë do ta bartë vet pala.

Numër 03-345/1

30.05.2018

Shkup,

Komisioni për letra me vlerë të  
Republikës së Maqedonisë  
Kryetar  
M-p Nora Aliti



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
Universiteti "Shën Kiril dhe Metodi" – Shkup  
Fakulteti për elektroteknikë dhe teknologji informatike



Në bazë të nenit 172 dhe 176 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2008) dhe nenit 51 të Rregullores për marrëdhënie të brendshme dhe punën e Fakultetit për elektroteknikë dhe teknologji informatike në përbërje të Universitetit "Shën Kiril dhe Metodi" në Shkup, dekani i Fakultetit për elektroteknikë dhe teknologji informatike ka sjellë vendim për publikim

### KONKURS Për zgjedhje në thirrje

Publikohet konkurs për zgjedhje të

1. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët në sferën mësimore – shkencore: **10900-matematika**,
2. Një mësimdhënës në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore për lëndët në sferat mësimore – shkencore: **20409 – matjet dhe instrumentet dhe 21300 metrologjia**, (zgjedhja është për kohë prej 5 vjet)
3. Nga një asistent për lëndët nga sferat mësimore-shkencore:
  - 3.1. **20200 – elektroteknika**
  - 3.2. **21208 – teknologjitë kompjuterike dhe inxhinieria** (zgjedhja është për kohë prej 3 vjet)

Kushtet: Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme dhe kushtet tjera në pajtim me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kiril dhe Metodi" dhe akteve të tjera të Universitetit dhe Fakultetit.

Së bashku me kandidatët duhet të parashtrorë: dokumente për arsim të mbaruar, biografi të shkurtë, Deklaratë për përmbushje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme nga vendi i punës, formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, dokumentet me të cilat dëshmohet përmbushja e kushteve listë për punimet profesionale dhe shkencore, nga një kopje të punimeve, vërtetim për njohje të gjuhës së huaj dhe certifikatë të shtetësisë.

Orari i punës është në pajtim me orarin e orëve në semestër, ndërsa paga do të varet nga angazhimi mësimor në semestër.

Fletëparaqitjet me dokumentet e kompletuara parashtrorë në arkiv të Fakultetit, ose përmes postës në adresën rr. Rugjer Boshkoviq 18 – Shkup.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Nga FETI





**MINISTRIA E MBROJTJES**  
REPUBLIKA E MAQEDONISE

Sipas nenit 39 nga Ligji për Shfrytëzim dhe Disponim me Pronat e Organeve Shtetërore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 78/15, 106/15 dhe 153/15, 190/16 dhe 21/18) dhe Vendimit për Dhënie me Qira të Pronave të Patundshme: nr. 44-2980/1, 44-2982/1, 44-2985/1, 44-3170 dhe 44-8296/1-17 nga data 20.03.2018 44-3108/1 nga data 10.04.2018 и 44-3946/1 nga data 02.05.2018 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 53 dhe 54/18) Vendimi i ministres së mbrojtjes nr. 02-3505/1 nga data 28.05.2018, Komisioni për Pasuri të Patundshme dhe Pasuri të Tundshme i Ministrisë së Mbrojtjes, shpall

**THIRJE nr. 01/2018**

për dhënie me qira të pronave të patundshme përmes ankandit publik - hapësira afariste përmes ofertave publike elektronike

1. Lëndë e shpalljes janë dhënia me qira e pronave të patundshme – hapësira afariste të përcaktuara me Vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për dhënie me qira të pronave të patundshme nr. 44-2980/1, 44-2982/1, 44-2985/1, 44-3107 dhe 44-8296/1-17 nga data 20.03.2018, 44-3108/1 nga data 10.04.2018 dhe 44-3946/1 nga data 02.05.2018 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 53, 54/18, 68/18 dhe 84/18) dhe me Vendimin e ministres së mbrojtjes nr. 02-3505/1 nga data 28.05.2018, si vijon:

| Nr. Ren. | Të dhënat e kadastrës mbi pasurinë e patundshme   | Sipërfaqja m <sup>2</sup> | Vlera e parashikuar në denarë | Qiraja fillestare mujore në denarë pa TVSH | Afati i qirasë |
|----------|---|---------------------------|-------------------------------|--|----------------|
| 1.       | rr. A. Dimovski në Shkup, numri i ndërtesës 3, hyrja 1, kati PR, numri 1, qëllimi i një pjese të veçantë/të përbashkët të ndërtesës HA, si më poshtë: HA1, HA 2, 01 dhe WC1, me sipërfaqe të brendshme 114m <sup>2</sup> , nr. 747 / 1, KK Kisela Voda 2, LP nr. 105974 CM Kisela Voda 2, pronë e Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes | 114                       | 4.589.345                     | 22.947                                     | 7 vjet         |
| 2.       | rr. Josif Josifovski nr. 1 në Manastir, numri i ndërtesës 1, hyrja 1, kati i PR, qëllimi i një pjese të veçantë / të përbashkët në ndërtesën HA me sipërfaqe prej 128m <sup>2</sup> , LP 8968/3, PK nr. 30639 KK Manastir 3, pronë e Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes  | 128                       | 8.733.492                     | 43.667                                     | 7 vjet         |
| 3.       | rr. Partizanska nr. 96 / 98 në Manastir Nr. 1, Hyrja 4, Kati PR, me sipërfaqe 104m <sup>2</sup> , PK Nr. 14618, KK Manastir 3, LP nr. 91955, pronë e Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes  | 104                       | 5.495.640                     | 27.490                                     | 7 vjet         |
| 4.       | Ndërtesa numër 2, hyrja 1, PK 3374/1, KK Kërçovë 6, LP Nr. 2165, në pronësi të Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes  | 324                       | 8.480.235                     | 42.401                                     | 7 vjet         |
| 5.       | Bul. "Çlirimi" pn. në Kërçovë,<br>- numri i ndërtesës 1, hyrja 1, kati PR, numri HA1, sipërfaqja prej 45m <sup>2</sup> ,<br>- numri i ndërtesës 1, hyrja 1, kati PR, numri 1, ndërtesa ndihmëse me sipërfaqe prej 14m <sup>2</sup> . në PK nr. 2094/2, KK Kërçovë 8, LP Nr. 56090, në pronësi të Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes  | 59                        | 2.048.503                     | 10.243                                     | 7 vjet         |
| 6.       | Kantina në kazemën " Kuzman Josifovski Pitu", numri i ndërtesës 28, hyrja 1, kati PR, numri 1, me sipërfaqe prej 128 m <sup>2</sup> , ndodhet në PK numër 727, KK Tetovë 1, regjistruar në Listën e Pronave nr. 14, prone e Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes   | 128                       | 2.375.886                     | 11.879                                     | 7 vjet         |
| 7.       | Shtëpia e ARM-së në Tetovë në rrugën "Boris Kidrich" - në PK nr. 2077, KK Tetovë 1, e regjistruar në Listën e Pronave nr. 6335, prone e Republikës së Maqedonisë, përdorues Ministria e Mbrojtjes me një sipërfaqe totale prej 896 m <sup>2</sup> ,   | 896                       | 83.566.077                    | 417.830                                    | 7 vjet         |

1. Procedura për dhënie me qira të pronave të paluajtshme nga pika 1 e këtij vendimi, kryhet nga Komisioni për Pasuritë e Patundshme dhe Pasuritë e Tundshme të Ministrisë së Mbrojtjes, të themeluar me vendimin nr. 02-768 / 3 të datës 01.03.2018 me përmes ofertimit publik elektronik.

2. Kushtet e veçanta për pjesëmarrje në ofertimin elektronik publik dhe teksti integral i thirrjes për qiradhënie të pasurive të patundshme – hapësira afariste mund të gjenden në faqen e internetit: [e-aukci.financa.gov.mk](http://e-aukci.financa.gov.mk) dhe në ueb faqen e Ministrisë së Mbrojtjes [www.morm.gov.mk](http://www.morm.gov.mk)

Komisioni për Pasuri të Patundshme  
dhe Pasuri të Tundshme i  
Ministrisë së Mbrojtjes



Në bazë të nenit 110, 114, 166, 172, 173, 174, 175, 176 dhe 182 të Ligjit për arsim sipëror, nenit 22 paragrafi 3 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune dhe në bazë të Vendimeve të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit për turizëm dhe biznes logjistikë, Fakultetit për shkenca të medicinës, fakultetit tekniko-teknologjik dhe Fakultetit juridik

**UNIVERSITETI "GOCE DELLÇEV" SHIPT**

Publikon  
**KONKURS**

**Për zgjedhje të mësimdhënësve të njëjësive në përbërje të Universitetit**

**1. FAKULTETI PËR TURIZËM DHE BIZNES LOGJISTIKË**

1.1 Mësimdhënës në të gjitha titujt për sferën mësimore-shkencore:  
-Komunikimi afarist dhe Komunikimet në turizëm - (1 realizues)

**2. FAKULTETI I SHKENCAVE TË MEDICINËS**

2.1. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Pediatria - (1 realizues)

2.2. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Patofiziologjia - (1 realizues)

2.3. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Radiologjia - (1 realizues)

2.4. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Medicina interne - (1 realizues)

2.5. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Gjinekologjia - (1 realizues)

2.6. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Otorinolaringologjia - (1 realizues)

2.7. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
Medicina e punës - (1 realizues)

2.8. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Neurologjia - (1 realizues)

2.9. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Imunologjia - (2 realizues)

2.10. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Neurokirurgjia - (1 realizues)

2.11. Mësimdhënës në titullin titullar Docent titullar/profesor titullar me korrespondencë për sferën mësimore-shkencore:  
-Kardiokirurgjia - (1 realizues)

**Kriteret për zgjedhje:**

-në titullin mësimor-shkencor docent mund të zgjidhet personi i cili: 1. Ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veç e veç, gjegjësisht ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe të dytë, 2. Ka shkallë shkencore doktor shkence nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet, 3. Ka të publikuar së paku katër punime shkencore në publikim referent shkencor në pajtim me këtë ligj në pesë vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje, 4. Ka njohuri të së paku një gjuhë të huaj, të përcaktuar me aktin e përgjithshëm të universitetit, gjegjësisht të shkolës së lartë të pavarur profesionale dhe 5. Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë për arsim sipëror. Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e posaçme nga Rregullorja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

- në titullin mësimor-shkencor profesor me korrespondencë mund të zgjidhet personi i cili: 1. Ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veç e veç, gjegjësisht ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe të dytë, 2. Ka shkallë shkencore doktor shkence nga sfera shkencore përkatëse, 3. Ka të publikuar së paku gjashtë punime të recensuara shkencore në publikim referent shkencor, në pajtim me Ligjin për arsim sipëror në pesë vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje, 4. Ka qenë më herët i zgjedhur në titullin profesor me korrespondencë dhe 5. Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë për arsim sipëror. Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e posaçme nga Rregullorja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

- në titullin mësimor-shkencor profesor i rregullt mund të zgjidhet personi i cili: 1. Ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë, për secilin cikël veç e veç, gjegjësisht ka realizuar sukses mesatar prej së paku 8,00 (tetë) në studimet e integruara të ciklit të parë dhe të dytë, 2. Ka shkallë shkencore doktor shkence nga sfera shkencore përkatëse, 3. Ka të publikuar së paku gjashtë punime të recensuara shkencore në publikim referent shkencor, në pajtim me Ligjin për arsim sipëror në pesë vitet e fundit para publikimit të shpalljes për zgjedhje, 4. Ka qenë më herët i zgjedhur në titullin profesor me korrespondencë dhe 5. Ka aftësi për realizimin e veprimtarisë për arsim sipëror. Kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe kushtet e posaçme nga Rregullorja për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor dhe mësimor të Universitetit "Goce Dellçev" – Shtip.

- Kandidati i cili do të zgjidhet për mësimdhënës në Fakultetin e shkencave të medicinës (nga pika 2.1 deri në pikën 2.11) do të mbajë vendin e punës në institucionin

shëndetësor ku është i punësuar, ndërsa në pajtim me marrëveshjen do të realizojë mësimdhënie në Universitetin "Goce Dellçev" – Shtip (neni 174 të Ligjit për arsim sipëror).

-Personave të cilët kanë themeluar marrëdhënie pune (deri më 15.05.2018) si docent, profesor me korrespondencë, asistent doktorant ose asistent i ri në ndonjërin prej universiteteve në Republikën e Maqedonisë, nuk do të aplikohen kushtet nën pikën 1 (për zgjedhje të profesorit me korrespondencë dhe profesorit të rregullt) gjatë zgjedhjes së tyre në titullin e njëjtë ose më të lartë të mësimor-shkencor.

-Docenti dhe profesori me korrespondencë fakultetit, gjegjësisht akademisë artistike zgjidhen gjatë kohës për pesë vjet (themelohet marrëdhënie pune për kohë të pacaktuar), ndërsa profesori i rregullt në fakultet, gjegjësisht në akademinë artistike me zgjedhjen themelon marrëdhënie të punës për kohë të pacaktuar dhe e mban titullin profesor i rregullt deri në fund të jetës.

-Orari i kohës së punës dhe pagesa:  
-Orari ditor i punës prej 08:30h. deri 16:30h.  
- Orari javor i punës – 40 orë punë (prej ditës së hënë deri në ditën e premte)  
-Neto paga themelore për: Docent -38.143,00 den.; Profesor me korrespondencë - 43.660,00 den.; Profesor i rregullt -50.311,00 den.; Docent titullar -700, 00 den/orë; Profesor titullar me korrespondencë - 800,00 den/orë;

**Dokumentet e nevojshme për kandidatët për zgjedhje në titujt mësimor, mësimor – shkencor:**

- fletëparaqitje;
- diplomë për arsim të mbaruar përkatës – për punim të mbrojtur të magjistraturës/doktoraturës (një kopje të diplomës në original dhe tre kopje të vërtetuara në noter, diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuara me ekuivalencë të notave);
- certifikatë për provimet e dhëna të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve
- biografi të shkurtë (në katër kopje);
- listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale
- nga një kopje të punimeve;
- vërtetim se një prej gjuhëve të huaja
- rekomandim prej së paku 2 (dy) profesorëve (me korrespondencë/i rregullt) nga sfera përkatëse shkencore për të cilin bëhet zgjedhja - për kandidatët për docent;
- rekomandim nga punëdhënësi paraprak (nëse kandidati ka qenë i punësuar) - për kandidatët për zgjedhje docent;
- një kopje të punimit të magjistraturës/doktoratës;
- certifikatë të shtetësisë;
- Konkursi zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afatin e paraparë në nenin 172 të Ligjit për arsim sipëror (deri në 6 muaj nga publikimi i konkursit).

Dokumentet të dorëzohen në arkivin e:

1. Fakulteti për turizëm dhe biznes logjistikë – rr. "7-mi Noemvri" pn, Gjevgjeli; tel. 032-550-350;

2. Fakulteti i shkencave të medicinës – Spitali klinik Shtip rr. "Luben Ivanov" nr. 25 (Departamenti për pediatri); tel. 032-550-400;

3. Fakulteti tekniko-teknologjik – rr. "Miro Baraga" nr. pn. Probishtip; tel. 032-550-180

4. Fakulteti juridik – rr. "Krste Misirikov" nr. 10A – Shtip; Tel. 032-550-450;



Faruk Tasholli/ Düsseldorf

## LIBRA TË VJETËR PËR SKËNDERBEUN PREZANTOHEN NË DÜSSELDORF

Në antikuariate nëpër botë, ka tridhjetë vjet që unë kam blerë libra të vjetër, të lirë, të shtrenjtë dhe shumë të shtrenjtë për Skënderbeun. Tash në koleksionin tim i kam 37 libra të vjetër për Skënderbeun. Gjithashtu edhe mbretëresha e Anglisë, Elisabetha I është lutur për Skënderbeun, për këtë figurë që sfidoi një perandori, tha koleksionistja angleze Patricia Nugge

Bashkësia Shqiptare me seli në Düsseldorf të Gjermanisë, të dieën, me një program kulturor shënoi 550-vjetorin e vdekjes së kryeheroit kombëtar shqiptar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Nga i gjithë programi, për të cilin duhet përgëzuar organizatorin, ishte një pikë e veçantë, madje shumë e rrallë në këso rastesh, hapja e ekspozitës së librave të vjetër nga autorë shqiptarë e evropianë, që nga viti 1596. Ishte ky koleksioni i londinezës së kujdesshme dhe të pasionuar pas figurës së Skënderbeut, Zonjës Patricia Nugge, e cila

edhe pse e moshuar, kishte ardhur pa përtesë nga Londra në Düsseldorf, bashkë me një pjesë të librave treqindvjeçarë.

E lodhur nga udhëtimi dhe nga mosha, me shkopin e saj dhe me ndihmën e zonjës së ambasadorit shqiptar në Danimarkë K.Robo, z. Patricia Nugge, u ngjit në skenën e sallës ku po mbahej manifestimi, duke reflektuar nga sytë e saj pasionin e madh për figurën e Skënderbeut. Duke iu drejtuar publikut shqiptar dhe gjerman, z. Nugge, ndër të tjera tha se nuk dua të flas këtu për jetën dhe bëmat e Skënderbeut, pasi unë nuk jam një historiane, por

thjesht një koleksioniste, e pasionuar për librat që kanë shkruar autorë të vjetër shqiptarë, italianë, spanjollë, portugezë, gjermanë, anglezë, francezë etj, qofshin ata historianë, shkrimtarë, filozofë apo publicistë të kohës, të cilët i ka tërhequr figura dhe epoka e tij. Emrin e Skënderbeut e gjeta derisa isha duke punuar në një librari antike në Londër, kur një lexues kërkoi një libër për të. As që kisha dëgjuar për Skënderbeun. Kërkova ndihmën e bossit im, Mr.Trifo Max, i cili u angazhua të më gjente librin e parë për Skënderbeun dhe kështu filloi njohja ime me këtë figurë, për të cilën hulumtova në vazhdimësi të gjej libra që janë shkruar për jetën e tij. Në antikuariate nëpër botë, ka tridhjetë vjet që unë kam blerë libra të vjetër, të lirë, të shtrenjtë dhe shumë të shtrenjtë për Skënderbeun. Tash në koleksionin tim i kam 37 libra të vjetër për Skënderbeun. Gjithashtu

edhe mbretëresha e Anglisë, Elisabetha I është lutur për Skënderbeun, për këtë figurë që sfidoi një perandori. Në fund të fjalës së saj të shkurtër, z. Patricia Nugge, e përcjellë nga duartrokitjet e të pranishmëve në shenj falënderimi për punën e saj të madhe për Skënderbeun, ftoi ata që ta shikojnë koleksionin, duke sugjeruar që është shumë atraktiv.

Në një kafaz qelqi, libra të vegjël e voluminozë, të ardhur nga një lashtësi, ku shkrimi ishte vështirë të ruhej, mahniti vizitorët, të cilët mezi prisnin t'i afroshin atij koleksioni, asaj pasurie të rrallë historike për kryeheroin kombëtar shqiptar, Skënderbeun. Derisa vizitorët kuriozë i ishin qasur koleksionit, u ndalëm pak për të biseduar me z. Nugge, e cila na tha se këtu ka libra që janë shkruar përpara vitit 1800. Këtu kam sjellë një pjesë të koleksionit tim. Janë libra të shkruar në gjuhë të ndryshme për Skënderbeun dhe nga autorë

të ndryshëm. Secili prej autorëve jep dimensionet e tij të mëdha dhe përcjell historinë e luftës së tij. Emrat e autorëve që unë sjell janë Marin Barleti, që ka edhe veprën më të vjetër, 1510; Frang Bardhin original me "Fjalorin" e vitit 1635; Jean Nicolas Duponcet "Historia e Skënderbeut, mbret i Shqipërisë" 1709; Giovanni Maria Biemi me "Historia e Gjergj Kastriotit, i quajtur Skënderbe" 1742; "Ritrati et logi di capitani illustri", Giulio Rosio 1646; "Scanderbeg: or love and liberty" i Thomas Ehincap 1747; Jean de Busieres me "Scanderbeg, poem" 1656-1658; një vepër nga Andrea Gambini 1652.

Duhet shtuar me këtë rast se koleksionistja londineze e librave antikë për Skënderbeun, gjatë ekspozitave të mëparshme e edhe këtë të së dieles, nuk ka kërkuar asnjë cent kompensim, ose ndonjë shpërblim tjetër, pos mirënjohjes së shqiptarëve, e cila ka qenë dhe është gjithnjë për këtë vepër të saj.

## BOTIMI I ARSIM SPAHIUT, "MBI MITOLOGJINË DHE FENË E MAQEDONASVE TË VJETËR"

"Teza të cilën po e ndjek prej kohësh Dr. Arsim Spahiu nuk është një tezë patriotike, nuk është deklamative, nuk është e nxitur vetëm nga dëshira, që të interpretojmë patjetër vetëm në favor të mullirit tonë, historinë dhe legjendat e lashta, por duket që ka një mbështetje shumë më të gjerë se sa ajo që kemi besuar deri më sot", theksoi Neritan Ceka



hapat e parë të mitografisë shqiptare dhe kjo monografi provon qartë se Pellazgët shumë kohë para heleneve kanë pasur epopetë e tyre luftëtare dhe kombëtare, të cilat, akejtë i kanë shndërruar në epope kombëtare që gjoja i përkasin Greqisë.

Autori në librin e tij të fundit, provon gjithashtu se mitet dhe feja pellazgjike janë njohur në Pellazginë Jugore e më gjerë shumë kohë para arrijtes së grekëve dhe se shumë mite të tjera pellazge të greqizuara i përkasin Pellazgisë, më vonë Shqipërisë. Në këtë botim ka të dhëna të tjera, të vjetra dhe të reja e të padiskutueshme mbi karakterin pellazgjik ose ilir të maqedonasve të vjetër, si dhe provohet që Maqedonia Perëndi-

more dhe Epiri kanë të njëjtat mitologji dhe fe. "Është një kontribut i rëndësishëm për vendin tim, për popullin tim, i cili duhet t'i mësojë këto gjëra. Mitologjia më e vjetër në Europë, është mitologjia e pellazgëve. Grekët e kanë marrë mitologjinë nga pellazgët, fenë nga pellazgët. Kush e thotë këtë?! E thonë 20, 30 dhe 40 autorë dhe Herodoti sidomos. Herodoti ka diku tek 13-14 citime", thekson ndër të tjera Dr. Arsim Spahiu.

Mes shumë personaliteteve të njohur në fushën e arkeologjisë dhe historisë, i pranishëm në promovimin e librit ishte dhe arkeologu, Neritan Ceka tha se ky libër vjen me një metodologji të re dhe se ai nuk shpreh vetëm anën patriotike. "Jemi në një metodologji

të re. Nuk janë më mjetet tradicionale, të cilat janë arkeologjia dhe gjuhësia, të cilët gjithmonë kanë dilemat e tyre. Nuk janë konfirmative në këtë drejtim, por kemi një metodologji e cila mbështetet tek një material tjetër shumë i vlefshëm. Teza të cilën po e ndjek prej kohësh Dr. Arsim Spahiu nuk është një tezë patriotike, nuk është deklamative, nuk është e nxitur vetëm nga dëshira, që të interpretojmë patjetër vetëm në favor të mullirit tonë, historinë dhe legjendat e lashta, por duket që ka një mbështetje shumë më të gjerë se sa ajo që kemi besuar deri më sot", theksoi Ceka.

Ai nuk nguron të shfaqet dhe si mbështetës i linjës së origjinës pellazgo-ilire të shqiptarëve. Ceka e sjell këtë argument, ndonëse ky nuk mbështetet me dëshmi arkeologjike pellazgjike në Shqipëri dhe ai vetë pranon që pellazgët dhe ilirët mbeten dy kufiza të panjohura. "Mendimi i tij është i thjeshtë, pellazgët janë paraardhësit e ilirëve; shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve, kjo është triada të cilën nuk mund ta kundërshtojë askush, por janë të rrallë ata të cilët e atakojnë

mënyrën, mjetet, të themi, metodologjinë për ta zgjidhur këtë trinom, ku kemi një të njohur të vetme dhe ky është elementi ai shqiptar; dy të tjerat ilirët dhe pellazgët mbeten gjithmonë në diskutim qoftë të gjuhësisë dhe qoftë të arkeologjisë", theksoi Ceka.

Pjesëmarrës në promovimin e librit ishte dhe personalitete të njohura të historisë dhe arkeologjisë shqiptare, të cilët kanë referuar mbi librin e Arsim Spahiut, duke vënë theksin në kontributin e rëndësishëm. Të pranishmit vlerësuan si të domosdoshme përkthimin dhe promovimin e librit dhe në gjuhë të ndryshme.

Dr. Arsim Spahiu ka botuar një sërë librash, "Pellazgët dhe Ilirët në Greqinë e Vjetër", një botim i vitit 2005, "Iliriciteti i maqedonasve dhe i epirotëve", botuar më 2006, "Orakulli i Dodonës dhe Epirotët", "Gjuha e Epirotëve", "Shteti Epirot", "Triptik Epirot" (Numismatikë, antropologji dhe pak etnografi epirote), "Maqedonasit e vjetër dhe arkeologjia e tyre", "Gjuha e maqedonasve të vjetër", "Shteti i maqedonasve të vjetër", "Diptik maqedonas" etj.

# PESË FUTBOLLISTË SHQIPTAR NË RUSI

Adnan Januzaj u ftua të hënën nga Belgjika, duke iu bashkuar Valon Behramit, Blerim Xhemailit, Xherdan Shaqirit e Granit Xhakës, të cilët do ta përfaqësojnë Zvicrën. Jashtë Botërorit kanë mbetur Admir Mehmedi, Shkodran Mustafi dhe Riza Durmishi

Kosova dhe Shqipëria nuk arritën ta presin nga një biletë për Kampionatin Botëror. Mirëpo, populli shqiptar si edhe herëve tjera do ta ketë hisen e tij në evenimentin më të rëndësishëm të futbollit botëror. Do të jenë pesë shqipe që do të luajnë në "Rusia 2018", shkruan sot gazeta Zëri. Edhe pse do t'i përfaqësojnë vendet tjera, ata do të jenë ndërkohë ambasadorë të shqiptarëve në Botëror, i cili do të fillojë pas më pak se 10 ditësh.

## JANUZAJ, PRAPË NË BOTËROR

Adnan Januzaj është treguar futbollisti më injorant dhe më përbuzës i popullit shqiptar, në aspektin sportiv. Ai fillimisht kishte bërë lojëra me Kombëtaren shqiptare, ndërsa kapakun ia vuri me Përfaqësuesen e Kosovës, me të cilën luajti si macja me miun, për ta zgjedhur në fund Belgjikën. Ky vendim i tij kishte zgjuar zhgënjim dhe mllef të madh te shqiptarët. Megjithatë, futbollisti i atëhershëm i Mançester Junajtdit në këmbim të zgjedhjes së Belgjikës, ishte ftuar nga kjo Përfaqësuese në Botërorin 2014. Më



pas Januzaj pati rënie në karrierë duke u huazuar në Sanderlend e Borussia Dortmund dhe mbeti pa "Evropianin 2016". Megjithatë, forma e mirë që po e shfaq në Spanjë me Real Sosiedadin ka bërë që trajneri Roberto Martinez ta përfshijë atë në listën definitive prej 23 futbollistëve të ftuar për në Rusi.

"Ai është një talent i madh, mjaft i rrezikshëm në një kundër një. Lojtarët mund ta sjellin freskinë e tyre, posaçërisht në një kundër një. Adnani më ka impresionuar dhe ka bërë përparim në muajt e fundit. Pres shumë nga ai", është shprehur trajneri Martinez. Konkurrenca në mesfushën e Belgjikës është e frikshme, por Januzaj do ta kërkojë ndonjë minutë në këmbët e tij.

## ZVICRA ME KATËR SHQIPTARË

Pa dyshim, Zvicra do të jetë Përfaqësuesja me më së shumti futbollistë shqiptarë, si zakonisht. Valon Behrami, Blerim Xhemaili, Xherdan Shaqiri dhe Granit

Xhaka do të jenë katër shqiptarë që do ta përfaqësojnë ekipin helvetik në Botëror, ndërsa fatin e tyre nuk do ta ketë edhe Admir Mehmedi, i cili duhet ta përcjellë evenimentin "Rusia 2018" vetëm si shikues për shkak të një lëndimi që e pësoi. Kurse Pajtim Kasami, Shani Tarashaj e Florent Hadërgjonaj, që kanë luajtur ndërkohë për Zvicrën, nuk janë ftuar nga trajneri Vladimir Petkoviç.

## MUSTAFI E DURMISHI, JASHTË BOTËRORIT

Në Botërorin e Rusisë pritej të merrnin pjesë më shumë shqiptarë. Sidoqoftë, në fund numri u kufizua në pesë. Kjo nënkupton se të tjerët nuk janë ftuar për arsye të ndryshme. Derisa Admir Mehmedi ishte "viktimitë" e një lëndimi dhe mbeti jashtë listës së Zvicrës, jashtë Botërorit mbetën edhe dy futbollistë shqiptarë. Shkodran Mustafi ishte shpallur kampion bote me Gjermaninë në vitin 2014, ndërsa e kishte përfa-

qësuar këtë vend edhe në "Evropianin 2016". Mirëpo, përzgjedhësi Joakim Lev nuk e ftoi atë edhe në "Botërorin 2018" për shkak të konkurrencës së fortë dhe formës jostabile të lojtarit tek Arsenali. Krahas tij, jashtë mbeti edhe Riza Durmishi të cilin nuk e ftoi trajneri i Danimarkës, Age Gareide. Paraqitjet e mbrojtësit të krahut me ekipin spanjoll Betis nuk e bindën trajnerin danez.

## 31 PËR QIND E EKIPIT TË ZVICRËS ME TË HUAJ

Në "Botërorin 2018" do të marrin pjesë futbollistë të shumtë që janë lindur diku tjetër, por që e përfaqësojnë një vend tjetër. Derisa kësaj liste i prin Maroku me 61,5 për qind, Zvicra gjendet në vendin e katërt me 31 për qind të lojtarëve që e përfaqësojnë, por që janë lindur diku tjetër. Helvetikët përfaqësohen nga katër shqiptarët, Behrami, Xhemaili, Shaqiri e Xhaka, të cilët kanë ndikuar dukshëm që përqindja e zvicranëve të rritet.



## Sampdoria arrin marrëveshje me Berishën

Tek Sallzburgu Valon Berisha shkëlqeu sezonin që lamë pas, por edhe në "Europa League" duke shënuar edhe gola shumë të rëndësishëm e vendimtar në këtë kompeticion. Pas këtij suksesti të arritur për futbollistin nga Kosova kanë shprehur interes shumë klube të mëdha evropiane kryesisht nga Serie A. Sampdoria e ka hedhur hapin e parë, duke arritur një akordim me Sallzburgun në orët e fundit. Por në garë ka qenë edhe ekipi i Lacios. Drejtori sportiv i Lacios, Igli Tare e ka bërë publik pëlqimin për Berishën, që duket se i ka "rrëshqitur" nga duart. "Sky Sport" ka raportuar se Sampdoria ka arritur akordimin me ekipin e Valon Berishës dhe se është duke menduar të riktheje Roberto Soruano, i cili gjatë këtij sezoni ka luajtur për Villarrealin.



## Do ta mund Furyn, kam zemër prej luani

Rikthimi më 9 qershor në ring pas dy vitesh e gjysmë për boksierin britanik Tajson Fury pritet me interes, teksa ka përzgjedhur që të duellojë në këtë sfidë që do të zhvillohet në Mançester ndaj shqiptarit Sefer Seferi. Ky i fundit edhe pse vjen nga pesha "cruiserweight" dhe nuk konsiderohet favorit, beson se do të arrijë ta ndalë ish-kampionin e botës në peshat e rënda, i pamposhtur në ring. "Unë do ta mund Furyn, pasi kam një zemër prej luani. Unë jam një shqiptar dhe ne jemi lindur për të qenë luftëtarë", tha Seferi për mediat britanike, pak ditë para duelit me Fury. Më tej, boksieri shqiptar tha: "Ndoshta nuk do të jem në gjendje ta hedh në tapet, por e di se kam fuqinë për ta mundur me nokaut. Njerëzit mund të thonë çfarë të duan, por unë e kam vërtetuar edhe në të shkuarën forcën time", deklaroi Seferi

## Hysaj pjesë e 100 lojtarëve më të shtrenjtë të planetit

Peformanca e Elseid Hysajit tek Napoli ka bërë që jo vetëm në Itali, por edhe jashtë saj të thuren elozhe në drejtim të lojtarit. Skuadra jugore me Hysajn në mbrojtje është më e sigurt dhe në fakt performanca e shkodranit nuk ka kaluar pa u vënë re. Shpesh kohët e fundit në drejtim të lojtarit janë shfaqur në skenë disa klube me peshë si Atletiko Madridit, Çellsit, Mançester Junajted apo dhe Bajerni i Munihut, të cilët kërkojnë të transferojnë Hysajn në radhët e tyre. Sidoqoftë përtej merkatos, observatori futbollistik me seli në Zvicër ka bërë publike listën e 100 futbollistëve më të shtrenjtë, ku pjesë e saj është mbrojtësi kuqezi. Hysaj mban vendin e 89 dhe vlera e kartonit të tij përllogaritet në 60.1



milione euro. Shkodrani ka lënë pas vetes shumë futbollistë të tjerë cilësorë si Ragja Naingolan, Nemanja Matić, Mesut Ozil, Florentin Toliso dhe Edin Xheko. Gjithashtu pjesë e 'top 100' të futbollistëve më të shtrenjtë qëndrojnë edhe Granit Xhaka në vendin e 74 si dhe Shko-

dran Mustafi në vendin e 94. Vendin e parë e mban Harry Kin i Totenhemit, vlera e të cilit është 200 milionë euro. Pas tij vijnë Nejmar, Mbappe dhe Messi, ndërkohë Cristiano Ronaldo në vendin e 24-t. Vlera e portugezitet kap shifrën e 103 milionë eurove.



**Totenhemi sezonin e fundit vuajti shumë në një pozicion, atë të mbrojtësit të djathtë. Kalimi i Walker tek Mançester Siti krijoi një vakum që nuk u plotësua dot as nga Trippier dhe as nga Aurier, për këtë arsye drejtuesit londinez kanë shënjestruar mbrojtësin e përfaqësueses shqiptare, Elseid Hysajn. Duke iu referuar mediave britanike shkodrani shihet si një hipotezë mjaft e vlefshme dhe trajneri Mauricio Pochettino ka dhënë "ok" e tij për startin e negociatave**



REPUBLIKA E MAQEDONISË  
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nënësive Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nënësive administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

### SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 72/2018

për punësimin e 1 nëpunës shtetëror nga grupi I, nëngrupi 1 „Komunën e Gjorçes Petrovit “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101V04000 Bashkëpunëtor i ri për resurse njerëzore, Njësia për 1 realizues(ë) menaxhimine resurseve njerëzore

#### Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike ose politike
- me ose pa përvojë pune

#### Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arrijte të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësimit strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

#### Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

#### Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00
- Rroga neto: 20.978,00 denarë

**VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonac(e) 1. Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit të Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit të Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësimit administrativ.

Faza e 1 – të: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – të. Ai iniciohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

### SHPLLJE PUBLIKE Për emërimin e drejtorit

Kandidatët për drejtor krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin, është e nevojshme të plotësohen edhe kushtet në vijim:

- të ketë të mbaruar arsimin e lartë
- t'i plotësojë kushtet për mësimdhënës, pedagog ose psikolog në shkollë të mesme,
- të ketë minimum 5 (pesë) vjet përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimorë të verifikuar nga MASH të RM
- të ketë të dhënë provimin për drejtor të shkollës së mesme
- në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- të ketë certifikatë përkatëse, jo më të vjetër se pesë vjet për njohje të gjuhës angleze TOEFL IBT – së paku 30 pikë, IELTS – së paku 3 pikë, BULATS – së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English) – të dhënë
- të ketë të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet
- të mos jetë i dënuar për vepra penale që e bëjnë të papërshtatshëm për kryerje të punës edukativo-arsimorë,
- të jetë shtetas i R. Maqedonisë
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me biografi të shkurtë (CV) dhe letër motivuese
- diplomë/Certifikatë për arsimin e lartë të mbaruar
- dëshmi se kundër kandidatit me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk është shqiptuar dënime ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës të dhen nga organi kompetent (dëshmi që do ta dorëzojë kandidati të jetë i dhënë nga organi kompetent në periudhën kohore deri sa zgjatë shpallja publike).
- vërtetim për 5 vjet përvojë të punës në institucion për punë edukativo-arsimorë të verifikuar nga MASH i RM.
- certifikatë të shtetësisë së RM (jo më të vjetër se gjashtë muaj)
- certifikatë për provimin e dhënë për drejtor të shkollës së mesme
- dëshmi se ka certifikatë përkatëse, jo më të vjetër se pesë vjet për njohje të gjuhës angleze TOEFL IBT – së paku 30 pikë, IELTS – së paku 3 pikë, BULATS – së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English) – të dhënë,
- dëshmi që kandidati ka të dhënë testin psikologjik dhe testin për integritet,
- dëshmi që kundër kandidatit nuk ka akt kundërvajtës e cila hyn në e dhënë nga Gjykata themelore në vendin e lindjes (dëshmia të mos jetë më e vjetër se 6 (gjatë) muaj)
- Certifikatë se kandidati nuk është i dënuar të dhënë nga gjykata kompetente,
- Program për punë të drejtorit të shkollës për periudhë prej 4 (katër) vjet,
- dëshmi që kandidati për drejtor ka gjendje të përgjithshme shëndetësore (certifikatë mjeku) pas zgjedhjes do ta dorëzojë vetëm kandidati i zgjedhur, i cili do të dërgohet në kontroll mjekësor në llogari të punëdhënësit, në pajtim me nenin 25 paragrafi 7 nga ligji për marrëdhënie pune( gazeta zyrtare e RM nr. 167/2015-Tekst i pastruar)
- Shpallja zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit dhe fillon të numërohet nga dita e ardhshme e publikimit.
- Me kandidatët që i plotësojnë kushtet do të realizohet intervistë për të cilën plotësisht do të njohohen të njëjt.
- Vendi i punës drejtor i shkollës është vend i punës me autorizime të veçanta. Mandati i drejtorit do të jetë 4 (katër) vite, duke u llogaritur nga dita e emërimit.
- Pagesa bazë mujore është 28.816,00 denarë.
- Orari i punës është 8 orë në ditë ose 40 orë pune në javë, me fillim prej ora 07.15 deri në ora 15.15 prej ditës së hënë deri ditën e premte. Zgjedhja do të bëhet në afatin e paraparë ligjor.
- Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.
- Dokumentet kandidatit duhet t'i dorëzojë në origjinal ose kopjet të vërtetuar në noter, në zarf të mbyllur, drejtpërdrejt ose përmes postës në adresën SHMK Kosta Susinov Kej 8 – Septemvri nr. 8 Radovish, me shenjë deri të Këshilli i shkollës – “Komisioni për shqyrtimin e dokumenteve për shpalljen publike për zgjedhje të drejtorit të shkollës”.
- Këshilli i shkollës së SHMK Kosta Susinov Radovish
- Kryetar: Mile Arsov

Në bazë të nenit 80 dhe nenit 82, paragrafi 1 nga Ligji për arsim fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 103/2008; 33/2010; 116/2010; 156/2010;18/2011; 42/2011, 51/2011; 6/2012, 100/2012, 24/2013, 14/2014, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15 dhe 145/15) dhe neni 22 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (“Gazeta zyrtare e RM 167/15”), SHFK “Nikolla Karev” Radovish publikon,

### SHPLLJE PUBLIKE për plotësimin e vendeve të punës në vazhdim për vitin shkollor 2017/2018

Për punësim në SHFK “Nikolla Karev” Radovish që ka nevojë për punësim për kryerje të punëve dhe detyrave të punës për kohë të pacaktuar të punës për vitin shkollor 2017/2018 edhe atë për vendin e punës:

- 1 (një) mirëmbajtës të higjienës në shkollën qendrore për kohë të pacaktuar të plotë të punës;

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë dhe kushtet e veçanta në vazhdim:

Përveç fletëparaqitjes për vendin e punës nën pikat kandidatët duhet të parashtojnë dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës (fillor) dhe certifikatë të shtetësisë.

Pagesa fillestare për të punësuarit është 12.000 MKD. Orari i punës do të fillon prej ora 06:30 deri në ora 14:30.

Dokumentet e dorëzuara të jenë origjinal apo kopje e notarizuar. Dokumentet e nevojshme të dorëzohen në arkivin e shkollës.

Konkursi zgjatë 5 (pesë) ditë pune duke përfshirë ditën e publikimit në shtypin ditor.

Lutjet bashkë me dokumentet e lartpërmendura të dorëzohen deri te Këshilli i Shkollës nëpërmjet arkivit të SHFK “Nikolla Karev” Radovish, rr. Ilindenska pa nr., Radovish, tel. 032/635-179. Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat prej 30 ditësh pas mbylljes së konkursit publik.

SHFK “Nikolla Karev  
UD Drejtor  
Kamenita Kostadinova Atanasova

Në pajtim me nenin 47 të Statutit të FXHM dhe nenit 14 të Ligjit për sport publikon

### Shpallje Publike

Për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Federatës së Xhudos të Maqedonisë për një periudhë prej katër vitesh:

- Dëshmia se nuk është vendosur ndalimi i kryerjes së një profesioni, veprimtarie ose detyre

- Dëshmi, apo certifikatë - diplomë për shkallën e përfundimit të arsimit të lartë

- Certifikata provuese për njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë zyre

- Dëshmi - një licencë për të kryer çështje të menaxhimit në fushën e sportit

- Dëshmi - certifikatë për njohuri aktive të gjuhës angleze;

- Dëshmia e së paku njëzet viteve të pjesëmarrjes aktive në sportin e xhudos;

- Aplikimi me letër motivimi dhe

- Një biografi të shkurtër, me banesën / vendbanimin e aplikantit, adresën e e-mailit dhe numrin e telefonit të kontaktit.

Aplikuesit duhet gjithashtu të dorëzojnë dëshmi për përmbushjen e kushteve në origjinal ose në një kopje. Kushtet në shpallje, kandidatët duhet të përmbushin në kohën e nënshkrimit.

Dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në adresën e mëposhtme:

Federata e Xhudos në Maqedoni

Rr. 1732 Nr. 1 (Parku i Qytetit) në Shkup

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve me dokumentet e kërkuara është 8 ditë pune, më së voni deri më 13 qershor 2018.

Kushtet e veçanta:

- Arsimi i lartë i përfunduar në shkallën VI A Sipas Kornizës Maqedonase të Kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas ECTS ose përfunduar shkallë e VII / 1

- licencë për kryerjen e aktiviteteve të menaxhimit të sportit

- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

- njohuri aktive të gjuhës angleze dhe

- të paktën njëzet vjet pjesëmarrje aktive në sportet e xhudos.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- Dëshmia e shtetësisë

Në bazë të nenit 42 të Ligjit për gjykata (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 62/06, 35/08, 150/10 dhe 83/2018), Gjykata Themelore Shkup I Shkup publikon:

### SHPLLJE PUBLIKE nr. 2/2018

Gjykata themelore Shkup I Shkup Këshillit gjyqësor të RM do ti propozojë 40 kandidatët për zgjedhje të gjykatësve – porotë për kohë prej 4 vjet.

Kandidatët e interesuar për zgjedhje të gjykatësit – porotë duhet t'i plotësojnë kushtet nga neni 42 paragrafi 2 të Ligjit për gjykatat (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 8/06, 62/06, 35/08, 150/10, 83/2018) edhe atë:

- për gjykatës – porotë mund të jetë i zgjedhur shtetas i Republikës së Maqedonisë i moshës së rritur së paku me arsim të mesëm të kryer, të cilët në mënyrë aktive njohin gjuhën maqedonase, gëzojnë respekt për kryerjen e funksionit dhe i cili nuk është më i vjetër se 60 vjet.

Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet t'i dorëzojnë edhe dokumentet në vijim:

- Certifikatë për arsim të mbaruar, në origjinal ose kopje të vërtetuar në Noter,

- Certifikatë të shtetësisë në origjinal ose kopje të vërtetuar në Noter.

- Vërtetim nga evidenca e dënimeve dhe

- Deklaratë se me gjykatësin ose gjykatësin porotë në këtë gjykatë madje as me anëtarë të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë nuk është në farefisi në vijë të drejtë ose anësore deri në shkallë të tretë ose bashkëshort, të vërtetuar në noter.

Afati për paraqitjen e kandidatëve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes. Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes. Kandidatët e interesuar fletëparaqitjen së bashku me dokumentet e nevojshme dhe kontakt telefonin mund ta parashtojnë me shkrim përmes departamentit për pranim në Gjykatën themelore Shkup I Shkup ose përmes postës në adresën Bulevardi Goce Dellçev nr. 10 Shkup, (me shenjë për Shpallje publike nr. 2/2018).

GJYKATA THEMELORE SHKUP I SHKUP

### KORRIGJIM I KONKURSI

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i shpallur më 04.06.2018 në gazetën ditore “Koha”

Në pjesën “FAKULTETI FILOLOGJIK”, në pikën 1 fjalët “Gjuhë angleze” zëvendësohen me fjalët “Letërsi angleze”.


Universiteti i Tetovës

### URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. “7 korriku” nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 – Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

KOMUNA E GOSTIVARIT  
ОПШТИНА ГОСТИВАР  
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk  
info@gostivari.gov.mk  
tel. +389 (0) 42 213 511  
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 23-513/60  
04.06.2018 vit  
Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 и 163/16), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

**L A J M Ě R I M**

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridikë të përfshirë në hapësirën e Propozim PDU-së – Njësia Urbane “V” – Bllok 22 - Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizimin e:

**PREZANTIMIT PUBLIK  
DHE ANKETËS PUBLIKE**

Rreth Propozim PDU-së – Njësia Urbane “V” – Bllok 22 - Komuna e Gostivarit për periudhën e planit 2016-2021, sipërfaqja e përfshirjes (12.469 Ha), që kufizohet ndërmjet rrugëve:


- Nga ana veriore me rrugën e re të projektuar Servisore “17” ,
- Nga ana jugore me rrugën Magjistrale “101” ,
- Nga ana lindore me rrugën e re të projektuar Servisore “5” , dhe
- Nga ana perëndimore me Magjistrale “ VII. Gjinoski ”.

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit respektivisht në sallën e Këshillit Komunal të Gostivarit dt. **12.06.2018 (e martë) në ora 12:00.** Propozimi i PDU-së – Njësia Urbane “V” – Bllok 22 - Komuna e Gostivarit, do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit në afat prej 5 ditë pune edhe atë nga dt. **12.06.2018 vit deri më 19.06.2018** çdo ditë pune prej orës 08:00-16:00.

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridik dhe fizik nga zona konkrete të përfshirë në Planin e shpallur në prezantimin publik mund të parashtrajnë vërejtje me shkrim në fletët anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm.

Kryetari i Komunës  
**Arben Taravari**

KOMUNA E GOSTIVARIT  
ОПШТИНА ГОСТИВАР  
GOSTIVAR BELEDIYESI



www.gostivari.gov.mk  
info@gostivari.gov.mk  
tel. +389 (0) 42 213 511  
fax. +389 (0) 42 214 406

Nr. 23-1294/61  
04.06.2018 vit  
Gostivar

Në bazë të nenit 35 alineja (3) nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gaz. zyrtare e RM nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16 ), Kryetari i Komunës së Gostivarit e solli këtë:

**L A J M Ě R I M**

Lajmërohen qytetarët dhe personat juridikë të përfshirë në hapësirën e Propozim PDU-së – Njësia Urbane “V” – Bllok 23 - Komuna e Gostivarit, se Kryetari i Komunës së Gostivarit solli Vendim për organizim e :

**PREZANTIMIT PUBLIK  
DHE ANKETËS PUBLIKE**

Rreth Propozim PDU-së – Njësia Urbane “V” – Bllok 23 - Komuna e Gostivarit për periudhën e planit 2016-2021, sipërfaqja e përfshirjes (23.160 Ha), që kufizohet në mes rrugëve:

- Nga ana veriore me rrugën e re të projektuar Servisore “9” ,
- Nga ana jugore me rrugën Magjistrale “101” ,
- Nga ana lindore me rrugën “Boris Kidriç”, dhe
- Nga ana perëndimore me rrugën e re të projektuar Servisore “ 8 ”.

Prezantimi publik do të mbahet në hapësirat e Komunës së Gostivarit respektivisht në sallën e Këshillit Komunal të Gostivarit dt. **12.06.2018 (e martë) në ora 13.00.** Propozim PDU-së – Njësia Urbane “V” – Bllok 23 - Komuna e Gostivarit , do të ekspozohet në lokalet e Komunës së Gostivarit në afat prej 5 ditë pune edhe atë nga dt. **12.06.2018 vit deri më 19.06.2018 vit.** çdo ditë pune prej orës 08.00-16.00.

Fletët anketuese gjenden në Qendrën për Shërbime Publike të Komunës së Gostivarit si dhe në sistemin e-urbanizëm, kurse në afatin e paraparë personat e interesuar juridik dhe fizik nga zona konkrete të përfshirë në Planin e shpallur në prezantimin publik mund të parashtrajnë vërejtje me shkrim në fletët anketuese në formë të shkruar ose në formë elektronike nëpërmjet sistemit e – urbanizëm.

Kryetari i Komunës  
**Arben Taravari**

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 167/15-tekst i pastruar), nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18) dhe Pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18-6242/2 të datës 29.05.2018, U.D Drejtori i IPKÇF “Aco Karamanov” – Radovish, publikon

**SHPALLJE PUBLIKE  
PËR PUNËSIM PËR KOHË TË PACAKTUAR TË PUNËS**

1. Një (1) person në vendin e punës përkëdhelës për kohë të pacaktuar të punës.  
Shkalla e arsimit: Arsimi i mesëm i mbaruar katër vjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës,  
- me ose pa përvojë pune,  
- neto pagesa mujore prej 14.779,00 den  
- orari ditor i punës i shkallëzuar prej ora 08.00-16.00 dhe prej ora 10.00 – 18.00 prej të cilave 7 orë punë me fëmijë.  
Orari javor i punës për vendin e punës është 40 orë, (8 orë në ditë prej ditës së hënë deri ditën premtë)

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të parashtrajnë edhe dokumentet në vijim:  
-Dëshmi për arsim të mbaruar dhe licencë valide për përkëdhelës,  
-Certifikatë të shtetësisë,  
-Dokument se me vendim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,  
-Dokument, se nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me çka është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligj është përcaktuar sjellje diskriminuese.  
Shpallja zgjatë pesë (5) ditë pune nga dita e publikimit.  
Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditë pas kalimit të shpalljes.  
Lutja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të parashtrohet deri në IPKÇF “Aco Karamanov” – Radovish, rr. “Aco Karamanov” nr. 54, Radovish.  
Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtrohen në afatin e caktuar dhe fletëparaqitjet të cilat nuk i përmbajnë dokumentet e kërkuara, do të konsiderohen si të dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara dhe nuk do të merren parasysh.  
U.D Drejtor,  
L. Trençeva

Në bazë të nenit 59 a, b, g, d të Ligjit për arsim të mesëm (“Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18), nenit 21 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18), Ligjit për standardet e nxënësve, nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë” nr. 167/2015 –teksti i pastruar, 27/2016), ndërsa në pajtim me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në SHMKKN “Dimitar Vllahov” – Strumicë nr. 01-165/1 të datës 11.02.2016, pëlqimit nga MASH për mjete të lejuara financiare nr. 12-3386/5 të datës 21.05.2018 dhe nr. 12-3386/7 të datës 21.05.2018 (financim i ri) dhe pëlqimit nga MASH nr. 12-14369/4 të datës 05.02.2018 (financim i vjetër), dhe Vendimit nr. 04-486/1 të datës 30.05.2018, drejtori i shkollës pranë SHMKKN “Dimitar Vllahov” Strumicë, publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**

Për punësim të kuadrit jomësor për kohë të pacaktuar të punës

- Mirëmbajtës të higjienës ..... 3 realizues me arsim të mbaruar fillor/të mesëm me ose pa përvojë pune me orar të plotë të punës 40 orë punë me neto pagesë prej 12.008,00 denarë me orar të punës me ndërrime gjatë javës – 2 realizues në bazë të financimit të ri dhe 1 realizues në bazë të financimit të vjetër.
- Gjellëbërës..... 1 realizues me arsim të mesëm të mbaruar të hotelierisë – drejtimi gjellëbërës me ose pa përvojë pune me orar të plotë të punës - 40 orë pune, me neto pagesë prej 12.925,00 denarë me orar të punës me ndërrime gjatë javës – në bazë të financimit të ri.
- Enëlarës..... realizues me arsim të mesëm të mbaruar me ose pa përvojë pune me orar të plotë të punës - 40 orë pune, me neto pagesë prej 12.925,00 denarë, me orar të punës me ndërrime gjatë javës – në bazë të financimit të ri

Për punësimin e edukatorit për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018

- Eduktor.....1 realizues me arsim të mbaruar sipëror shkalla VII/1 me 240 (dyqindëzvet) kredi, me ose pa përvojë pune me orar të plotë të punës - 40 orë punë me neto pagesë prej 21.521,00 denaarë me orar të punës me ndërrime gjatë javës – në bazë të financimit të ri.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të përcaktuara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës: të jetë shtetas i R. Maqedonisë dhe në mënyrë aktive të njëj gjuhën maqedonase.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrajnë

- Dëshmi për arsim të mbaruar
- Certifikatë të shtetësisë
- Dëshmi për përvojën e punës

Dokumentet duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Procedura për përzgjedhje do të realizohet nga ana e Komisionit që do të formojë rang listë të kandidatëve që përmbushin kushtet për punësim në vendet e punës të theksuara në shpallje. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme si dhe dëshmitë për përmbushje të kushteve parashtrohen deri te SHMKKN “Dimitar Vllahov” – Strumicë personalisht ose përmes postës në adresën rr. Goce Dellçev nr. 17 Strumicë. Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit nuk do të shqyrtohen.

SHMKKN “Dimitar Vllahov”  
Strumicë

Drejtor  
Dimitar Gjorgjev



**Koha**  
http://www.koha.mk

www.koha.mk  
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk  
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;  
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Buf. Goce Dellçev nr.11, | Q.T. Mavrovrasja lok.14 - përdhësë, Shkup

NË PRAG TË BOTËRORIT RUSI 2018

# MIQËSORE DHE DËMTIME, JA GJENDJA E PRETENDENTËVE

Botërori është shumë pranë filimit dhe kalendari ndërkombëtar është plot me miqësore, që i japin mundësi ekipeve të përgatiten dhe "yjeve" të tyre të mbajnë ose të gjejnë formën. Gjermania, kampione e botës në fuqi, po teston formën e të rikthyerit Nojer, ashtu si Brazili që dëshiron të shohë si është Nejmar pas dëmtimit. Egjipti po përpaket të gjejë një alternativë për Salah, por gjithsesi emëruesi i përbashkët në stërvitje gjatë kësaj periudhe është stërvitje intensive. Ja si mbërrijnë "të mëdhatë" në Rusi 2018

## GJERMANIA

**Nojer është gati, por fitorja është zhdukur!**

Le ta nisim me citim e famshëm të Gari Lineker në "Itali '90": "Futbolli është një lojë e thjeshtë: 22 futbollistë vrapojnë pas një topi për 90 minuta, por në fund fiton Gjermania." Kampionët e Botës në fuqi nuk po e kalojnë mirë këtë periudhë përgatitore që i afron me Rusinë. Por kur të vijë momenti jemi gati të vëmë bast se koha e eksperimenteve do të mbyllet dhe fitoret do të vijin. Dyshimi më i madh ka lidhje me prezencën si titullar për Manuel Nojer, pas tetë muajsh mungesë si pasojë dëmtimi, por në pesë ndeshjet e fundit miqësore pas eliminatorëve, gjermanët nuk kanë fituar asnjëherë. Duhet thënë se kanë pasur disa nga kundërshtarët më të fortë në qarkullim, rivalë të drejtpërdrejtë për trofeun. Humbja kundër Austrisë në Klagenfurt ka qenë një kabanë alarmi që Lov nuk do të nënvlerësojë.

Miqësoret: Angli 0-0, Francë 2-2, Spanjë 1-1, Brazil 0-1, Austri 1-2

## FRANCA

**Ekipi është në formë dhe favorit për trofeun**

Superfuqia transalpine është bindëse në fushatën që e afron me Kupën e Botës dhe mjafton që mendosh futbollistët e famshëm që Didier Deschamp nuk ka grumbulluar për të kuptuar forcën e kësaj përfaqësuese. Trajneri ka larminë e zgjedhjeve dhe dy ndeshjet e fundit miqësore kanë treguar një ekip në formë. Italia dhe Irlanda janë mundur përkatësisht 3-1 dhe 2-0 në dy



ndeshje që nuk kanë pasur histori. Në mars, të njëjtin fat pati edhe Rusia. E veçanta është që shënojnë të gjithë dhe janë sulmues cilësor si Dembele, Mbappe, Zhirud, Fekir dhe Grizmann. Zgjidhni vetë se cili prej tyre është më i rrezikshëm.

Miqësoret: Rusia 3-1, Irlanda 2-0, Italia 3-1

## BRAZILI

**Më në fund Nejmar është kthyer, edhe me gol**

Dyshimi më i madh për "Seleao" është situata e Nejmar. Sulmuesi i Paris SZH nuk luante që nga muaji shkurt për arsye dëmtimi, por mjaftuan pak minuta në fushë, në pjesën e dytë të miqësore ndaj Kroacisë, për të shënuar golin e parë në fitoren 2-0, me një veprim të denjë për famën e tij. Nuk do të jetë në maksimumin e formës, por është riaftësuar dhe mund të jetë protagonist në veprimtarinë më të rëndësishme. Pjesën tjetër të punës do ta bëjë një grup solid, i fortë në mbrojtje dhe i bashkuar, brenda dhe jashtë fushës së lojës. Sigurisht me synimin për të harruar humbjen 7-1 ndaj Gjermanisë, katër

Dyshimi më i madh ka lidhje me prezencën si titullar për Manuel Nojer, pas tetë muajsh mungesë si pasojë dëmtimi, por në pesë ndeshjet e fundit miqësore pas eliminatorëve, gjermanët nuk kanë fituar asnjëherë. Duhet thënë se kanë pasur disa nga kundërshtarët më të fortë në qarkullim, rivalë të drejtpërdrejtë për trofeun

vjet më parë. Me Alisson në portë garancitë janë shtuar.

Miqësoret: Rusia 3-0, Gjermania 1-0, Kroacia 2-0

## ARGJENTINA

**Është provimi i fundit me kombëtaren për Messin**

"Çelesët" po fshihen. Pasi kanë lënë pas shpine polemikat, që kryesisht vinin nga Italia, për zgjedhjet

e "dyshimta" të Sampaoli, Argjentina po përgatitet me drita të fikura për "Rusi 2018". Nuk ka pasur ende një test të nivelit të lartë, vetëm një sukses 4-0 ndaj modestëve të Haitit me tre gola të shënuar nga Lionel Messi. "Pleshti" është në apelin e fundit të karrierës për t'iu përgjigjur Kristiano Ronaldos në pikët e tij më të dobët: kombëtaren. Messi, Higuain, Aguero, Di Maria dhe të tjerët duhet të marrin revanshin edhe për humbjen 6-1 në miqësoren e luajtur në mars ndaj Spanjës.

Miqësoret: Italia 2-0, Spanja 1-6, Haiti 4-0

## SPANJA

**Ndoshta po nënvlerësojnë ekipin "më të tmerrshëm"!**

Pasi dominuan dhjetë vjeçarët e fundit të futbollit ndërkombëtar, "furitë e kuqe" janë disi në hije, por gabimi më i madh do të ishte nënvlerësimi. Grupi i lojtarëve të Lopetegui është shumë i fortë, pavarësisht nga një ndryshim i detyruar breza. Loja e Spanjës është bindëse dhe barazimi 1-1 ndaj Zvicrës në miqësoren e fundit në Villarreal nuk është tregues real i forcës së tyre. Ndaj

zvicranëve paguan një gjendje fizike që ende nuk është në 100 për qind dhe eksperimente të ndryshme taktike, pavarësisht se në pjesën më të madhe të ndeshjes topin e zotëronte vetëm një ekip. Asensio, Vazkuez dhe disa të tjerë janë futbollistë që mund të ndryshojnë fatet e ndeshjes duke u aktivizuar nga stoli. Praktikisht, trajneri i Spanjës ka 23 titullarë në dispozicion.

Miqësoret: Gjermania 1-1, Argjentina 6-1, Zvicra 1-1

## PORTUGALIA

**Kampionët e Evropës i kanë sytë nga Ronaldo**

Prezantohen në Kupën e Botës si kampionët e Evropës në fuqi dhe kjo është një risi, por ka disa paqartësi. I vetmi që jap siguri është Kristiano Ronaldo, por pesë herë fituesi i "Topit të Artë" nuk është bashkuar ende ekipit në grumbullim, sepse është me pushime, pas konsumimit të energjive me Real Madrid. Me kthimin e tij do të përmirësohet sulmi. Pa të Portugalia mbetet sterile në sulm, si e tregoi barazimi 0-0 ndaj Belgjikës. Ndaj Tunizisë shënoi dy herë, por gjithashtu pësoi dy gola. Brishtësia në mbrojtje duke se shqetëson trajnerin Fernando Santos. Të paktën Andre Silva me Portugalinë, është ndryshe nga ai i parë me Milanin.

Miqësoret: Egjipti 2-1, Holanda 0-3, Tunizia 2-2, Belgjika 0-0

## ANGLIA

**Sautgejt ka një "kartë" fituese, Harri Kin**

Si gjithmonë, kombëtarja e "tre luanëve" është një enigmë. Në letër formacioni është "ok" dhe jep larmi zgjedhjesh taktike, sidomos në sulm, ku talenti i futbollistëve është me bollëk. Por në fushën e lojës, zakonisht, Anglia nuk shkon mirë në veprimtarinë e mëdha. Trajneri Southgate duket se ka "blinduar" prej kohësh mbrojtjen dhe problemet janë vetëm në zgjedhjet që duhet të bëjë në sulm. Kapiteni Harri Kin pritet të jetë një nga "yjet" në Rusi, por a do të dijë skuadra e tij ta furnizojë me topa.

Miqësoret: Holanda 1-0, Italia 1-1, Nigeria 2-1

## Hakimi, talenti i Realit që pritet të shkëlqejë në Rusi

Ashraf Hakimi! Mbani mend këtë emër dhe përgatituni të mahnitëni nga talenti i tij. Mbrojtësi i Marokut, Ashraf Hakimi, mund të jetë një nga yjet e Botërorit që do të zhvillohet në Rusi. Ai ka treguar disa momente shkëlqimi në sezonin e sapo mbyllur me Real Madrid, madje ka debutuar në "Champions League" kundër Tottenhamit në "Wembley". Mbrojtësi 19-vjeçar i krahut mund të luajë edhe si qendërmbrojtës, dhe ka potencialin të bëhet një nga më të mirët në qarkullim. I lindur në Getafe, afër Madridit, ai mund të kishite luajtur për Spanjën. Megjithatë, prindërit e tij janë nga Maroku, që



ka bindur talentin se e ardhmja e tij do të ishte në duar të sigurta me ata. Tani ai është një titullar i palëvizshëm. Debutimi i tij me kombëtaren ka ardhur në fitoren

4-0 të marrë kundër Kanadasë, kur ishte vetëm 17 vjeç, shumë kohë para se të debutonte në "Santiago Bernabeu". Hakim ka kaluar te "La Fabrica" e Real Madrid në

korrik të 2006-ës dhe ka luajtur bashkë me djalin e Zidan, Luka. Ajo ka qenë platforma ideale për të, që të tregonte aftësitë para trajnerit të tij të ardhshëm. Për shkak të rivalitetit të madh në krahun e djathtë të mbrojtjes së Real, Hakimi ka qenë i detyruar të ishte zëvendësuesi i Dani Karvahal. Por kur ai ka munguar në ndeshjen kundër Espanjolit tetorin e kaluar, Hakimi ka marrë vendin e tij dhe ka bërë një paraqitje bindëse. "Arra", si e thërrasin shokët e skuadrës, ka qenë i duruar dhe tani po shpërblehet.

Në fillim të sezonit i është dhënë mundësia të kalonte te Ala-

ves me formulën e huazimit për të fituar eksperiencë. Por kur Danilo u shiti te Manchester Siti, trajneri Zinedin Zidan i kërkoi Hakimit të mos largohej. Ai i garantoi atij deri në 20 ndeshje nëse do të qëndronte. Hakim ka luajtur 17 ndeshje në të gjitha kompeticionet për Realin në këtë sezon, duke shënuar dy gola. Hakimi do të jetë një nga lojtarët më të rinj të Real Madrid që do të luajë në Kupën e Botës këtë verë, duke thyer rekordin e Sergio Ramos, i cili ka luajtur me Spanjën në 2006-ën. Nëse do të ketë gjysmën e karrierës që kanë pasur shokët e tij të skuadrës, ai do të jetë një nga më të mirët në botë.

**DASHI** 21. mars - 20. prill

Do të jeni të mërzitur për shkak të disa projekteve që nuk stimulojnë kreativitetin tuaj. Megjithatë duhet të mundoheni të mbyllni gjithçka brenda një kohe të shkurtër, pasi në të kundërt rrezikoni që t'iu grumbullohet punë. Kjo ditë do të jetë mjaft e favorshme, në rast se prisni përgjigje në dashuri.

**DEMI** 21. prill - 21. maj

Mos u ndjeni të detyruar që të ndiqni të gjitha këshillat dhe sugjerimet e marra nga personat që ju rrethojnë, pasi jo vetëm ju e dini se për çfarë keni nevojë, për të marrë rezultatet e dëshiruara. Në dashuri mos u tregoni shumë grindavec/e.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Kjo ditë do të jetë mjaft e frytshme për punën dhe bashkëpunimet e reja. Jini më spontan dhe mos hezitoni që të shfaqni kapacitetin tuaj teknik. Në dashuri parashikohen zhvillime interesante.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Mos lejoni që të përfshihen nga paniku, nëse haseni me të papritura në rrugën tuaj profesionale. Kjo pasi në të vërtetë këto sfida ju lejojnë që të nxirrni në pah aftësinë tuaj. Jini kurajoz, sidomos në dashuri.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Gjatë kësaj dite do të tregoni kujdes ndaj një personi të cilin e keni shumë përzemër dhe që po kalon një periudhë të vështirë. Duke qenë komunikues, do ta ndihmoni që të mos bëjë një zgjedhje të nxituar. Në sferën profesionale, pritët të ketë të reja.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Një takim më se rastësor, do ju bëjë tejet euforik. Kjo gjë do ju japë mundësinë që të rizgjoni disa ndjenja, të cilat i keni lënë pas dore kohëve të fundit. Horoskopi ju sugjeron që të mundoheni të respektoni më shumë, këshillat e kolegëve tuaj në punë.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Gjatë kësaj dite duhet të jeni shumë të kujdeshëm në dashuri, për shkak se pa dashje, mund të joshni një person që nuk ju intereson. Hijeshia juaj do ju mundësojë që të bëni shumë persona për vete. Në vendin e punës jini më të lirshëm dhe të guximshëm.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Kjo ditë mund të jetë mjaft intriguese dhe do ju ftojë që të mos jini shumë pesimistë, sidomos në dashuri, ku mund të keni një keqkuptim me personin që ju pëlqen. Përgjigjet që prisni, janë fare pranë. Ky është një moment shumë i mirë edhe për të bërë biznes apo blerje të ndryshme.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të ndjeni nevojën që të rinovoni totalisht jetën tuaj, dhe do të gjeni stimuj të rinj. Dashuria do të jetë një prioritet absolut, kështu që jini të gatshëm që të keni takime të kënaqshme, apo të zyrtarizoni një lidhje.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Do të jeni shumë të përqendruar në realizimin e një projekti të cilin e keni nisur prej pak kohësh. Ka ende disa çështje që duhen sqaruar, lodhur me disa bashkëpunime të rëndësishme për ju. Gjatë mbrëmjes së kësaj të marte, merrni më shumë kohë për tu kujdesur për veten.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Mundohuni të jeni më shumë të kuptueshëm dhe bashkëpunues me kolegët tuaj në punë, pasi në këto momente, duhet të jeni të gatshëm për gjithçka. Do të merrni disa përgjigje të mira në dashuri, kështu që përfitoni për të çuar përpara propozime lidhur me udhëtime apo transferime.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Kjo do të jetë një ditë e turbullt, gjatë së cilës do të jeni mjaft aktiv. Do të gjeni mënyrën për të treguar të gjithë krijimtarinë tuaj, duke nisur një aktivitet të ri në bashkëpunim me kolegë ose mik të besuar. Këshillohet që të bëni kujdes me shpenzimet.

**Sudoku**

|   |   |   |   |   |   |   |   |   |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
|   |   | 2 |   | 1 | 3 | 4 |   |   |
|   | 3 | 7 |   |   |   | 9 | 5 |   |
| 6 |   |   |   | 2 |   |   |   | 7 |
|   |   |   | 2 |   | 1 |   |   |   |
|   |   |   |   | 3 |   |   |   |   |
| 2 |   |   | 5 |   | 9 |   |   | 3 |
| 4 |   |   |   | 7 |   |   |   | 5 |
|   | 6 | 1 |   |   |   | 2 | 8 |   |
|   |   | 5 |   | 9 | 6 | 3 |   |   |

**DY VJET PA MË TË DASHURIN TONË**



**XHEMALUDIN ALIU**  
05.09-1935-06.06 2016

Më 6 qershor përkujtojmë 2 vjetorin e vdekjes së babait, gjyshit dhe të dashurit tonë. Ditët kalojnë por malli dhe dashuria nuk shuhen. Na mungon. Të përkujtojnë, familja nga Tetova dhe fshati Reçicë e Madhe.

| Mensur Mamuti  | VEPËR E AUTORIT NË FOTO                              | BIMË E NGJASHME ME BORONICËN                   | MATEMATIKANI POLAK, NIKOLLA(US) | ELEKTRO-VOLT  | PAGË MUJORE APO VJETORE (PËR ENDBANIM)                                    |
|--|--|--|---------------------------------|---|---|
| KEQBËRËS   |  |  |                                 |   |   |
| BIMË BARISHTORE NJËVJEÇARE (PËRDORET SI USHQM PËR KAFSHËT) |  |  |                                 |   |   |
| DATA-ORIENTED PARSING                                      |  |  |                                 | REOMIRI<br>VEPËR E AUTORIT NË FOTO                      |   |
| KËNGËTARJA TARIFA  |  |  |                                 |   |   |
| AKTORI ROBERT DE   |  |  |                                 |   | KRAHINË NË MALAJZI  |
| KËNGËTARJA AMERIKANE, XHILJIAN                             |  |  |                                 |   |   |
| RUMANIA  |  | INTERNATIONAL THEATRE INSTITUTE<br>SAPOARRITUR |                                 |   |   |
| USHTARË JO TË RREGULLT KROATË KUNDER PERANDORISË OTOMANE   |  |  |                                 |   |   |
| SHKA I KRISHTERË (VJET.)                                   |  |  |                                 | SHENJË QË U BËHET KAFSHËVE, NJOLLA<br>LIDHJA SOCIALISTE | D MASIV MALOR NË GJERMANI RADIO NEWYORK INTERNATIONAL ZEMËRIM, ZEMËRATË I |
| Ë. P.  |  | FËRFËLLON, FLUTURON<br>SIPËR                   |                                 |   |   |
| AUTORI GJERMAN NË FOTO                                     |  |  |                                 |   | GJERMANIA<br>CMIMI PËR LETËRSI QË IU NDA A AUTORIT MË 1929                |
| KOHA   | VULLKAN NË HONSHU, JAPONI<br>PJESË E VEGJËS, BËRDILË |  |                                 | AKTORI AMERIKAN, STIV MEK (SHQ.)<br>THAJ                |   |
| NOVELË E AUTORIT NË FOTO                                   |  |  |                                 |   | O. NJ.<br>DATA TRANSFER OBJECT  |
| I VOGLJ I DHISË  |  | TETOVA<br>TORONTO                              |                                 | SHËRBIMI SEKRET JUGOSLLAV<br>4 ROMAK                    |   |
| A NDJEKËSIT E FUTURIZMIT                                   |  |  |                                 |   |   |
| KËNGËTARI ITALIAN, RAMAXOTI                                |  |  |                                 | INSTRUMENT MUZIKOR (MË E MADHE SE VIOLINA)              |   |

**NE KETE DATE**

6 QERSHOR 1875  
12 GUSHT 1955

|   |                         |  |  |   |
|---|-------------------------|--|--|---|
| D | MASIV MALOR NË GJERMANI | RADIO NEWYORK INTERNATIONAL                | ZEMËRIM, ZEMËRATË  | I |
|   |                         |  |  |   |
|   |                         |  | GJERMANIA<br>CMIMI PËR LETËRSI QË IU NDA A AUTORIT MË 1929 |   |
|   |                         |  |  |   |
|   |                         | O. NJ.<br>DATA TRANSFER OBJECT             |  |   |
|   |                         | SHËRBIMI SEKRET JUGOSLLAV<br>4 ROMAK       |  |   |
|   |                         |  |  |   |
|   |                         | INSTRUMENT MUZIKOR (MË E MADHE SE VIOLINA) |  |   |

ZGJIDHJET: BAKEQ, UROVI, DOP, R, ENEDA, NIRO, BANKS, R, ITI, USKOK, KAUR, D, I, EP, FLATRON, TOMAS MAN, D, ABU, KUINI, TRISTAN, ONJ, EDH, TE, UDBA, FUTURISTËT, EROS, VIOLE.



## Kur ika në SHBA... me not!

Një francezi i duket një distancë e shkurtër Francë-Belgjikë, ndaj dhe kërkon ta sfidojë veten me një objektiv edhe më të vështirë. Notari 51-vjeçar, Ben Lecomte është nisur nga Japonia, me synimin për t'u bërë i pari që kalon oqeanin Paqësor me not. Ai pritet të notojë për rreth 8 orë në ditë, për mbi 6 muaj, me destinacion brigjet perëndimore të Shteteve të Bashkuara.

Mes vështirësive me të cilat do të përballlet ai janë peshkaqenët, stuhitë, moria e kandilëve të detit, por edhe temperaturat ekstremisht të ulëta të ujit.

Me këtë nismë, ai gjithsesi shpreson të zgjojë ndërgjegjësimin për ndryshimet

klimatike, pasi edhe një ekip shkencëtarësh do të kryejnë studime gjatë notimit prej 5,500 milje detare (rreth 9.000 km). Ata do të studiojnë mbetjet plastike, efektet e ushtrimeve ekstreme ndaj zemrës dhe do të hetojnë gjithashtu edhe sesi fatkeqësia bërthamore e Fukushima ka ndikuar në oqean.

Lecomte jeton në SHBA dhe është përgatitur prej kohësh me orë të tëra notimi në det të hapur. Ai ka praktikuar gjithashtu teste shikimi dhe veçimi, në mënyrë që të garantohej se ishte psikologjikisht i gatshëm për këtë sfidë.

"Pjesa mendore është shumë më e rëndësishme sesa ajo fizike - tha ai për

"AFP"-në. - Duhet të jesh i sigurtë se gjithmonë do të mendosh për diçka pozitive. Kur nuk ke diçka me të cilën të mund të merresh, atëherë truri bie në një spirale shqetësimesh, e pikërisht këtu nisin edhe problemet".

Përgatitjet për udhëtimin kanë zgjatur më shumë se 6 vite, por Lecomte e ka pasur në mendje këtë sfidë prej më shumë sesa kaq. Në vitin 1998, ai ishte i pari që zhvilloi kalimin transatlantik, duke kryer më shumë se 4.000 milje (6.400 km) në 73 ditë. Kur ai mbërriti në Francë, fjalët e para të asaj kohe ishin "kurrë më", por prej atëherë duket se ka ndryshuar mendje dhe ka nisur një sfidë të re.



## Maji dhe prilli në Gjermani më të nxehtët që nga viti 1881

Gjermania ka përjetuar majin dhe prillin më të nxehtë që nga vitet e fundit të 1800-s. Shërbimi klimatik i Gjermanisë ka pohuar se këto ndryshime mund të kuptohen vetëm falë ngrohjes globale. Këta dy muaj shënuan temperaturat më të larta, që prej kur ka filluar regjistrimi i motit në vitin 1881. Me temperaturë mesatare prej 16 gradësh, maji i vitit 2018 ishte 3.9 gradë më i ngrohtë se mesatarja në mes të viteve 1961 dhe 1990. Ndryshimet klimatike kanë rezultuar në ngritje të temperaturave duke bërë që ato mesatare të rriten çdo muaj e më tepër, përcjell KP.

## Zvicra do t'u kontrollojë Facebookun azil-kërkuesve



Autoritetet e Zvicrës janë duke shqyrtuar mundësinë që t'i përdorin të dhënat nga Facebooku, Twitteri dhe media të tjera sociale, për të hetuar deklaratimet në lidhje me azil. "Detajet që azil-kërkuesit publikojnë në rrjete sociale mund të na dërgojnë në përfundime që janë të rëndësishme për procedurat e azilit, duke treguar gjëra

për lidhjet familjare dhe të tjera", kanë thënë për të përditshmen zvicerane NZZ nga zyra për emigrim. Është krijuar një grup punues për të kuptuar nëse dhe sa të dhënat e rrjeteve sociale mund të ndikojnë për aplikacionet e azilit. Rregullat e tanishme të azilit kërkojnë që autoritet të kërkojnë vetëm identitetin e azil-kërkuesit.

## Kimioterapia mund të shmangët te kanceri i gjirit

Rreth 70 për qind të grave në fazën fillestare të kancerit të gjirit mund të mënjanojnë kimioterapinë, pas heqjes së tumoreve, thonë studiuesit nga Shteteve të Bashkuara. "Kjo është një gjetje shumë e madhe", tha doktor Larry Norton, ekspert i kancerit të gjirit në një spital të Nju Jorkut, që ndihmoi në organizimin e këtij studimi, para më shumë se një

dekade. Studimi që u prezantua në Klinikën Onkologjike të Shqipërisë Amerikane në Çikago, tregon se si të trajtohen gratë në fazat e para të kancerit me anë të terapive hormonale. Me anë të një testimi që iu bëhet grave në fazën fillestare të kancerit, varësisht nga rezultati vendoset se cilat kanë nevojë për kimioterapi dhe cilat shpëtojnë nga ky trajtim.



1520 – Franca dhe Anglia nënshkruajnë traktatin e Skocisë.

1660 – Danimarka dhe Suedia nënshkruajnë traktat të paqes.

1664 – Nju Amsterdam ndërron emrin në Nju Jork Siti.

1665 – Beteja e Monte Karlos: Ushtritë angleze dhe portugeze mundin Spanjën.

1809 – Suedia shpall pavarësinë, themelohet monarkia konstitucionale.

1850 – Levi Strauss bën xhinset e para.

1919 – Finlanda ju shpall luftë bolshevikëve.

1958 – Premier Charles de Gaulle ka deklaruar se Algjeria çdoherë do të mbetet franceze.

1967 – Trupat izraelite okupojnë Gazën.

1983 – Nikaragua dëboi 3 diplomatë amerikan.



Shumë prej njerëzve ende nuk hanë mëngjes për arsye të ndryshme, por mund të ndryshojnë kur të gjejnë se mund të kenë një frymë të keqe për shkak të kësaj. Kapërcimi i mëngjesit lë bakteret që ne përndryshe do t'i kishim larguar me rastin e ngrënies. "Nëse nuk hani mëngjes, ju keni një nga zakonet më të këqija që shkakton frymëmarrje të keqe, sepse zgavra e gojës mbetet e thatë dhe e mbushur me baktere", tha Mervin Druian nga Qendra e Londrës për Stomatologji Estetike. Më shumë baktere mund të ndodhin nëse zgjedh drithërat me bazë sheqeri për mëngjes. Në vend të kësaj, Druian këshillon të konsumohen fruta dhe ujë, pasi në këtë mënyrë do të largoni më efektivisht bakteret nga goja juaj.

### DY BIONDINA NË KREVAT

Kanë qenë dy biondina duke fjetur në një krevat të ngushtë. Pas pak, njëra nga biondinat bie poshtë. Tjetra menjëherë thotë: - Motra eja se u liria një vend.



Dietë quhet kur ti shikon çfarë ha, dhe do të doje të haje çfarëdo që shikon.  
**(Hermione Gingold)**



KALENDARI HISTORIK 6 QERSHOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS